



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**

Nr.19532 prot.

Tiranë, më 19.10.2020

UDHËZIM

Nr.06, datë 19.10.2020

**MBI ZBATIMIN PRAKTIK TE PROCEDURAVE TË APLIKIMIT, MIRATIMIT,
FUNKSIONIMIT DHE MBIKQYRJES SË THJESHTIMEVE DOGANORE DHE
OPERATORËVE EKONOMIKË TË AUTORIZUAR**

Seksioni I - Hyrje

Statusi OEA

Sipas përcaktimeve të pikës 1, të Nenit 40 të Kodit Doganor (KD), një operator ekonomik i cili është i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe përmbush kriteret e vendosura në nenin 41 të KD, mund të aplikojë për statusin e operatorit ekonomik të autorizuar.

Programi i OEA është i hapur për të gjithë operatorët ekonomikë, duke përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme pavarësisht nga roli i tyre në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit.

Operatorët ekonomikë nuk kanë asnjë detyrim juridik për tu shndërruar në Operator Ekonomik të Autorizuar; kjo është një zgjedhje e vetë operatorit, sipas rrethanave specifike. Gjithashtu, nuk ekziston asnjë detyrim ligjor për OEA-të që t'u kërkojnë partnerëve të biznesit të përftojnë statusin e OEA-ve.

Sipas pikës 2, të nenit 40, të KD, statusi i operatorit ekonomik të autorizuar ka të bëjë me lloje të ndryshme autorizimi:

- OEA për thjeshtime doganore (OEAD) dhe
- OEA për aspekte të Sigurisë dhe Mbrojtjes (OEAS).

Secili nga autorizimet garanton përfitime të ndryshme për operatorin. Sipas nenit 41 të Kodit Doganor, statusi i OEA mund t'i jepet çdo operatori ekonomik që plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) të mos ketë kryer shkelje të rënda ose të përsëritura të legjislacionit doganor dhe tatimor;
- b) të mos jetë i proceduar penalisht për vepra penale që lidhen me aktivitetin ekonomik të aplikuesit;
- c) të demonstrojë një nivel të lartë kontrolli të veprimeve të tij dhe të lëvizjes së mallrave me anë të një sistemi që menaxhon regjistrimet tregtare dhe, kur është me vend, edhe regjistrimet e transportit, i cili lejon kryerjen e kontroleve të duhura doganore;
- ç) të ketë aftësi pagueuse që do të kërkohen për të provuar nëse aplikuesi ka gjendje të mirë financiare, e cila i lejon atij të përmbushë angazhimet që rrjedhin e lidhen me karakteristikat e llojit të aktivitetit në fjalë;
- d) për sa i takon autorizimit për thjeshtësime doganore (OEAD) të ketë standardet praktike të kompetencave ose kualifikimeve profesionale që lidhen direkt me aktivitetin e kryer;
- dh) për sa i takon autorizimit për sigurinë dhe mbrojtjen (OEAS), të ketë standardet e duhura të sigurisë dhe mbrojtjes, të cilat konsiderohen të plotësuara kur aplikuesi tregon se ai siguron masat e duhura për zbatimin e sigurisë dhe mbrojtjes së zinxhirit tregtar ndërkombëtar, përfshirë fushat e integritetit fizik dhe kontrollit të aksesit, proceset logjistike dhe trajtimet për lloje të veçanta mallrash, personel dhe identifikimin e partnerëve të tij të biznesit.

1.1.1. OEA-Thjeshtimet doganore (OEAD):

Statusi OEA në trajtën e OEAD-ve parashikohet për operatorët ekonomikë të krijuar në territorin e Republikës së Shqipërisë të cilët janë të interesuar të përfitojnë nga thjeshtime të ndryshme që ofrohen specifikisht në kuadrin e legjislacionit doganor. Kriteret për përftimin e OEAD-së përfshijnë:

- mungesën e shkeljeve të rënda apo të përsëritura të legjislacionit doganor dhe rregullave tatimore, përfshirë këtu asnjë rast shkeljeje të rëndë që lidhet me veprimtarinë ekonomike të aplikuesit;
- të provuarit e një niveli të lartë kontrolli të veprimtarive të tij dhe qarkullimit të mallit, përmes një sistemi menaxhimi të regjistrave tregtarë dhe atyre të transportit, sipas rastit, gjë që mundëson kontrollin e duhur doganor,
- si edhe prova të likuiditetit financiar; të cilat konsiderohen të provuara në rastet kur aplikuesi ka një gjendje financiare të qëndrueshme, e cila e lejon të përmbushë detyrimet e tij në lidhje me karakteristikat e llojit të biznesit në fjalë;

Duke qenë se këto kritere vlejné për një pjesë të konsiderueshme të autorizimeve për thjeshtime doganore, marrja e statusit OEAD-së do të lehtësonte apo thjeshtësonte përfitime

të operatorit ekonomik dhe mundësitë për përdorim të thjeshtimeve/autorizimeve të ndryshme doganore.

Kështu, p.sh. sipas nenit 192 të K D, kriteret për autorizim, për regjime të posaçme mbahen në konsideratë gjatë procesit të aplikimit për OEA. Gjithashtu një operator ekonomik i autorizuar për thjeshtësi doganore konsiderohet se plotëson kushtet për autorizime të veçanta, nëse aktiviteti i lidhur me regjimin e posaçëm në fjalë është marrë në konsideratë në autorizimin për OEA;

Një OEAD gëzon të drejtën për:

- të përfituar nga lloje specifike lehtësish doganore mbi bazën e njohjes së OEAD, sa kohë që përmbushen kërkesat që lidhen me llojin specifik të lehtësive që jepen në legjislacionin doganor;
- trajtim më favorizues në krahasim me operatorët e tjerë ekonomikë, për sa u takon kontrolleve doganore, duke përfshirë këtu më pak kontrolle fizike dhe ato për dokumentacion, por duke përjashtuar kontrollet që lidhen me masat e sigurisë dhe të mbrojtjes;
- njoftim paraprak në rast përzgjedhjeje për kontroll doganor;
- trajtim prioritar në rast përzgjedhjeje për kontroll;
- mundësinë për të përzgjedhur një vend specifik për kontrollin.

1.I.2. OEA-Siguria dhe Mbrojtja (OEAS):

OEAS parashikohet për operatorët ekonomikë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të cilët dëshirojnë të përfitojnë nga lehtësi specifike në lidhje me kontrollet doganore që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen, gjatë kohës që mallrat hyjnë apo dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë

Kriteret për dhënien e OEAS përfshijnë:

- dëshmi të zbatimit të legjislacionit doganor dhe atij tatimor, duke përfshirë edhe dëshmi të moskryerjes së veprës së rëndë penale që lidhet me veprimtarinë ekonomike të aplikuesit;
- demonstrimin e një niveli të lartë të kontrollit të veprimeve dhe qarkullimit të mallrave të operatorit, përmes një sistemi të menaxhimit të regjistrave tregtarë dhe transportit, sipas rastit, që mundëson kontrollin e duhur doganor.

- të vërtetojë likuiditet financiar dhe ekzistencën e standarteve të duhura të sigurisë dhe mbrojtjes.

Një OEAS ka të drejtën për:

- lehtësime që lidhen me deklaratat përpara nisjes;
- trajtim më favorizues nga operatorët e tjerë ekonomikë në lidhje me kontrollet doganore, duke përfshirë këtu më pak kontrolle fizike dhe ato për dokumentacion, por duke përjashtuar kontrollet që lidhen me masat e sigurisë dhe të mbrojtjes;
- njoftim paraprak në rast përzgjedhjeje për kontroll doganor;
- trajtim prioritar në rast përzgjedhjeje për kontroll;
- mundësinë për të përzgjedhur një vend specifik për kontrollin.

Një OEAS njihet si operator ekonomik që ka marrë masat e duhura për të garantuar/siguruar biznesin e tij/saj dhe, rrjedhimisht, është një aktor i besueshëm në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit, si nga këndvështrimi i autoriteteve përkatëse shtetërore dhe nga perspektiva e partnerëve të tij të biznesit.

1.I.3. AEO - Thjeshtimet doganore/ Siguria dhe Mbrojtja (OEAD/OEAS):

Të dy llojet e autorizimeve, si OEAD ashtu edhe OEAS mund të mbahen njëkohësisht. Në këtë rast, operatorit i duhet të përmbushë kriteret për OEAD dhe OEAS dhe përfiton nga të dyja llojet e autorizimeve.

Në Nenin 58 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr. 102/2014 Kodi Doganor i Republikës Së Shqipërisë” (VKM NR.651/2017) *“në rastet kur aplikuesi ka të drejtën të konsiderohet edhe si OEAD, edhe si OEAS, autoritetet doganore që kanë kompetencë për vendimmarrje do të lëshojnë një autorizim të kombinuar”*.

Tabela e mëposhtme është një përmbledhje e kushteve dhe kriterëve për OEA:

Kushtet dhe Kriteret	AEOD	AEOS	Referenca Kodi Doganor/VKM
Operatori Ekonomik	X	X	pika 5, e Nenit 6, e Kodit Doganor
I vendosur në territorin doganor e Shqipërisë	X	X	pika 31, e Nenit 6, e Kodit Doganor

Konformiteti	X	X	Neni 41 i KD Neni 49 i VKM NR.651/2017
Mbajtja e regjistrave në mënyrën e duhur	X	X	Shkronja (c), e Neni 41, e KD Neni 50 i VKM NR.651/2017
Aftësia paguese	X	X	Shkronja (ç), e Neni 41, e KD Neni 51 i VKM NR.651/2017
Praktikat standarte të kompetencës dhe kualifikimit profesional	X		Shkronja (d), e Neni 41, e KD Neni 52 i VKM NR.651/2017
Ruajtja dhe Siguria		X	Shkronja (dh), e Neni 41, e KD Neni 53 i VKM NR.651/2017

1.I.4. Puna parapërgatitore, përpara dorëzimit të një aplikimi:

Përgatitja e aplikimit për OEA, si edhe autorizimi dhe mbajtja e OEA-ve është një proces që në vetvete kërkon kohë. Çelësi i suksesit është puna përgatitore e kujdesshme, ndaj parashikohet që aplikuesi që synon të bëhet OEA ta ketë biznesin e tij “nën kontroll”.

Kjo do të thotë që në varësi të llojit të OEA-së, për të cilin aplikohet dhe në varësi të veprimtarisë së biznesit të kompanisë, si edhe modelit të biznesit, kompania duhet të ketë masat e duhura organizative që lidhen me kriteret e OEA-së, me qëllim që risqet që lidhen me aktivitetin doganor të mund të evidentohen, të shmangen dhe të minimizohen.

[Pyetësi i Vetëvlerësimit](#) është një instrument që shërben për të strukturuar përgatitjen e operatorit ekonomik, për të evidentuar njësitë organizative brenda operatorit, të cilat do të përfshihen dhe për të kuptuar nivelin e punës përgatitore që kërkohet.

Për të siguruar një bashkëpunim të ngushtë midis autoriteteve doganore dhe aplikuesit për statusin e OEA rekomandohet të vendoset kontakt me Autoritetin Doganor që në fillimin e aplikimit, kontakt i cili duhet të vijojë përtej procesit të aplikimit. Kjo mund të ndihmojë në shmangien e keqkuptimeve nga të dyja palët dhe të garantojë mbështetje në rast se lindin paqartësi.

Përpara dorëzimit zyrtarisht të një aplikimi, rekomandohet që operatori ekonomik:

- të vendosë kontaktet me Autoritetin Doganor;
- të vendosë për llojin e autorizimit që kërkon;
- të caktojë një person kompetent kontakti që do të përgjigjet për aplikimin;

- të plotësojë me kujdes Pyetësozin e Vetëvlerësimit duke u siguruar që për plotësimin e tij të përfshihen të gjithë personat dhe departamentet e duhur.

Gjithashtu është e rëndësishme që administrata e kompanisë ta mbështesë aplikimin për OEA.

Seksioni II – Kush/cilët mund të bëhen operatorë ekonomikë të autorizuar (OEA)?

Neni 40 i KD përcakton se një operator ekonomik i ngritur (themeluar) brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që plotëson kriteret e parashikuara në nenin 41 të Kodit Doganor mund të aplikojë për të marrë statusin e OEA-së.

Kjo kërkesë themelore nënkupton realizimin e dy kushteve: i pari, që aplikuesi të jetë operator ekonomik dhe i dyti, që ai të jetë themeluar në territorin e Republikës së Shqipërisë.

1.II.1. Çfarë është në vetvete “operatori ekonomik”?

Në shkronjën 5, të nenit 6 të KD, përcaktohet se, citojmë: *“Operator ekonomik” është personi, i cili gjatë aktivitetit të tij tregtar, përfshihet në veprime të mbuluara nga legjislacioni doganor.*

Sërish, përkufizimi juridik i “operatorit ekonomik” përmban dy kushte kryesore. Aplikuesi duhet të jetë “person” dhe duhet të jetë i përfshirë në aktivitete që mbulohen nga legjislacioni doganor.

Në kuptimin e shkronjës 4, të nenit 6 të K D *“Person” është një person fizik, një person juridik, si dhe çdo person tjetër/individ me zotësi të plotë për të vepruar, të njohur si subjekte nga legjislacioni në fuqi.*

Konsiderohet filial i kompanisë apo shoqëri e kontrolluar një person juridik, domethënë subjekt juridik apo bashkim i personave të regjistruar në regjistrin e kompanive vendase, sipas ligjit për shoqëritë tregtare, ku është themeluar ky filial i shoqërisë. Me fjalë të tjera, nëse një kompani mëmë dëshiron të marrë statusin OEA për një pjesë apo për të gjitha filiale të shoqëritë e saj të kontrolluara, aplikimet duhet të paraqiten nga të gjitha ato që dëshirojnë të bëhen OEA.

Nga ana tjetër, "dega" është një zyrë/vendndodhje tjetër e vetë kompanisë dhe është pjesë përbërëse e totalit të aktiveve të kompanisë dhe rrjedhimisht nuk është person juridik më vete. Në këtë rast, kompania mëmë që kërkon të marrë statusin e operatorit ekonomik të autorizuar duhet të paraqesë një aplikim të vetëm,

1.II.2. Çfarë përfaqëson një operator ekonomik i krijuar në Shqipëri?

Në zbatim të pikës 31, të Nenit 6, , të K D, person i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë është:

- a) në rastin e një personi (individ), çdo person që ka vendqëndrimin, (vendbanimin) në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;
- b) në rastin e një personi fizik ose juridik, i njohur si i tillë nga legjislacioni në fuqi, çdo person që ka selinë, zyrën qendrore, degën apo vendndodhjen e përhershme të biznesit, të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Pika 32, e Nenit 6 të K D, përcakton si vendndodhje të përhershme biznesi, zyrën qendrore ose degën e biznesit, ku janë gjithmonë burimet e nevojshme njerëzore dhe ato teknike, nëpërmjet të cilave kryhen pjesërisht ose tërësisht operacionet e një personi që ka marrëdhënie me doganën.

1.II.3. Cili konsiderohet si operator ekonomik “i përfshirë në aktivitete doganore”?

Një aspekt tjetër që duhet të mbahet në konsideratë kur vendoset nëse një aplikant i caktuar është “një operator ekonomik” ka të bëjë me faktin nëse aktiviteti i operatorit ekonomik në fjalë “mbulohet ose jo nga legjislacioni doganor”.

Aplikimet për statusin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar konsiderohen të pranueshme vetëm nga ata operatorë ekonomikë të cilët në biznesin e tyre janë të përfshirë në veprimtari që mbulohen nga legjislacioni doganor. Mbi bazën e këtij përkufizimi ka një sërë rrethanash kur një operator ekonomik nuk mund të aplikojë për status OEA, duke qenë se nuk është i përfshirë në aktivitet doganor, si p.sh:

- një furnitor me bazë në Republikën e Shqipërisë, i cili shpërndan vetëm mallra që janë në qarkullim për një prodhues me bazë po në territorin shqiptar.
- një operator në fushën e transportit që transporton vetëm mallra në qarkullim të lirë, të cilat nuk kryejnë procedura të tjera doganore brenda territorit doganor të Republikën e Shqipërisë;
- një prodhues që prodhon mallra vetëm për tregun e brendshëm dhe që përdor lëndë të parë që ekziston në qarkullim të lirë;
- një konsulent që ofron shërbime konsulence vetëm për çështje që lidhen me doganat.

Përkufizimi i një operatori ekonomik nuk e kufizon nocionin e "përfshirjes në veprimtari që mbulohen nga legjislacioni doganor" vetëm e vetëm tek përfshirja e drejtpërdrejtë. Një prodhues që prodhon mallra për eksport mund të aplikojë për status OEA, edhe në ato raste kur formalitetet e eksportit kryhen nga një tjetër person.

Koncepti i Sigurimit dhe Sigurisë OEA lidhet ngushtësisht me menaxhimin e zinxhirit të furnizimit. Operatorët që trajtojnë/përpunojnë mallra që i nënshtrohen mbikqyrjes doganore apo që kanë të bëjnë me të dhëna doganore mund të aplikojnë për OEAS.

Megjithatë, çdo rast duhet të trajtohet në veçanti, duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat që lidhen me një operator ekonomik më vete.

1.II.4. Aktorët e interesit në një zinxhir ndërkombëtar furnizimi

Nga këndvështrimi i doganave, zinxhiri ndërkombëtar i furnizimit përfaqëson një proces të tërë, domethënë që nga prodhimi i mallrave të destinuara për eksport deri tek dorëzimi i mallrave tek blerësi në një territor tjetër doganor. Zinxhiri ndërkombëtar i furnizimit nuk është një organ më vete i identifikueshëm. Ai përfaqëson një sërë elementësh të një operatori ekonomik, të ndërlidhura, që përfaqësojnë segmente të ndryshme të industrisë tregtare. Në disa raste, operatorët ekonomikë mund të njihen mirë dhe mund të kenë marrëdhënie pune afatgjata, por ka edhe raste kur operatorët ekonomikë mund të ndryshojnë shpesh ose mund të kenë marrëdhënie kontraktuale me njëri-tjetrin për një veprim apo dërgesë të vetme. Nga pikëpamja operationale, referenca për "zinxhirët e furnizimit" në vend të terminologjisë "zinxhir furnizimi" është më e saktë, sepse do të thotë që çdo operator ekonomik mund të përfshihet jo vetëm në një zinxhir teorik furnizimi, por në disa zinxhira të tillë praktikë.

Praktikisht, shumë biznese mund të luajnë më shumë se një rol të vetëm në një zinxhir të caktuar furnizimi dhe mund të kenë më shumë se një përgjegjësi në lidhje me ato role (p.sh. një agjenci spedicionere mund të luajë edhe rolin e përfaqësuesit doganor). Kur aplikohet për statusin e OEA-së, aplikuesi duhet të sigurohet që në aplikimin e tij të përfshijë/përmendë veprimtaritë doganore për të gjitha përgjegjësitë brenda zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit.

Aktorët e ndryshëm të interesit dhe përgjegjësitë e tyre të ndryshme në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit, nga këndvështrimi doganor, të cilët mund të aplikojnë për Statusin e OEA-së janë si më poshtë vijon:

a) prodhuesi

Në kuadrin e zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit, një prodhues është një operator ekonomik i cili gjatë punës së tij prodhon mallra të destinuara për eksport.

Përgjegjësia e prodhuesit në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit mund të jetë, *ndër të tjera*:

- të garantojë një proces të sigurt dhe të mbrojtur prodhimi për produktet e veta;
- të garantojë furnizim të sigurt dhe të mbrojtur të produkteve të veta për klientët;
- të sigurojë zbatimin me korrektesë të rregullave doganore, përsa i takon origjinës së mallit.

b) eksportuesi

Për qëllimet e OEA-së, sipas pikës 19, të nenit , të VKM n.651/2017eksportues nënkupton:

- a) *personin e vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, i cili në kohën kur pranohet deklarata mban kontratën me marrësit në vendin tjetër dhe ka të drejtë për të përcaktuar se mallrat duhet të dërgohen në një destinacion jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;*
- b) *personin (individin) që mban mallrat që do të eksportohen, kur këto mallra ndodhen në bagazhin personal të tij;*
- c) *në raste të tjera, personin e vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, i cili ka të drejtë për të përcaktuar se mallrat duhet të dërgohen në një destinacion jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.*

Disa nga përgjegjësitë e eksportuesit në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit përfshijnë:

- përgjegjësi për saktësinë e deklaratës së eksportit dhe paraqitjen e saj në kohë, në rastet kur deklarata e eksportit bëhet nga eksportuesi;
- përgjegjësi për lëshimin e deklaratës së eksportit me të dhënat e duhura;
- aplikimin për formalitetet juridike të eksportit, sipas rregullave doganore, duke përfshirë politikat tregtare, masat e ndalimit dhe kufizimit, dhe tarifat/detyrimet e eksportit;
- garantimin e furnizimit të sigurt dhe të mbrojtur të mallrave tek agjencia pedicionere apo agjencia doganore.

c) agjencia spedicionere

Spedicioneri organizon transportin e mallrave në tregtinë ndërkombëtare, në emër të eksportuesit, importuesit apo një personi tjetër. Në disa raste agjencia spedicionere, vepron si transportues dhe lëshon kontratën e vet të transportit, si p.sh. policë ngarkimi apo fletë shoqërimi.

Ndër veprimtaritë e zakonshme të agjencive spedicionere përfshihen: marrja, kontrolli dhe hartimi i dokumentacionit, për të përmbushur kërkesat doganore.

Përgjegjësia e spedicionerit në një zinxhir ndërkombëtar furnizimi përfshin ndër të tjera, sa më poshtë vijon:

- zbatimin e rregullave për formalitetet e transportit;
- garantimin, sipas rastit, të transportit të sigurtë dhe të sigurisë së mallrave;
- zbatimin, sipas rastit, të rregullave të deklarates përmbledhëse, sipas legjisllacionit.

ç) drejtuesit e magazinave dhe operatorë të shërbimeve të tjera të magazinimit

Drejtuesi i magazinës është personi i autorizuar për të siguruar mbarëvajtjen e magazinës doganore, ose një person që administron një objekt të përkohshëm magazinimi, apo objekte të zonës së lirë.

Në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit, përgjegjësitë e magazinierit ndër të tjera janë:

- drejtuesi i magazinës garanton që gjatë kohës që malli qëndron në magazinën doganore apo në magazinim të përkohshëm të merren masat e duhura dhe të zbatohen procedurat përkatëse për të siguruar që malli nuk del nga mbikqyrja doganore, si edhe të përmbushë detyra të tjera që lindin nga magazinimi i mallit në procedurë magazinimi, ose të veprojë sipas rregullave për magazinimin e përkohshëm;
- të plotësojë kushtet e veçanta të autorizimit për magazinën doganore apo për objektin e magazinimit të përkohshëm;
- të garantojë mbrojtjen e duhur të zonës ku ndodhet magazina nga ndërhyrjet e jashtme;
- të garantojë mbrojtjen e duhur nga aksesit i pa-autorizuar, apo raste të zëvendësimit apo ngacimit të mallit.

d) agjenti/përfaqësuesi doganor

Në kuptimin e përdorur në këtë udhëzues, *Përfaqësues doganor është çdo person i caktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, nga një person tjetër, për të kryer veprimet dhe formalitetet e kërkuara nga legjislacioni doganor në marrëdhëniet e tij me autoritetet doganore*, sipas përkufizimit të pikës 6, të nenit 6të KD.

Bazuar në Nenin 24 të KD cdo person mund të caktojë një përfaqësues doganor. Një përfaqësues i tillë mund të jetë ose direkt, në rastin kur përfaqësuesi doganor vepron në emër e për llogari të një personi tjetër, ose i tërthortë, kur përfaqësuesi doganor vepron në emër të tij, por për llogari të një personi tjetër. Përfaqësuesi doganor duhet të jetë i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Me Udhëzimin nr.5 datë 28.03.2019 janë të miratuara procedurat për zbatimin praktik për miratimin dhe funksionimin e përfaqësimit në doganë.

Në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit, përgjegjësia e një agjenti doganor ndër të tjera mund të përfshijë:

- zbatimin e dispozitave të nevojshme sipas rregullave doganore specifike për llojin e përfaqësimit, për vendosjen e mallit në procedurë doganore;
- përgjigjet për korrektesën e doganës apo deklaratës përmbledhëse dhe për paraqitjen e saj në kohë.

dh) transportuesi

“Transportues” është:

a) *në kuptim të hyrjes*, personi i cili sjell mallrat ose që merr përgjegjësinë për transportin e mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Sidoqoftë:

i) në rastin e transportit të kombinuar, “transportues” është personi që operon mjetet e transportit, të cilat, mbasi kanë hyrë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, lëvizin vetë si një mjet aktiv transporti;

ii) në rastin e transportit ajror apo detar me një mjet të përbashkët transporti apo të një marrëveshjeje kontraktuale, “transportues” është personi, i cili lidh një kontratë dhe lëshon një dokument transporti detar ose ajror (bill of lading ose air waybill) për transportin konkret të mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) *në kuptim të daljes*, personi, i cili nxjerr mallrat ose që merr përgjegjësinë për transportin e mallrave jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Sidoqoftë:

i) në rastin e transportit të kombinuar, kur mjeti aktiv i transportit që lë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë është vetëm duke transportuar një mjet tjetër transporti, i cili, mbas mbërritjes së mjetit aktiv të transportit në destinacion, do të lëvizë vetë si një mjet aktiv transporti, “transportues” është personi që do të operojë mjetin e

transportit që do të lëvizë vetë sapo mjeti i transportit, që lë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, ka arritur në destinacionin e tij;

ii) në rastin e transportit ajror apo detar me një mjet të përbashkët transporti apo të një marrëveshjeje kontraktuale, “transportues” është personi, i cili lidh një kontratë dhe lëshon një dokument transporti detar ose ajror (bill of lading ose air waybill) për transportin konkret të mallrave që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

Në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit, përgjegjësitë e transportuesit mund të përfshijnë:

- garantimin e transportit të sigurt të mallrave gjatë kohës që ato janë në kujdesin e transportuesit, në veçanti, duke shmangur aksesin e paautorizuar dhe ngacmimin (ndryshimin) e mjeteve të transportit dhe mallit që transportohet;
- sigurimin e dokumentacionit të transportit në kohë, sipas parashikimeve ligjore;
- zbatimin e formaliteteve të nevojshme juridike, sipas legjislacionit doganor;
- zbatimin, sipas rastit, të rregullave për deklaratën përmbledhëse, në përputhje me legjislacionin.

e) importuesi

Importuesi është një operator ekonomik që lëshon deklaratën e importit, ose në emër të të cilit lëshohet deklarata e importit. Megjithatë, nga një këndvështrim më i gjerë tregtar dhe në veçanti në lidhje me thelbin e programit të OEA-së, përkufizimi i importuesit të vërtetë duhet të konsiderohet nga një perspektivë më e gjerë (personi që bën deklaratën e importit jo gjithmonë është personi që hedh edhe mallin në treg).

Përgjegjësitë e importuesit në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit, ndër të tjera, përfshijnë:

- përgjigjet për marrëdhëniet me autoritetet doganore, për lëvrimin e mallit dhe për caktimin e mallrave që do të paraqiten në doganë - miratimi i trajtimit apo përdorimit;
- përgjigjet për korrektesën e deklaratës (saktësinë) paraqitjen e saj brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin përkatës;
- në rastet kur importuesi është personi që bën deklaratën fillestare/hyrëse përmbledhëse, ai përgjigjet për zbatimin me korrektesë të rregullave për deklaratën përmbledhëse;
- përgjigjet për zbatimin formaliteteve të nevojshme ligjore, sipas rregullave doganore që lidhen me importin e mallrave;

- përgjigjet për zbatimin e politikave tregtare dhe masave ndaluese dhe kufizuese;
- përgjigjet për garantimin e marrjes së sigurt dhe të mbrojtur të mallit, në veçanti, duke shmangur aksesin e paautorizuar dhe ngacmimin e mallit.

f) operatorë të tjerë, si p.sh., operatorët në terminal, punëtorët e ngarkim-shkarkimit dhe ambalazhuesit e ngarkesave.

Seksioni III – Përfitimet e OEA-s

Autorizimi për operator ekonomik të autorizuar (OEA) i lëshohet aplikuesit, pas një kontrolli të imtësishëm të aktivitetit të tij të biznesit. Statusi i OEA-t ka të bëjë me vetë operatorin ekonomik dhe me aktivitetin e tij të biznesit dhe ai është i vetmi që gëzon përfitimet që lindin nga ky status. Ky është një parim i përgjithshëm për të gjitha llojet e autorizimeve OEA që mund t'i jepen një operatori ekonomik, me role të ndryshme në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit.

Përfitimet që ka një Operator Ekonomik i Autorizuar janë pjesë përbërëse e legjislacionit doganor .

Më poshtë jepet një përmbledhje e përfitimeve të OEA-ve, në varësi të llojit të autorizimit.

Në mënyrë që autoritetet doganore të ofrojnë këto përfitime për Operatorët Ekonomik të Autorizuar, Drejtoria e Procedurave Doganore duhet të garantojë njoftimin e autorizimit përkatës të gjithë strukturave në Drejtori të Përgjithshme të Doganave dhe Degëve Doganore me qëllim marrjen e masave lehtësuese nga ana e tyre.

1.III.1. Akses më i lehtë për thjeshtimet doganore

Këto përfitime janë vetëm për mbajtësit e autorizimit OEAD.

Legjislacioni i Shqipërisë për doganat parashikon këto raste kur OEA merr vlerë:

- a) Statusi OEA kërkohet për të pasur akses në lidhje me thjeshtimet/autorizimin,
- b) disa nga kriteret për një thjeshtim/autorizim të posaçëm mbulohen nga kriteret OEA,
- c) kriteret për një thjeshtim/autorizim të posaçëm konsiderohen të barasvlershme me kriteret OEA.

Në pikën 4, të Nenit 40, të K D parashikohet se në rast se personi që kërkon një thjeshtim të caktuar për arsye se është mbajtës i një autorizimi OEAD, autoritetet doganore nuk do t'i marrin edhe një herë në shqyrtim këto kushte, plotësimi i të cilave

konsiderohet i shteruar me marrjen e statusit si OEA. Kjo do të thotë që autoritetet doganore duhet të përqendrohen tek elementë të rinj apo shtesë dhe tek kërkesat që lidhen me thjeshtimin në fjalë.

Kriteret që konsiderohen të përmbushura nga një OEA mund të gjenden në nenet përkatëse të Kodit Doganor dhe në dispozitat e tij zbatuese që lidhen me thjeshtimin specifik. Më poshtë jepet një listë e thjeshtimeve në fjalë.

a) rastet kur kërkohet statusi i OEA për të pasur akses tek një thjeshtim/autorizim:

- garanci globale, me shumë të reduktuar për tarifatat dhe detyrimet ekzistuese doganore, Pika 3, e nenit 90, të KD, zhdoganim i centralizuar (në rastet kur kërkohet autorizim), Neni 163 pika 2, e nent 163, të KD,
- hyrja në regjistrat e deklaruesit duke hequr detyrimin për praninë/paraqitjen fizike të mallit, pika 3, e Neni 165, i KD,
- vetëvlerësimi, Neni 167 i KD dhe Neni 346 i VKM NR.651/2017

b) rastet kur disa nga kriteret për një thjeshtim/autorizim të posaçëm mbulohen nga kriteret e OEA-së (në zbatim të pikës 4, të Neni 40, të Kodit Doganor):

- autorizim për thjeshtimin që lidhet me vlerën e mallit për qëllime doganore, Neni 166 i VKM NR.651/2017
- garancia globale, pika 1, e Neni 90 i Kodit Doganor,
- garanci globale ose një garanci për heqjen e detyrimit në lidhje me borxhin dhe detyrime të tjera doganore, sipas rastit, Neni 90 (2) i KD,
- autorizim për përdorim të një garancie globale të ndalimit të përkohshëm, pika 2, e Neni 91 të Kodit Doganor,
- miratimi i një vendi të ndryshëm nga zyra e doganës kompetente (paraqitja e mallit), Neni 250 i VKM NR.651/2017
- autorizim për shërbim të zakonshëm transporti (me anije/detar), Neni 295 i VKM NR.651/2017
- lëshues i autorizuar (provë e statusit doganor), Neni 290 i VKM NR.651/2017
- peshues i autorizuar bananesh, Neni 393 i VKM NR.651/2017
- autorizim për deklaratë të thjeshtuar doganore, Neni 321 i VKM NR.651/2017
- autorizim për të hyrë në të dhënat e deklaruesit, Neni 336 i VKM NR.651/2017

- dërgues i autorizuar (TIR), transport ndërkombëtar rrugor, Neni 571 i VKM NR.651/2017
 - autorizim për thjeshtime që lidhen me tranzitin, Neni 583 i VKM NR.651/2017;
- c) rastet kur kriteret për një thjeshtim/autorizim të posaçëm konsiderohen të barasvlershme me kriteret OEA:
- Autorizim për vënien në funksionim të objektit të magazinimit të përkohshëm, Neni 138 (2) (b) dhe (4) nënparagrafi 2, i KD,
 - Autorizim për regjime të posaçme, Nenet 192 (3) (b), 194 (2) dhe 201 (2) nënparagrafi 2, i KD.

Vlen të theksohet se Statusi i OEA-t u fut në legjislacionin doganor të Shqipërisë, pas thjeshtimeve të tjera dhe për pasojë, një pjesë e operatorëve ekonomikë tashmë ishin autorizuar për to, përpara se të merrnin Statusin e OEA-t. Megjithatë, ky përfitim i veçantë mbetet ende me shumë rëndësi për OEA-të, apo për personat që janë duke e menduar të aplikojnë për statusin e OEA, dhe aq më tepër për autoritetet doganore. Përsa u takon aktiviteteve të monitorimit për OEA, ato duhet të koordinohen me aktivitetet për autorizimet e tjera, me qëllim shmangien sa më shumë të jetë e mundur të duplikimeve. Për përdorimin sa më efikas të këtij përfitimi, si nga ana e operatorëve ekonomikë të autorizuar, ashtu edhe nga ana e autoriteteve doganore duhen mbajtur parasysh këta elementë:

- duke qenë se thjeshtimet janë kyçe për përputhshmërinë me disa kriteret të OEA-t, duhet të garantohet/mbahet marrëdhënia/vartësia midis autorizimit specifik dhe Statusit të OEA-t, duke mbuluar jo vetëm fazën e aplikimit, por edhe gjatë monitorimit dhe rivlerësimit, momentin e sigurimit të autorizimit/statusit;
- ekzaminimi i kriterëve përkatëse të Operatorit Ekonomik të Autorizuar, përpara dhënies së statusit të OEA-t nuk është një ushtrim abstrakt dhe bëhet gjithmonë në lidhje me aktivitetin e biznesit të operatorit ekonomik. Dmth., kur paraqitet një aplikim për një autorizim specifik, autoritetet doganore nuk duhet të shqyrtojnë nga e para kriteret që janë kontrolluar më parë, por duhet të përqendrohen vetëm tek ndonjë element/kërkesë e re.

1.III.2. Njoftimi paraprak

Ky përfitim i bën të mundur mbajtësit të autorizimit të OEA-t të ketë një avantazh logjistik, dmth., ndihmon në një planifikim më të mirë dhe optimizim të logjistikës dhe transportit, duke ulur vonesa logjistike dhe kostot e transportit. Përfitimi mund të përdoret nga:

a) mbajtësit e OEAD dhe OEAS:

Pika 5, e Nenit 40, , të K Ddhe pika 3, e Nenit 43 të VKM NR.651/2017 përcaktojnë se *“Kur një OEA depoziton një deklaratë për magazinim të përkohshëm ose një deklaratë doganore në përputhje me nenin 156, të Kodit, zyra doganore kompetente për pranimin e deklaratës për magazinim të përkohshëm apo deklaratës doganore në përputhje me nenin 156, të Kodit, duhet të njoftojë OEA kur ngarkesa përzgjidhet për kontroll doganor. Njoftimi duhet të bëhet përpara paraqitjes së mallrave në doganë”*.

Këtu përfshihet gjithashtu kontrolli për llogari të autoriteteve të tjera shtetërore, në rastin kur aplikohet.

Është e rëndësishme të bëhet dallimi midis njoftimit paraprak që lidhet me sigurinë dhe mbrojtjen dhe njoftimit paraprak që ka të bëjë me zbatimin e masave të tjera, të përshkruara në legjislacionin doganor.

Kjo do të thotë që vetëm OEAS do të marrin njoftim paraprak në rastin e kontrolleve doganore që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen, ndërsa OEAD do të marrin njoftim paraprak në rastet kur kontrollet doganore nuk lidhen me sigurinë.

b) vetëm për mbajtësit e OEAS:

Pika 2 , e Nenit 43 të VKM NR.651/2017 përcakton se kur një Operator Ekonomik i Autorizuar (OEA) ka paraqitur një deklaratë hyrëse përmbledhëse, zyra dogana ku është bërë hyrja e parë do ta njoftojë OEA-në, në rast se dërgesa/malli është përzgjedhur për kontroll fizik. Ky njoftim do të bëhet përpara mbërritjes së mallit në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që OEA të jetë i lidhur me sistemet elektronike të doganës. Njoftimi paraprak mund të ketë rëndësi të posaçme për OEA-të që kanë aktivitet në portet e mëdha, duke qenë se kjo i ndihmon ata ta planifikojnë më mirë punën e tyre.

Njoftimi nuk do të bëhet në rastet kur kjo vë në rrezik kontrollet që do të kryhen, si edhe rezultatet e tyre. Megjithatë, autoritetet doganore mund të kryejnë kontrolle fizike, edhe në ato raste kur OEA nuk është njoftuar.

1.III.3. Më pak kontrolle fizike dhe kontrolle të dokumentacionit

Nga kjo përfitojnë mbajtësit e autorizimeve OEAD dhe OEAS.

Neni 5 i KDdhe Neni 43 i VKM NR.651/2017 parashikon se OEA-të do t'u nënshtrohen më pak kontrolleve fizike dhe kontrolleve të dokumentacionit, në krahasim me operatorët e tjerë ekonomikë, për sa u takon kontrolleve doganore, në përputhje me llojin e autorizimit që kanë. Megjithatë, autoritetet doganore mund të vendosin të kontrollojnë dërgesat e një OEA-, për të marrë në konsideratë një rrezik specifik, apo detyrimet për

kontroll sipas përcaktimeve në ligjet specifike (p.sh. legjislacioni që lidhet me sigurinë e produktit etj.).

Njëkohësisht, ka edhe shembuj të tjerë, kur statusi i OEA merret pozitivisht në konsideratë edhe në rast të kontroleve të tjera.

Është e rëndësishme të bëhet dallimi midis kontrollit që lidhet me sigurimin dhe sigurinë dhe kontrollit që lidhet me zbatimin e masave të tjera të parashikuara në legjislacionin doganor.

Kjo do të thotë që vetëm OEAS do të përfitojnë nga ulja e numrit të kontroleve fizike dhe atyre të dokumentacionit, ndërsa OEAD do të përfitojnë nga ulja e numrit të kontroleve fizike dhe atyre të dokumentacionit që lidhen me masa të tjera të përshkruara në legjislacionin doganor. Këtu përfshihet edhe ulja e numrit të kontroleve në pikën e importit apo eksportit dhe mund të merret në konsideratë edhe për kontrollet e kryera më vonë (aposteriori).

Për të përfituar nga ky mekanizëm, në sistemin e menaxhimit të riskut doganor duhet të përfshihet një klasifikim më i ulët për riskun. Megjithatë, ky klasifikim më i ulët i riskut është për shkak të statusit OEA-s që duhet të mbahet në konsideratë gjithmonë pozitivisht, por mund të variojnë në varësi të rolit dhe përgjegjësi të OEA-s në zinxhirin e furnizimit.

Duhet gjithashtu të mbahet në konsideratë se ky përfitim lidhet me vlerësimin e përgjithshëm të riskut që bëhet për një transaksion të veçantë. Rrjedhimisht, ndonëse statusi i OEA gjithmonë do të kërkojë një trajtim të favorizuar, ka disa tregues risku, si p.sh. vendi i origjinës etj., të cilët mund të nxisin rrethana për kryerjen e një kontrolli.

Duke mbajtur në konsideratë parimet e përgjithshme të sipërpërmendura, më poshtë po japim disa prej situatave të mundshme:

a) deklarata përmbledhëse hyrëse (DPH):

Në pjesën më të madhe të rasteve, sipas përcaktimeve të nenit 119 të K D kërkesat dhe përgjegjësia e paraqitjes së një DPH i takojnë transportuesit. Në rast se ai është personi që dorëzon DPH dhe është mbajtës i OEAS, automatikisht i lind e drejta për të pasur rezultate më të ulëta risku, duke qenë se sistemet dhe procedurat e tij që lidhen me sigurinë, partnerin e biznesit dhe punëmarrësit janë marrë një herë në shqyrtim nga autoritetet doganore. Në rast se përveç transportuesit dhe vetë dërguesi në vetvete është mbajtës i një OEAS, atëherë nivelet e kontrollit mund të ulen më tej.

Gjithashtu, në rast se dërguesi i deklaruar ka edhe një autorizim ekuivalent me atë AEO, të lëshuar nga një autoritet doganor në një vend tjetër, që njihet nga autoritetet doganore shqiptar, në kuadrin e marrëveshjes së njohjes reciproke (shih [Pjesën 1, Seksioni V](#) dhe [Pjesën 6 të këtij Udhëzuesi në lidhje me](#) “Njohjen Reciproke”), të gjitha palët e

deklaruar në DPH, duke përfshirë ato që kanë informacion direkt në lidhje me mallin, do t'i kenë pasur sistemet e tyre të sigurisë dhe mbrojtjes të verifikuara nga autoritetet doganore, qoftë në Shqipëri, apo me një proces të ngjashëm nga autoritetet doganore në vendin tjetër. Kjo do të kontribuonte në rritjen e sigurisë së zinxhirit të furnizimit dhe do të çonte në ulje të mëtejshme të nivelit të kontrollit lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen.

Gjithashtu mund të ketë edhe raste kur të dhënat e nevojshme për paraqiten përmes një deklarate doganore (si p.sh. për tranzitin). Niveli i reduktimeve vlerësohet njësoj, duke marrë në konsideratë rolin dhe përgjegjësitë e aktorëve të përfshirë. Kështu p.sh. një spedicioner që mban statusin e OEA-s është kryesori në një deklaratë doganore për tranzitin me të dhënat e caktuara për DPH. Në këtë rast mbahet si fillim në konsideratë lloji i autorizimit. Në rast se spedicioneri mban edhe një autorizim OEAD, rezultatet e riskut që lidhen me procedurën doganore në fjalë mund të ulen proporcionalisht, duke qenë se për deklaratën e zakonshme doganore për tranzitin, spedicioneri është kryesori. Ai gjithashtu mban përgjegjësi (edhe financiare) për mallin e transportuar dhe për saktësinë e informacionit të dhënë, si edhe për përputhshmërinë me rregullat e tranzitit nga zyra e nisjes deri në zyrën e destinacionit.

Megjithatë, për reduktime të pikavarazhit të riskut që lidhen me kontrollet e sigurisë, personi kryesor do të jetë mbajtësi i OEAS.

b) deklarata doganore me të dhënat për sigurinë e deklaratës përmbledhëse të daljes:

Në shumicën e rasteve, eksportuesi siguron të dhënat për sigurinë dhe mbrojtjen përmes deklaratës doganore të eksportit. Rrjedhimisht, në përgjithësi, nëse eksportuesi është mbajtës i OEAS, ai përfiton nga reduktime më të mëdha përsa u takon kontrolleve të sigurisë.

c) deklaratat doganore:

Mbajtësi i OEAD është agjent doganor dhe klienti që ai përfaqëson nuk është OEA. Agjenti doganor OEA bën një deklaratë doganore për qarkullim të lirë:

Në përgjithësi, autoritetet doganore duhet ta ulin klasifikimin e riskut, në përputhje me përfshirjen e agjentit doganor OEA në përfaqësimin e klientit të vet. Kjo varet nga lloji i përfaqësimit.

Dhënia e përfitimeve lidhet me nocionin e 'Deklaruesit'. Vlen të përmendet se sipas piës 15, të nenit 6, të KD "deklaruesi" është "personi që bën deklaratën doganore, një deklaratë për magazinim të përkohshëm, deklaratë përmbledhëse hyrëse, deklaratë për ri-eksportim apo njoftim për ri-eksportim për llogari të vet, apo personi në emër të të cilit bëhet kjo deklaratë, apo njoftim".

Në rast të përfaqësimit të drejtpërdrejtë agjenti doganor është përfaqësues direkt i importuesit, që do të thotë se agjenti doganor vepron për llogari të importuesit. Rrjedhimisht, "mbajtësi i OEA" (agjenti doganor) dhe "deklaruesi" (importuesi) nuk janë i njëjti person.

Duke pasur parasysh që autoritetet doganore e kanë kontrolluar rutinën dhe procedurat doganore të agjentit doganor, statusi i tij si OEA duhet të mbahet pozitivisht në konsideratë. Megjithatë, njëkohësisht duhet të mbahet në konsideratë se në këtë rast, personi përgjegjës për saktësinë e informacionit që jepet në deklaratën doganore, autenticitetin e dokumenteve të paraqitura dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve që lidhen me hyrjen e mallrave në fjalë, sipas procedurës në fjalë është deklaruesi (importuesi që nuk është OEA) dhe jo mbajtësi i OEA-s.

Në rast të përfaqësimit të tërthortë, agjenti doganor që është mbajtës i statusit të OEA-s vepron për llogari të vet. Ai/ajo është "deklaruesi" dhe procedurat që përdor për plotësimin e përgjegjësi të përcaktuara në Nenin 6 (15) të Kodit Doganor janë verifikuar nga autoritetet doganore. Mbajtësi i një OEAD është një importues dhe ai/ajo bashkëpunon me agjentin doganor që nuk është operator ekonomik i autorizuar. Importuesi bën deklaratë doganore për çlirim për qarkullim të lirë:

Menaxhimi i riskut gjithashtu duhet të trajtohet sipas nivelit të përfshirjes së agjentit doganor në marrëdhëniet e klientit të vet me autoritetet doganore.

1.III.4. Trajtim me përparësi për dërgesat (ngarkesat), në rast se zgjidhen për kontroll

Ky përfitim u shkon mbajtësve të OEAD dhe OEAS.

Pika 3, e nenit 43 , të VKM NR.651/2017 përcakton se në rastet kur dërgesat e deklaruara nga një OEA janë përzgjedhur për kontroll fizik apo dokumentacioni, këtyre kontrolleve duhet t'u jepet përparësi.

Ky përfitim lidhet direkt dhe varet nga modaliteti i transportit dhe infrastruktura e objektit ku do të kryhet kontrolli.

1.III.5. Zgjedhja e vendit ku do të bëhet kontrolli

Ky përfitim u takon mbajtësve të OEAD.

Në pikën 4, paragrafi i dytë, të nenit 43, të VKM NR.651/2017 përshkruhet mundësia që me kërkesën e një operatori ekonomik të autorizuar, kontrollet të mund të kryhen në një vend të ndryshëm nga ai ku mallrat paraqiten në doganë. Ky vend alternativ mund të ulë vonesat dhe/ose koston. Megjithatë, kjo u nënshtrohet marrëveshjeve individuale me autoritetin doganor në fjalë. Vendi i përzgjedhur për kontrollin duhet gjithmonë t'u japë

mundësi autoriteteve doganore të kryejnë kontrollet e nevojshme, pa vënë në rrezik rezultatin e tyre.

Ndonëse mundësia për të zgjedhur vendin për kontrollin jepet edhe në kuptimin e Nenit 349, nënparagrafi tre, i KD, për të gjithë operatorët ekonomikë, në kushte dhe procedura të tjera ka një dallim midis dispozitave të përgjithshme dhe dispozitës për përfitim të OEA, kur autoriteteve doganore u duhet të marrin në konsideratë statusin për të përcaktuar nëse kërkesa do të plotësohet apo jo.

Disa rrethana praktike mund të lindin përsa u takon OEA-ve, si p.sh.:

- *rast pas rasti, për transaksione të veçanta një OEA mund të kërkojë një vend tjetër ku të kryhet kontrolli.*

Në këtë, rast autoritetet doganore do të marrin në konsideratë statusin e OEA-s. Nëse nuk ekzistojnë rrethana të tjera për ta ndaluar atë, autoritetet doganore duhet të lejojnë që kontrolli të kryhet në vendin e zgjedhur nga OEA. Këto janë rrethana ku statusi i OEA-s dhe dijenia që kanë autoritetet doganore mund të përdoret si përfitim të cilin operatorët e tjerë nuk e kanë.

- *për shkak të aktivitetit të tij të biznesit, një OEA duhet ta përdorë atë opsion vazhdimisht dhe të kombinuar me “mundësi” të tjera, me kusht që hyrja në regjistrat e deklaruesit të vijë me mundësinë e heqjes së detyrimit për paraqitjen e mallrave, sipas nenit 165 (3) të K Dr.*

Në këtë rast, statusi i një OEA nuk mjafton për t'i lejuar operatorit ekonomik përdorimin automatik të këtij thjeshtimi dhe zhdoganimin permanent të mallrave në hapësirat e tij administrative. Ndonëse për të pasur akses tek ai thjeshtim kërkohet statusi OEAD, për këtë autorizim kërkohet një aplikim i veçantë.

Vlen të theksohet se përveç përfitimeve direkte që jep dhe njeh legjisllacioni, një operator ekonomik i autorizuar mund të përfitojë gjithashtu edhe nga avantazhe të tjera që nuk lidhen direkt me anën doganore të aktivitetit të tij të biznesit. Ndonëse ato konsiderohen si përfitime “të tërthorta” dhe rrjedhimisht nuk përfaqësohen shprehimisht në legjisllacion, ato kanë rëndësinë e tyre pasi mund të kenë një ndikim të lartë pozitiv në biznesin e përgjithshëm të operatorit ekonomik të autorizuar.

Disa ilustrime të përfitimeve të tërthorta që paraqiten në nën-kapitujt në vijim.

1.III.6.1. Njohja si një partner i sigurt biznesi

Një operator ekonomik i autorizuar që plotëson kriterin e sigurisë dhe mbrojtjes konsiderohet si partner i sigurtë në zinxhirin e furnizimit. Kjo gjë do të thotë që OEA bën gjithçka që është e mundur për të minimizuar rreziqet në zinxhirin e furnizimit në të cilin ai është i përfshirë. Statusi si OEA, duke përfshirë mundësinë e përdorimit të logos AEO ia shton reputacionin. Ndonëse nuk është e nevojshme të punohet vetëm me OEA, statusi i OEA-s do të ketë ndikim pozitiv kur krijohen marrëdhënie të reja pune. Duhet të

theksohet se operatorët mund të kontrollojnë listën e OEA-ve të cilët kanë dhënë pëlqimin për publikimin e të dhënave të tyre në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

<http://www.dogana.gov.al>

1.III.6.2. Marrëdhënie më të mira me autoritetet doganore dhe autoritete të tjera shtetërore

Partneriteti i ngritur gjatë procesit të autorizimit dhe bashkëpunimi në vazhdimësi do të ndihmojë për mirëkuptim dhe në gjetjen e zgjidhjeve me dobi të përbashkët për të dyja palët.

Një OEA duhet të ketë një pikë të caktuar kontakti tek autoriteti doganor, tek i cili të drejtohet në rast pikëpyetjesh. Pika e kontaktit mund të mos jetë në gjendje t'u japë përgjigje të gjitha pyetjeve, por mund ta drejtojë OEA-n drejt mënyrës më të saktë për të proceduar dhe tek personat që duhet të kontaktojnë më tej, në rast se është e nevojshme.

Statusi i OEA-s po merr famë dhe rëndësi në shumë fusha. Sigurisht që ka një sërë certifikatash apo autorizimesh në fusha të tjera politikash për të cilat kërkesat janë një apo më shumë kritere OEA apo të lidhura direkt me statusin OEA.

1.III.6.3. Përfitime të tjera indirekte

Qasja OEA u vjen në ndihmë operatorëve ekonomikë në analizën e hollësishme të të gjitha proceseve të zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit. Aktivitetet e të gjitha departamenteve në fjalë në përgjithësi vlerësohen gjatë përgatitjes së aplikimit për OEA. Në shumicën e rasteve efikasiteti dhe bashkëpunimi midis këtyre shërbimeve optimizohet për të pasur më shumë transparencë dhe vizibilitet të zinxhirit të furnizimit.

Investimet nga operatorët për rritjen e standardeve të tyre të sigurisë mund të sjellin efekte pozitive në këto fusha: vizibilitet dhe gjurmim, siguria e personelit, zhvillimi i standardeve, përzgjedhja e furnitorit dhe investimet, siguria në transport, ngritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimi mbi infrastrukturën organizative, bashkëpunim midis palëve në zinxhirin e furnizimit, investime në teknologji dhe sigurimi vullnetar i përputhshmërisë.

Disa prej shembujve të përfitimeve indirekte që mund të vijnë si pasojë e këtyre efekteve pozitive janë:

- ulja e rasteve të vjedhjeve dhe humbjeve;
- më pak vonesa në transportin detar;
- planifikim më i mirë;
- shërbim më i mirë për klientin;
- rritja e besnikërisë së klientit;

- menaxhim më i mirë i inventarit;
- angazhim më i mirë nga ana e punonjësve;
- ulja e incidenteve që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen;
- kosto më të pakta për furnitorët dhe rritje bashkëpunimi;
- raste më të pakta krimi dhe vandalizmi;
- siguri më e lartë dhe bashkëpunim më i mirë midis partnerëve të zinxhirit të furnizimit.

Në tabelën e mëposhtme jepet një përmbledhje e llojeve të ndryshme të përfitimeve:

Përfitimi	AEOD	AEOS	Referenca Kodi Doganor(KD)/VKM NR.651/2017
Akses më i mirë në thjeshtimet doganore	X		Pika 4, Neni 40, e KD
Më pak kontrole fizike dhe dokumentacioni në lidhje me sigurinë dhe legjislacionin doganor	X	X	Pika 1, e Neni 43, i VKM NR.651/2017 dhe pika 5, e Neni 40, të KD
Njoftimi paraprak në rast përzgjedhjeje për kontroll fizik (në lidhje me sigurinë)		X	Pika 2, e neni t43, VKM NR.651/2017 dhe , pika 5 e neni 40, e KD
Njoftimi paraprak në rast përzgjedhjeje për kontroll doganor në lidhje me sigurinë dhe legjislacionin doganor	X	X	Pika 1, e Neni t43, i VKM NR.651/2017 dhe pika 5, e Neni t40, e KD
Trajtim prioritar nëse përzgjidhet për kontroll	X	X	Pika 4, e Neni 43, të VKM NR.651/2017 dhe pika 5, e Neni 40, KD
Mundësia për të kërkuar një vend specifik për kontroll doganor	X	X	pika 4, paragrafi i dytë i , neni 43, të VKM NR.651/2017 dhe pika 5, e Neni t40, e KD
Përfitime të tërthorta	X	X	
Njohje reciproke me vendet e treta		X	Marrëveshjet për njohjen reciproke

Seksioni IV – Bashkëpunimi midis autoriteteve doganore dhe autoriteteve shtetërore

Bashkëpunimi me autoritetet kompetente dhe përditësimi i programeve është evidentuar dhe njihet si element kyç për zhvillimin e mëtejshëm të një programi OEA të shëndoshë. Qëllimi është garantimi i sigurisë globale të zinxhirit të furnizimit dhe shmangia e duplikimeve/mbivendosjeve të përpjekjeve dhe kostove për autoritetet dhe operatorët ekonomikë.

Si i tillë, ai është bërë që në fillim pjesë e bashkëpunimit në rang ndërkombëtar me WCO SAFE, si edhe legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Puna në nivelin e BE-së ka nisur në një sërë fushash (si p.sh. siguria ajrore, detare, kontrolli eksportit etj.), me pikësynimin për evidentimin e sinergjive dhe shmangien e duplikimit të pengesave administrative dhe në këtë fushë, Strategjia e Shqipërisë dhe Plani i Veprimit për menaxhimin e riskut në dogana dhe në veçanti përfshirja e një objektivi specifik në lidhje me bashkëpunimin midis agjencive dhe shkëmbimin e informacionit midis doganave dhe autoriteteve të tjera do të luajë një rol kryesor.

Siguria dhe mbrojtja po marrin gjithmonë e më shumë peshë dhe rëndësi për aktorë të ndryshëm interesi. Statusi i OEA-s është një nga iniciativat më të mëdha në rang global dhe po tërheq gjithmonë e më shumë vëmendje.

Njëkohësisht, certifikatat dhe autorizimet që lëshohen nga autoritetet doganore apo autoritete të tjera shtetërore lehtësojnë procedurën e autorizimit.

Seksioni V – Njohja reciproke

Për disa vite me radhë, ECO dhe administratat doganore përcaktuan objektivin e rritjes së sigurisë së zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit, duke lehtësuar më tej procesin për operatorët ekonomikë të sigurt dhe të besueshëm. Korniza ‘SAFE’ e Standardeve për sigurimin dhe lehtësimin e Tregtisë Globale nxiti administratat doganore për bashkërendim në lidhje me njohjen reciproke të AEO-ve dhe masave të sigurisë.

Rritja e bashkëpunimit midis partnerëve tregtarë, përsa i takon lehtësimit të sigurisë dhe tregtisë ka luajtur një rol të rëndësishëm në BE dhe në vendet e rajonit CEFTA . Njohja reciproke e statusit të OEA-s është një element kyç për përforcimin dhe asistencën e zinxhirit të furnizimit dhe shtimin e përfitimeve për tregtarët.

Njohja reciproke përfshin faktin që administrata doganore e një vendi

- njeh autorizimin OEA të lëshuar nga programet e tjera dhe
- është dakord të ofrojë përfitime/lehtësi të rëndësishme, të krahasueshme dhe aty ku është e mundur reciproke për OEA-n e njohur reciprokisht.

Ndër të tjera, përfitimet nga njohja reciproke përfshijnë:

- numër më të pakët kontrollesh- Statusi i pjesëmarrësit në programin e partneritetit tregtar njihet nga të dy programet dhe përdoret si faktor për vlerësimin e riskut në sistemet e automatizuara të targetimit.

- menaxhimi i riskut-Administrata doganore mund të evidentojë tregtarët e besueshëm dhe të përqendrohet tek dërgesat e tregtarëve të panjohur.

Seksioni VI – Logo dhe Çertifikata e AEO-s

Operatorët ekonomikë të autorizuar kanë të drejtë të përdorin logon e OEA-s:



Të drejtën e autorit të kësaj logoje OEA e ka Drejtoria e Përgjithme e Doganave.

Logoja lëshohet nga Drejtoria e Përgjithme e Doganave dhe jo kushdo mund ta shkarkojë atë nga interneti.

Drejtoria e Përgjithme e Doganave e lëshon logon bashkë me udhëzime të qarta për mënyrën dhe vendin e përdorimit të saj.

Logoja OEA mund të përdoret në këto kushte:

- vetëm mbajtësi i një autorizimi OEA ka të drejtën e përdorimit të logos;
- OEA duhet të mos e përdorë më logon në kohën kur i është pezulluar apo hequr statusi si OEA.

Çdo abuzim në përdorimin e logos së Operatorit Ekonomik të Autorizuar do të ndiqet sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

PJESA 2, Kriteret për OEA

Seksioni I - Përputhshmëria me legjislacionin doganor dhe rregullat tatimore, duke përfshirë mungesën e veprave të rënda penale që lidhen me aktivitetin ekonomik të aplikuesit.

2.I.1. Të përgjithshme

Neni 41 gërma (e) KD bën fjalë për mungesën e shkeljeve të rënda apo të përsëritura të legjislacionit doganor dhe rregullave tatimore, duke përfshirë moskryerjen e veprave të rënda penale që lidhen me aktivitetin ekonomik të aplikuesit. Për më tepër, Pika 1, e Nenit 49 VKM NR.651/2017 e konsideron këtë kriter si të plotësuar, në rast se gjatë tre viteve të fundit nuk ka pasur shkelje të rënda të legjislacionit doganor dhe rregullave tatimore në lidhje me aktivitetin e biznesit të personit në fjalë. Në këtë kontekst, Neni 49 i VKM NR.651/2017 bën dallim mes personave fizikë dhe jo-fizikë:

Në rastet kur aplikuesi është person fizik, kushtet e mësipërme duhet të përmbushen nga

- a) aplikuesi, dhe
- b) në rastet kur është e aplikueshme, punonjësi që merret me çështjet doganore të aplikuesit.

Në rastet kur aplikuesi nuk është person fizik, kriteret duhet të plotësohen nga:

- a) aplikuesi dhe,
- b) personi i ngarkuar nga aplikuesi apo që ushtron kontroll për menaxhimin dhe,
- c) punonjësi që merret me çështjet doganore të aplikuesit.

Përkufizimi i legjislacionit doganor jepet në Nenin 6 (2) të KD. "Rregullat tatimore" duhet të kuptohen në një këndvështrim më të gjerë, jo vetëm si rregullat e taksave që lidhen me import-eksportin e mallrave (si p.sh. TVSH, akcizat, etj.). Nga ana tjetër, "rregullat tatimore" duhet të jenë të kufizuara tek taksat që kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetin ekonomik të aplikuesit.

Dokumentimi i konformitetit me legjislacionin doganor dhe atë tatimor mund të konsiderohet si i përshtatshëm në rast se autoriteti kompetent doganor që do të marrë vendimin e konsideron shkeljen të parëndësishme përkundrejt numrit apo sasisë së veprimeve në fjalë, dhe në rast se autoriteti doganor nuk ka asnjë dyshim mbi qëllimin e mirë të aplikuesit.

Në rast se personi që ushtron kontroll tek aplikuesi është i themeluar apo e ka rezidencën në një vend tjetër, ose në rast se aplikuesi ka më pak se tre vjet që funksionon, autoritetet doganore do të bëjnë vlerësim të përputhshmërisë me kriterin, mbi bazën e dokumentacionit dhe informacionit të disponueshëm.

Rrethanat e zakonshme specifike të mëposhtme rekomandohen të mbahen në konsideratë gjatë vlerësimit që i bëjnë shkeljes autoriteti doganor:

- vlerësimi i konformitetit duhet të mbulojë të gjithë aktivitetin doganor të aplikuesit, duke përfshirë të gjithë elementët përkatës tatimorë dhe duke marrë në konsideratë dokumentimin e veprave të rënda penale në lidhje me aktivitetin ekonomik të aplikuesit;
- termi “shkelje” do t’u referohet jo vetëm akteve/veprimeve të zbuluara nga autoritetet doganore gjatë ushtrimit të kontrollit doganor kur mallrat hyjnë në territorin doganor të Shqipërisë-së apo kur vendosen në procedurë doganore, por çdo shkelje e legjislacionit doganor, rregullave tatimore apo legjislacionit penal e konstatuar në rast të çdo kontrolli të kryer në një fazë të mëvonshme, si edhe çdo shkelje që mund të zbulohet përmes përdorimit të autorizimeve të tjera doganore, dhe çdo burim tjetër informacioni i disponueshëm për autoritetet doganore;
- do të mbahen gjithashtu në konsideratë shkelje të bëra nga spedicionerët, agjentët doganorë apo palë të treta që veprojnë për llogari të aplikuesit. Aplikuesi duhet të demonstrojë me fakte se janë marrë masat e duhura për të garantuar përputhshmërinë e personave që veprojnë për llogari të tij, si p.sh. udhëzime të qarta për palët, monitorimi dhe kontrolli i saktësisë së deklaratës dhe masat ndreqëse kur bëhen gabime;
- në rastet kur penaltetet/gjobat që lidhen me një shkelje specifike shqyrtohen nga autoriteti kompetent, pas një apeli apo shqyrtimi, vlerësimi i shkallës së shkeljes duhet të bazohet mbi atë vendim të rishikuar. Në rastet kur penalteteti për një shkelje tërhiqet plotësisht nga autoriteti kompetent, shkelja do të konsiderohet si të mos ketë ekzistuar;

Përpara se të merret një vendim nëse përmbushet apo jo kriteri i regjistrimit të përputhshmërisë është e nevojshme të bëhet një krahasim i shkeljeve në total që ka bërë aplikuesi kundrejt numrit total të veprimeve doganore të këtij aplikuesi gjatë së njëjtës kohë, me qëllim që vendoset një raport i drejtë. Në këtë kuadër, duhet të mbahen në konsideratë llojet e ndryshme të aktiviteteve përsa u takon numrit dhe volumit të deklaratave dhe veprimeve doganore të aplikuesit.

2.I.2. Shkelje të vogla

Shkelje të vogla përbëjnë ato veprime, të cilat edhe në rast se ka pasur vërtet një shkelje në çdo aspekt të legjislacionit doganor dhe rregullave tatimore të mos jetë aq e rëndësishme sa të konsiderohet si tregues risku, përsa i takon lëvizjes ndërkombëtare të mallrave, aspekteve të sigurisë apo borxhit doganor që kërkohet.

Për të përcaktuar se çfarë konsiderohet si shkelje e vogël, elementi i parë që duhet marrë në konsideratë dhe që duhet të trajtohet në vlerën e vet kundrejt historikut të operatorit,

natyrës së aktivitetit të biznesit dhe shkallës së operatorit ekonomik në fjalë. Në rast se merret një vendim sipas të cilit shkelja konsiderohet e papërfillshme, operatori duhet të tregojë masat që ka ndërmend të marrë për të ulur numrin e gabimeve në aktivitetin e tij doganor.

Kjo listë (checklist) që është indikative mund të shërbejë për t'u ardhur në ndihmë autoriteteve doganore gjatë vlerësimit të shkeljes, për të parë nëse ajo është e papërfillshme:

- nuk duhet të ekzistojë mashtrimi i qëllimshëm;
- shkelja nuk duhet të parë mbi baza kumulative, por përkundrejt totalit të volumit të veprimeve;
- të përcaktohet nëse shkelja ka qenë një rast i izoluar apo sporadik nga një person brenda organigramës së përgjithshme të kompanisë;
- duhet të mbahet në konsideratë gjithashtu edhe konteksti i shkeljes;
- aplikuesi duhet të ketë sistemet e veta të kontrollit të brendshëm dhe duhet të mbahet në konsideratë nëse shkelja është konstatuar nga vetë aplikuesi, si rezultat i kontrollit të tij të brendshëm dhe në rast se për këtë janë njoftuar menjëherë autoritetet doganore;
- nëse aplikuesi ka marrë masa të menjëhershme për të korrigjuar apo shmangur këto veprime në të ardhmen;
- natyra e shkeljes – autoritetet doganore duhet të marrin në konsideratë llojin dhe shkallën e shkeljes. Disa gabime mund të konsiderohen si “të papërfillshme” për shkak se nuk kanë ndikim në sasinë e tarifave doganore që duhet të paguhet, si p.sh. mosklasifikimi i duhur i dy mallrave me të njëjtën tarifë doganore dhe mos bërja e dallimit midis masave të tjera që aplikohen për to (si në rastin e ndalimeve apo kufizimeve). Shkelje të tjera mund të ndikojnë në shumën e tarifave që duhet të paguhet, por diferenca nuk konsiderohet si me rëndësi përse i takon numrit dhe volumit të deklaratave të bëra nga aplikuesi.

Në rast se si rezultat i vlerësimit të shkeljes, ajo konsiderohet si shkelje e lehtë, atëherë konformiteti konsiderohet si i realizuar.

Duke pasur parasysh sa më sipër dhe me kusht që në çdo rast të analizuar nuk ka rrethana të tjera që merren në konsideratë, rastet e mëposhtme të shkeljeve mund të merren si shembuj të shkeljeve doganore të shkallës së lehtë:

- dështime që konsiderohen se nuk kanë rëndësi të madhe për funksionimin e procedurave doganore, sipas përcaktimit në Nenin 6 (16) të Kodit Doganor;

- tejkalime të afateve që lejohen për mallrat në statusin e magazinimit të përkohshëm ose çdo limit tjetër kohor që zbatohet për mallrat me procedurë përpunimi aktiv ose pasive, me kusht që këto tejkalime të mos ndikojnë në përcaktimin e saktë të borxhit doganor për tu paguar;
- gabime të izoluara, që nuk janë të përsëritura nga ana e operatorit gjatë plotësimit të të dhënave të përfshira në deklaratat doganore që ka dorëzuar, me kusht që këto gabime të mos rezultojnë në një vlerësim jo të saktë të detyrimit doganor për tu paguar.

2.I.3. Shkelje të përsëritura

Në rast të shkeljeve të cilat fillimisht mund të konsiderohen si të lehta apo të papërfillshme, autoritetet doganore duhet të përcaktojnë nëse ka pasur në të kaluarën shkelje të ngjashme të përsëritura. Në këtë rast autoritetet doganore duhet të analizojnë nëse përsëritja është rezultat i veprimit të një apo disa personave të veçantë brenda kompanisë së aplikuesit apo nëse është rezultat i mangësive strukturore të sistemit të aplikuesit. Gjithashtu, autoritetet doganore duhet të zbulojnë nëse lloji i shkeljes është i përsëritur apo nëse shkak i shkeljes rastësor dhe pasi është evidentuar nga aplikuesi dhe janë marrë masat për zgjidhjen e tij si dhe mospërsëritjen në të ardhmen. Në të kundërt, në rast se shkelja përsëritet në periudha të ndryshme kohore, kjo mund të jetë tregues për probleme me menaxhimin e brendshëm të kompanisë, përsa i takon marrjes së masave të duhura për parandalimin e shkeljeve në fjalë.

Përsa u takon rregullave tatimore duhet të mbahet në konsideratë përkufizimi i dhënë nga autoritetit kompetent tatimor.

2.I.4. Shkelje të rënda

Gjatë vlerësimit të një shkeljeje të rëndë duhen marrë në konsideratë këta elementë:

a) Nëse është veprim i qëllimshëm

- veprim i qëllimshëm apo mashtrim i provuar që bëhet me dijeni dhe qëllim të plotë nga ana e aplikuesit, personi që ka caktuar aplikuesi apo që ushtron kontroll në administratën e tij, apo personi që aplikuesi ka vënë për tu marrë me çështjet doganore duhet të konsiderohet si shkelje më e rëndë sesa i njëjti rast në rrethana të tjera, edhe në rastet kur natyra e gabimit mund të konsiderohej si “e papërfillshme”;

b) Natyra e shkeljes

- Kur shkelja ka natyrë të tillë që mund të konsiderohet si shkelje e rëndë e legjislacionit doganor dhe rregullave tatimore, e cila kërkon vendosjen e një gjobe/penaliteti të rëndë apo procedim penal;

c) Neglizhencë e dukshme/ e hapur

- Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED)¹ ka përcaktuar tri faktorë që duhet të merren në konsideratë gjatë vlerësimit nëse një veprim i kryer nga operatori ekonomik ka qenë në neglizhencë të hapur: kompleksiteti i legjislacionit doganor, kujdesi i ushtruar nga biznesi dhe përvoja e tij. Në rast se autoritetet doganore gjykojnë se biznesi ka qenë haptazi neglizhent, ky mund të jetë një tregues që shkelja mund të konsiderohet si e rëndë;

d) Tregues i riskut të rëndë përsa i takon sigurisë ose mbrojtjes, apo doganat, rregullat tatimore dhe shkeljet e rënda që lidhen me veprimtarinë ekonomike.

- Shkelje të rënda mund të jenë edhe ato të cilat, pa qëllim nga ana e aplikuesit për të kryer mashtrim, janë aq të rëndësishme sa të konsiderohen si tregues i një risku të rëndë për sa u takon sigurisë apo doganave, rregullave tatimore dhe veprave penale në lidhje me veprimtarinë ekonomike.

Duke pasur në konsideratë sa më lart, me kusht që çdo rast të analizohet në mënyrë individuale dhe nuk ka rrethana të tjera që duhen mbajtur në konsideratë, rastet e mëposhtme të shkeljeve mund të merren si shembuj të shkeljeve të rënda:

DOGANAT

- kontrabanda;
- mashtrimi, p.sh. klasifikimi i gabuar qëllimisht, nënvlerësimi apo mbivlerësimi, deklarimi i rremë i origjinës për të shmangur tarifën doganore;
- shkelje që lidhen me të drejtën e pronësisë intelektuale (DPI);
- mashtrim në lidhje me rregulloret *antidumping*;
- shkelje në lidhje me ndalimet dhe kufizimet;
- falsifikim;
- vepra penale në lidhje me akcizat,
- çdo lloj vepre tjetër që lidhet me kërkesat doganore.

¹ Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në lidhje me neglizhencën e hapur: "C- 48/98 Söhl & Söhlke (1999)"

TATIMET

- mashtrim tatimor;
- evazion tatimor;
- mashtrim me TVSh-në,
- vepra të rënda penale në lidhje me aktivitetin ekonomik të aplikuesit;
- falimentim;
- çdo shkelje që lidhet me legjislacionin shëndetësor, si p.sh. hedhja në treg e mallrave të pasigurta;
- çdo shkelje që lidhet me legjislacionin mjedisor, si p.sh. kalimi i paligjshëm i kufirit për mbetje të rrezikshme;
- mashtrime që lidhen me rregulloren për përdorimin e dyfishtë;
- pjesëmarrje në organizata kriminale;
- mitmarrje dhe korrupsion;
- krimi kibernetik;
- pastrim i parave;
- përfshirje direkte apo e tërthortë në veprimtari terrorizmi (si p.sh. zhvillimi i bizneseve apo aktiviteteve të tjera që nxisin apo u vijnë në ndihmë grupeve terroriste të njohura ndërkombëtarisht);
- përfshirje direkte apo indirekte në promovimin apo ndihmesën e emigrimit të paligjshëm.

Seksioni II – Sistem i kënaqshëm i menaxhimit tregtar dhe kur është e përshtatshme, regjistrave të transportit, që lejon nivelin e duhur të kontrollit doganor.

2.II.1. Të përgjithshme

Për t'u ardhur në ndihmë autoriteteve doganore që të përcaktojnë nëse aplikuesi i ka nën kontroll siç duhet veprimet e tij dhe qarkullimin e mallrave përmes një sistemi të menaxhimit të të dhënave/regjistrave tregtare/ë, dhe sipas rastit, atyre të transportit që lejon kontrollin e duhur doganor, aplikuesi do të plotësojë të gjithë kërkesat e parashtruara nga Neni 41 gërma c të Kodit Doganor.

Gjatë verifikimit të këtij kriteri duhet të mbahen në konsideratë sa më poshtë:

- duhet të kontrollohet përkundrejt të gjithë veprimtarisë doganore të aplikuesit;
- autoritetet doganore duhet ta përdorin të gjithë informacionin që disponojnë për çdo autorizim që i është lëshuar tashmë aplikuesit. Në përgjithësi, nuk ka nevojë

që kjo pjesë e biznesit të kontrollohet rishtazi, në rast se auditimi i fundit është kryer kohët e fundit dhe nuk ka pasur ndryshime. Megjithatë, duhet të sigurohet që të gjitha aspektet/kushtet të jenë mbuluar nga auditimi i mëparshëm;

- rekomandohet që një pjesë e verifikimit të bëhet në vend, gjatë vizitës në kompani;
- kur auditimi bëhet në hapësirat e aplikuesit ka disa elementë të rëndësishëm që duhen marrë në konsideratë;
- verifikohet që informacioni që është dhënë në aplikim dhe në dokumentet e tjera të jetë i saktë dhe që rutina/procedurat e përshkruara nga aplikuesi të jetë e dokumentuar dhe e zbatuar në vend;
- teste të transaksioneve për tu siguruar që ka gjurmë të auditimit në dokumentacion;
- verifikohet që sistemi i IT të jetë i mbrojtur nga ndërhyrjet, manipulimet dhe që ngjarjet e historikut të jenë pjesë e sistemit, në mënyrë që ndryshimet të mund të monitorohen, nëse kjo është e nevojshme.

Përsa i takon kontrollit të kërkesave specifike të dhëna në Nenin 50 (1) , autoritetet doganore duhet që gjithmonë të mbajnë parasysh natyrën specifike të biznesit dhe shkallën/madhësinë e operatorit, duke pasur gjithashtu parasysh disa elementë të tjerë të zakonshëm.

2.II.2 Kushti i një sistemi të kënaqshëm për menaxhimin e regjistrave tregtare dhe atyre të transportit

Bazuar në pikën 1, gërma a, të nenit 50 të VKM NR.651/2017... kërkohet që “Aplikuesi mban një sistem kontabiliteti në përputhje me parimet e përgjithshme të pranuar të kontabilitetit të Republikës së Shqipërisë, që lehtëson kontrollin doganor të bazuar në auditim, dhe mban një raport historik të të dhënave, që sigurojnë një gjurmë të auditimit nga momenti që të dhënat hyjnë në regjistra

Në kontabilitet, gjurma e auditimit përfaqëson një proces rakordimi të çdo hyrjeje në regjistër me burimin, me qëllim lehtësimin e kontrollit të saktësisë. Një gjurmë e plotë auditimit gjurmon ciklin jetik të veprimeve operative të aplikuesit, në lidhje me ngarkesat, mallrat dhe produktet që hyjnë, përpunohen dhe dalin nga hapësirat e kompanisë. Shumë biznese dhe organizata kërkojnë një gjurmë auditimi për sistemet e tyre të automatizuara, për arsye sigurie. Është e rëndësishme të kombinohen kontrollet në sistemin e biznesit me kontrollet për sigurimin dhe mbrojtjes. Për qëllimet e sigurisë dhe mbrojtjes është e rëndësishme që aty ku është e mundur, informacioni në sistemin e

biznesit të pasqyrojë lëvizjen fizike të mallit, dërgesave dhe produkteve dhe kjo duhet të jetë pjesë e verifikimit. Gjithashtu është e rëndësishme që në rastet e duhura, informacioni në sistemin e biznesit të reflektojë lëvizjet e dërgesave, mallrave dhe produkteve, si edhe masat e marra për të garantuar sigurinë e tyre në faza të ndryshme të zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit, ku ka përfshirje të operatorit ekonomik të autorizuar. Kontrollat mbi transaksionin duhet të reflektojnë të dy këto aspekte dhe të garantojnë që kompania ndjek të njëjtën rutinë gjatë gjithë kohës. Gjurma e auditimit shërben për regjistrimin historik të të dhënave që i mundëson përdoruesit të ndjekë një pjesë të të dhënave nga momenti që ato hyjnë në sistemin e të dhënave, derisa dalin prej tij.

- a) Pika 1, gërma b, e nenit 50 të VKM nr.651/2017
- b) ...kërkon që *"të dhënat/regjistrat e mbajtur nga aplikuesi për llogari të doganave të jenë të integruar në sistemin e kontabilitetit të aplikuesit ose të bëjnë të mundur rakordimin e informacionit me sistemin kontabël"*.
- c) Pika 1, gërma (c) e nenit 50 të VKM NR.651/2017... kërkon *"nga aplikuesi t'u bëjë të mundur autoriteteve doganore akses fizik në sistemet e veta kontabël dhe, në rastet kur mundet edhe për regjistrat tregtarë dhe ata të transportit"*.

Shih pikën d) më poshtë.

- d) Pika 1, gërma (ç) nenit 50 të VKM nr.651/2017... kërkon *"që aplikuesi t'u bëjë të mundur autoriteteve doganore të kenë akses elektronik në sistemin e tij kontabël, dhe kur aplikohet edhe në regjistrat tregtarë dhe të transportit ku ato sisteme apo regjistra mbahen në mënyrë elektronike"*.

Aksesi në regjistrat e kompanisë përcaktohet si mundësia për të marrë informacionin që kërkohet, pavarësisht nga vendi ku ruhen fizikisht të dhënat. Informacioni i kërkuar përfshin regjistrat e kompanisë, si edhe çdo informacion tjetër përkatës që nevojitet për të kryer auditimin. Aksesi ka forma dhe natyrë të ndryshme:

- **me letër:** informacioni i kërkuar jepet me letër. Zgjidhja me letër është e përshtatshme kur sasia e informacionit që kërkohet është e kufizuar. Kjo situatë mund të ndodhë p.sh. kur kontrollohen llogaritë vjetore;

- **me mjete portabël për hedhjen e të dhënave:** një kopje e informacionit të kërkuar jepet me CD-ROM ose një media tjetër e ngjashme. Kjo zgjidhje përdoret kur kërkohet më shumë informacion dhe kjo kërkon përpunim të dhënash;

- **akses on-line:** përmes sistemit kompjuterik të kompanisë në rast të vizitës në vend, duke përdorur kanale elektronike për shkëmbimin e të dhënave, duke përfshirë edhe internetin.

Pavarësisht nga mënyra sesi sigurohet aksesit tek të dhënat, autoriteteve doganore duhet t'u garantohet mundësia e hetimit dhe analizës së të dhënave. Po kështu, është e rëndësishme që të dhënat e ofruara të jenë gjithmonë të përditësuara.

Për këtë kusht, në mënyrë specifike, duhet të mbahet në konsideratë natyra e SME-së. Kështu, p.sh., ndonëse të gjithë aplikantët që kërkojnë të marrin statusin e OEA-s do të duhet të demonstrojnë një sistem të mirë të mbajtjes së të dhënave/regjistrave për të bërë të mundur kontrollin doganor me baza auditimi, mënyra sesi kjo arrihet mund të ndryshojë. Për një aplikant të madh mund të duhet të ketë një sistem të integruar elektronik për mbajtjen e të dhënave në mënyrë që autoritetet doganore të bëjnë auditimin, ndërsa për një SME mund të mjaftojë një sistem i thjeshtë dokumentacioni, në letër, për doganat që të kryejnë kontrollin.

e) Pika 1, gërma (d), e nenit 50 të VKM NR.651/2017... kërkon nga *"aplikuesi të ketë një sistem logjistik që evidenton mallrat si mallra shqiptare ose jo shqiptarë dhe tregon, sipas rastit, vendndodhjen e tyre"*.

Duhet të vlerësohet sesi mallrat jo shqiptare apo mallrat subjekt të kontrollit doganor dallohen nga mallrat shqiptare. Sipas nenit 50 (2) e VKM NR.651/2017..., OEAS-të janë të përjashtuar nga ky kusht. Argumenti është që dispozitat që lidhen me sigurinë nuk bëjnë dallim mes mallrave shqiptare dhe atyre jo shqiptare. Kërkesat e sigurisë aplikohen për të gjitha mallrat që hyjnë apo dalin nga territori doganor i Shqipërisë, pavarësisht nga statusi i tyre.

Përsa u takon SME-ve, plotësimi i këtij kushti mund të konsiderohet si i përmbushur në rast se dallimi midis mallrave shqiptare dhe jo shqiptare mund të bëhet përmes një dosjeje të thjeshtë elektronike (file) ose përmes dokumentacionit në letër, me kusht që ato të menaxhohen dhe ruhen në mënyrë të sigurtë.

f) Pika 1 gërma (dh), e nenit 50 të VKM NR.651/2017 ... kërkon *"nga aplikuesi të ketë një organizim administrativ që përkon me llojin dhe shkallën e biznesit dhe që është i përshtatshëm për menaxhimin e qarkullimit të mallrave, si edhe garantimin e kontrollit të brendshëm për parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e gabimeve, si edhe parandalimin dhe zbulimin e transaksioneve të paligjshme apo të parregullta"*.

Vlen të theksohet se nuk ka "rregulla standarde" për organizimin administrativ. Elementi më i rëndësishëm që duhet të demonstrojë një aplikant është që organizimi i tij administrativ është i përshtatshëm/i duhuri, duke marrë në konsideratë modelin e biznesit të aplikuesit, për menaxhimin e qarkullimit të mallrave dhe që ka një sistem të përshtatshëm për kontrollin e brendshëm. Rrjedhimisht, përdorimi i "pragjeve sasiore", dmth., numri minimal i personelit, nuk është i përshtatshëm.

Pavarësisht nga sa më sipër, është e rëndësishme që aplikuesi të ketë dhe të zbatojë siç duhet procedura me shkrim dhe udhëzime pune, me përshkrime të qarta të proceseve, të kompetencave dhe përfaqësimit. Për bizneset mikro dhe ata të vegjël, këto pritshmëri mund të përmbushen me anë të mjeteve të tjera të përshtatshme që do të demonstrohen përpara Administratës Doganore.

Procedurat e kontrollit të brendshëm ndikojnë jo vetëm në funksionimin e drejtpërdrejtë të departamentit përgjegjës për operacionet që mbulohen nga legjislacioni doganor, por gjithashtu të gjitha shërbimet që kanë të bëjnë me menaxhimin e atyre aktiviteteve që lidhen me zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit në të cilin aplikuesi është i përfshirë. Ilustrimet e kontrollit të brendshëm janë të ndryshme dhe mund të nisin nga kontrolle të thjeshta tek kontrolle komplekse elektronike përputhshmërie.

Çdo parregullsi në administrim, duke përfshirë shkeljet doganore mund të jetë një tregues që sistemi i kontrollit të brendshëm nuk ka qenë efikas. Në këtë këndvështrim, çdo shkelje doganore duhet gjithmonë të vrojtohet edhe nga aspekti i këtij kushti, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, duke shmangur përsëritjen e kësaj shkeljeje.

g) Pika 1 gërma (e) ,neni 50 të VKM NR.651/2017.. kërkon, *"në rastet kur zbatohet, aplikuesi duhet të ketë procedura të kënaqshme për trajtimin e licencave dhe autorizimeve të dhëna sipas masave të politikave tregtare apo në lidhje me tregtinë në prodhimet bujqësore"*.

Mbi bazën e informacionit të dhënë në PyetëSORIN e Vetëvlerësimit , sipas Aneksit 13 , të Shtojcës C të VKM n.651/2017 dhe çdo informacioni tjetër të disponueshëm nga autoritetet doganore është e rëndësishme të evidentohet paraprakisht nëse aplikuesi tregton mallra që u nënshtrohen licencave të tregtisë ekonomike (si p.sh. në sektorin e tekstileve, ushqimore, ilaceve etj.). Në këtë rast, duhet të ekzistojnë procedura për administrimin e licencave që kanë të bëjnë me importin dhe/ose eksportin e mallrave. Nëse është e nevojshme, zbatimi në praktikë i këtyre procedurave duhet të verifikohet në vend.

Në rast të tregtisë me mallra specifike që u nënshtrohen licencave që do të lëshohen nga autoritete të tjera kompetente këshillohet që autoritetet doganore të konsultohen me to për informacion/feedback mbi aplikuesin.

h) Pika 1 gërma (ë) , e nenit 50, të VKMnr. 651/2017, ... kërkon *"Aplikuesi ka procedura efikase për arkivimin e të dhënave dhe informacionit dhe për mbrojtjen kundër humbjes së informacionit aplikuesi"*.

Duhen vlerësuar procedurat e arkivimit dhe marrjes së regjistrave dhe informacionit të aplikuesit, duke përfshirë edhe llojin e medias dhe softuerëve që përdoren për ruajtjen e të dhënave dhe nëse të dhënat mund të kompresohen, si edhe në çfarë faze. Në rast se përdoret një palë e tretë, gjithçka duhet të jetë e qartë, sidomos shpeshësia dhe vendndodhja e *back-up*-it për informacionin e arkivuar. Një aspekt i rëndësishëm i këtij kushti lidhet me shkatërrimin apo humbjen potenciale të informacionit të nevojshëm. Ndaj është e rëndësishme të kontrollohet nëse ka plan për sigurinë, duke përfshirë veprime dhe masa që duhet të merren në rast incidentesh dhe nëse ky plan përditësohet rregullisht. Duhet të kontrollohet gjithashtu edhe procedura që përdoret për *back-up*-in, sa herë nuk funksionojnë sistemet kompjuterike.

Pika 1, gërma (f) ,e VKM nr. 651/2017... kërkon *"Aplikuesi siguron që punonjësit përkatës të jenë udhëzuar të informojnë autoritetet doganore nëse zbulohen vështirësi të përmbushjes*

së kritereve dhe përcakton procedurat për informimin e autoriteteve doganore për vështirësi të tilla

i) *Aplikuesi*

Aplikuesi duhet të ketë procedura për njoftimin e autoriteteve doganore në rast të vështirësive me përputhshmërinë doganore, madje edhe një person kontakti që përgjigjet për njoftimin e autoriteteve doganore. Punonjësit e përfshirë në zinxhirin e furnizimit duhet të jenë të trajnuar për parandalimin e vështirësive të mundshme për të përmbushur kërkesat doganore. Të gjitha vështirësitë e evidentuara duhet t'i t'u raportohen personit(ave) përgjegjës dhe/ose zëvendësuesit të tij/tyre.

Ndaj, për këtë qëllim do të ishte mirë që detajet e kontaktit të personit të caktuar të jenë në dukje për stafin që merret me mallrat dhe për ata që merren me informacionin.

Për të identifikuar llojin e informacionit që duhet të raportojë një operator ekonomik, Neni 50 (1) (g) e VKM nr. 651/2017, kërkon që "*Aplikuesi ka miratuar masat e duhura të sigurisë për të mbrojtur sistemin kompjuterik të tij nga ndërhyrja e paautorizuar dhe për të siguruar dokumentacionin e aplikuesit.*

Duhet të ekzistojnë procedura për mbrojtjen e sistemit kompjuterik nga ndërhyrjet e paautorizuara dhe të sigurohen të dhënat. Këtu mund të përfshihet mënyra sesi aplikuesi kontrollon aksesin në sistemin kompjuterik përmes përdorimit të fjalëkalimeve, mbrojtjes nga ndërhyrjet e paautorizuara, si p.sh. përmes përdorimit të *firewalls* dhe anti-virusëve, si edhe mënyra sesi aplikuesi mban dosjet e arkivuara dhe siguron ruajtjen e dokumenteve. Këto masa sigurie nuk duhet të vlejnjë vetëm për harduerin që gjendet brenda kompanisë së aplikuesit, por edhe për mjetet lëvizëse që i krijojnë aplikuesit akses tek të dhënat (si p.sh. enkriptimin e *hard drive*-it për laptop, fjalëkalime për telefona smart).

Kompjuterët personalë (PC) duhet të mbyllen automatikisht pas një periudhe të shkurtër mospërdorimi. Gjithashtu, kompjuterët duhet të kenë një program antivirus të azhurnuar rregullisht dhe një sistem *firewall*. Konfigurimi i kompjuterëve duhet të administrohet në mënyrë të centralizuar.

Serverat duhet të vendosen në dhoma me çelës, me akses të limituar dhe kontrolluar vetëm për personat që janë të autorizuar, duke ndaluar hyrjen e personave të treta.

j) Neni 50 (1) (gj) e VKM nr. 651/2017, kërkon që "*Kur është e zbatueshme, aplikuesi ka procedura efikase për trajtimin e licencave të importit dhe eksportit lidhur me ndalimet e kufizimet, duke përfshirë masa për të dalluar mallrat që u nënshtrohen ndalimeve ose kufizimeve nga mallra të tjera dhe masa për të siguruar pajtueshmërinë me këto ndalime e kufizime aplikuesi*".

Trajtimi i licencave të import-eksportit që lidhet me ndalimet dhe kufizimet është përfshirë më parë në kriterin e sigurisë dhe mbrojtjes, dhe si i tillë kufizohet tek statusi i

OEAS, me qëllim parandalimin e shpërdorimit dhe dorëzimit të paligjshëm të mallrave delikate për arsye sigurie. Kjo duhet parë në lidhje të ngushtë me kontekstin e pikës 1, gërma 3, të Nenit 50, të VKM nr. 651/2017, d

Këto procedura mund të përfshijnë:

- dallimin midis mallrave që u nënshtrohen kërkesave jo-fiskale dhe mallrave të tjera;
- kontrollin nëse operacionet zhvillohen sipas legjislacionit aktual (jo-fiskal);
- në lidhje me trajtimin e mallrave që i nënshtrohen embargos;
- në lidhje me mallra të tjera që u nënshtrohen kufizimeve;
- evidentimi i mallrave me përdorim potencial të dyfishtë dhe procedurave për trajtimin e tyre.

Përsa i takon këtij kushti është e rëndësishme që stafi ta ketë të qartë rëndësinë e kërkesave jo-fiskale, klasifikimin e duhur/korrekt të mallit dhe të mbajë të azhornuara të dhënat kryesore. Bizneset që punojnë me llojin e mallrave të sipër përmendura duhet të organizojnë trajnime të vazhdueshme apo studime autodidakte në lidhje me legjislacionin.

Gjithashtu është e rëndësishme për operatorin ekonomik të mbetet në kontakt me autoritetet kompetente kombëtare përsa u takon kërkesave jo-fiskale, në rast se lind ndonjë problem në fazë të hershme. Kjo merr rëndësi të posaçme për kompanitë e tipit “start-up” apo për rastet kur operatorët ekonomikë janë duke zgjeruar portofolin e tyre.

Kur bëhet vlerësimi i këtij kushti, doganat duhet të konsultohen me autoritetet e tjera kompetente të përfshira në proces për të marrë sa më shumë informacion në lidhje me proceset e operatorëve ekonomikë.

Seksioni III – Aftësia e provuar paguese (shlyerja)

2.III.1. Të përgjithshme

Siç përcaktohet në shkronjën (ç,) të Nenit 41, të K D, një operator ekonomik i autorizuar (OEA) duhet ta provojë aftësinë e tij paguese, gjë që i bën të mundur operatorit të përmbushë angazhimet e tij në lidhje me karakteristikat e llojit të biznesit në fjalë. Në Nenin 51 të VKMnr. 651/2017, ... përshkruhen më me hollësi parashikimet e Administratës Doganore përsa i takon kriterit të përcaktuar në shkronjën (ç), të Nenit 41 të K.D.

Për të konstatuar nëse aplikuesi e plotëson kriterin e përcaktuar në Nenin 51 të VKM nr. 651/2017, ..., autoritetet doganore do të marrin në konsideratë sa më poshtë vijon:

a) aplikuesi nuk është subjekt i procedurave të falimentimit;

b) gjatë tri viteve të fundit, para dorëzimit të aplikimit, aplikuesi i ka përmbushur detyrimet e tij financiare për pagesat e detyrimeve doganore dhe të gjitha detyrimet e tjera, taksat apo pagesat, të cilat janë mbledhur ose që kanë lidhje me importin apo eksportin e mallrave;

c) aplikuesi, në bazë të regjistrimeve dhe informacioneve në dispozicion për tre vitet e fundit, para dorëzimit të aplikimit, ka qëndrueshmëri të mjaftueshme financiare për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet e tij, duke pasur parasysh llojin dhe vëllimin e aktivitetit të biznesit, duke përfshirë që nuk ka asete negative neto, përveç rasteve kur ato mund të mbulohen.

Nëse aplikuesi ka më pak se tre vjet nga themelimi i tij, situata e tij/saj financiare do të gjykohet mbi bazën e regjistrave dhe informacionit të disponueshëm.

Duhet të theksohet se termi "mungesa e aftësisë për të paguar" në kuptimin e këtij seksioni të udhëzimit nuk duhet të konsiderohet si i barasvlershëm me "falimentimin", që do të thotë mungesë e aftësisë së një kompanie për të paguar kreditorët e vet, e shpallur kjo në mënyrë ligjore, zakonisht nga gjykata. Për këtë kriter, fokusi është më shumë në lidhje me aspektin teknik të mungesës së aftësisë për pagesë dhe në riskun e mundshëm që kjo të ndodhë, për shkak të situatës ekonomiko-financiare, që do të bëjnë që një operator ekonomik të mos jetë në gjendje të shlyejë borxhin. Në këtë kontekst, çdo indicie apo e dhënë që një operator ekonomik nuk është në gjendje apo që në të ardhmen e afërt nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e veta financiare duhet të vlerësohet me kujdes.

2.III.2. Burimet e informacionit

Kur merret në konsideratë kriteri i provës së aftësisë paguese është e rëndësishme që i gjithë informacioni, kur është e përshtatshme, të konsiderohet si një i tërë për të pasur një panoramë të plotë. Nuk duhet të merret në konsideratë një tregues i veçuar dhe vendimet duhet të merren mbi pozitën e përgjithshme të aplikuesit, me qëllim kryesor që kur operatori në fjalë të marrë statusin e OEA-s, të ketë mundësi të vijoje të përmbushë detyrimet e tij.

Për vlerësimin e këtij kriteri, autoritetet doganore mund të varen nga burime të ndryshme, si p.sh:

- të dhëna zyrtare të paaftësisë paguese, likuidimeve dhe administrime;
- të dhënat për pagesën e detyrimeve doganore dhe detyrimeve tjera, taksave apo tarifave që arkëtohen në lidhje me import-eksportin e mallrave gjatë tri viteve të fundit;

- pasqyrat e publikuara financiare dhe bilancet e aplikuesit të periudhës së tre viteve të fundit, për të analizuar aftësinë paguese të aplikuesit për shlyerjen e detyrimeve ligjore;
- llogaritë e përkohshme ose llogaritë e administrimit, në veçanti në raporte të periudhave të ndërmjetme dhe fluks arke (*cash flow*), bilancet dhe parashikimet e humbjeve dhe fitimeve të miratuara nga drejtorët/partnerët/pronari i vetëm, në veçanti kur pasqyrat e fundit financiare nuk japin evidencat e duhura të pozicionit aktual financiar apo kur aplikuesi ka ngritur një biznes të ri;
- rastet kur aplikuesi financohet nga një kredi nga një institucion financiar;
- konkluzionet e agjencive të klasifikimit të kredisë, shoqatat e mbrojtjes së kreditorit apo çdo *ranking* nga autoritetet përkatëse publike;
- çdo informacion financiar i aksesueshëm, si p.sh. të dhëna ligjore, baza të dhënash *online*, lajme financiare etj.
- fakte të tjera nga aplikuesi, si p.sh. një garanci nga kompania mëmë (ose grupi) ku të demonstron shlyerja/aftësia paguese e aplikuesit.

2.III.2.1. Aplikuesi nuk i nënshtrohet procedurës së falimentimit

Në rast se aplikuesi i është nënshtuar një procedure falimentimi apo likuidimi, kriteri i aftësisë paguese, sipas përkufizimit në shkronjën (ç), të Nenit 41 të K D dhe pikës 1, të Nenit 51 të VKM nr. 651/2017, ... konsiderohet që nuk plotësohet.

Nëse aplikuesi i nënshtrohet çdo forme të mungesës së aftësisë paguese, zbatimi i kriterit të sipërpërmendur duhet të shtjellohet më tej, si p.sh. një administrim i kontrolluar nga një person i përzgjedhur nga gjykata. Është e rëndësishme të mblidhen informata mbi rrethanat që kanë çuar në fillimin e këtyre procedurave (recesion ekonomik, falimentim i kompanisë mëmë, ndryshime të përkohshme dhe të papritura të trendit të tregut), dhe shumat që detyrohet. Shumat që detyrohet duhet të krahasohen me shumat e llojeve të ndryshme të aseteve të aplikuesit, si p.sh. asetet korrente (*cash* dhe instrumente të tjera likuide, duke përfshirë të arkëtueshmet, që mund të konvertohen në para *cash*, brenda maksimumi një viti), aktivet afatgjata (prona, fabrika, pajisje dhe asete të tjera kapitale, amortizimi), aktivet e patrupëzuara (asete me një vlerë të përcaktuar, por që mund të mos realizohen, si p.sh. patentat, të drejtat e pronësisë, njohja e emrit të markës) dhe parapagimet (shpenzime për kosto në të ardhmen, si sigurimet, interesi, qiraja).

2.III.2.2. Pagesat e detyrimeve doganore dhe tarifave të tjera të arkëtueshme në lidhje me import-eksportin e mallrave

Autoritetet doganore mund të përcaktojnë nëse aplikuesi ka paguar apo ka qenë më vonesë në pagesën e taksave dhe tarifave doganore gjatë tri viteve të fundit. Këtu përjashtohen shumat që nuk njihen ligjërisht apo që janë në proces apelimi. Në rast apelimi, kur vendimi është i pezulluar nga autoritetet doganore, duhet të kontrollohet nëse ka pasur një garanci për të mbuluar doganat. Në rast se nuk ka pasur një garanci të tillë, sipas kuptimit të pikës 3, të Nenit 46, të K D duhet të konsultohet raporti që argumenton këtë çlirim.

Në përgjithësi, kur aplikuesi nuk ka paguar detyrimet ligjore, kriteri i aftësisë së provuar paguese do të konsiderohet si i papërbushur. Megjithatë, argumentet për mospagesë apo pagesa të vonuara duhet të shqyrtohen për të përcaktuar ekzistencën e rrethanave të pranueshme zbutëse. Ndër këto mund të përfshihen:

- një problem afatshkurtër apo një rast i vetëm pamundësie për të paguar, gjë që nuk vë në dyshim statusin financiar dhe besueshmërinë e aplikuesit;
- në rastet kur aplikuesi ka pasur vonesa në pagesa për shkak të një gabimi administrativ dhe jo për shkak të mungesës së aftësisë paguese, kjo nuk duhet të ndikojë në përbushjen e këtij kriteri.

Ekziston mundësia që një kompani të aplikojë për lehtësim pagese duke kërkuar shtyerjen e saj, sipas kushteve të neneve 104-105 të K D. Nëse këto rrethana ekzistojnë kjo nuk do të thotë që automatikisht aplikuesi të konsiderohet me mungesë aftësie paguese dhe për rrjedhojë të mos i jepet statusi i OEA-s.

Megjithatë, përveç lehtësirave për pagesat, në raste të tjera detyrimet duhet të paguhen brenda periudhës së caktuar ligjore. Detyrimet e përcaktuara sipas dispozitave të Kodit Doganor do të konsiderohen të lidhur jo vetëm me vetë pagesën, por edhe me afatet kohore për të kryer këtë pagesë. Çdo rast moszbatimi i këtyre afateve duhet të konsiderohet në kontekstin e përbushjes së detyrimeve të përgjithshme doganore të aplikuesit.

Në rastet kur është e zbatueshme, nëse kompania ka kërkuar rimbursim të detyrimeve apo taksave doganore që kanë të bëjnë me import-eksportin e mallrave, evidencat e këtyre rimbursimeve mund të hulumtohen më tej nga Administrata Doganore.

2.III.2.3. Aplikuesi mund të demonstrojë një pozitë financiare që i mundëson të përmbushë detyrimet dhe angazhimet e tij

Autoritetet doganore janë në gjendje të përcaktojnë nëse aplikuesi është në gjendje të plotësojë detyrimet e tij ligjore ndaj palëve të treta, duke kontrolluar pasqyrat financiare të aplikuesit, gjatë tri viteve të fundit:

- kur kërkohet nga Ligji për Shoqëritë Tregtare, bilancet duhen dorëzuar brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj. Mosparaqitja e bilanceve brenda afateve të kërkuara kohore është tregues që biznesi mund të ketë probleme me regjistrat e veta, ose mund të jetë në vështirësi financiare. Në rast mosrespektimi të afateve, autoritetet doganore duhet të marrin masa të mëtejshme për të hetuar mbi arsyet e mosrespektimit;
- çdo raport ose koment nga ana e auditit në lidhje me vijimësinë e biznesit, që aludon dyshime në lidhje me aftësinë paguese të një biznesi. Në këtë rast, autoriteti doganor duhet të hetojë mbi arsyet e gjetjeve duke vënë në peshë në raport me rëndësinë e biznesit;
- çdo pasiv i mundshëm që tregon mundësinë që ka aplikuesi për të bërë pagesa të borxheve në të ardhmen;
- çdo dokument shtesë financiar, si p.sh. deklarata e të ardhurave apo fluksi i arkës (*cash floë*) mund të përdoret për vlerësimin e situatës financiare të kompanisë;
- çdo analizë raporti (si p.sh. raporti aktual (aktivet korrente pjesëtuar me pasivet korrente) që mat mundësitë e kompanisë për të plotësuar detyrimet aktuale nga asetet likuide);
- çdo konkluzion tjetër që vjen nga institucionet financiare apo ato kërkimore;
- tregues të tjerë me interes për tu vlerësuar, si p.sh. nëse kompania ka qenë në grevë, apo nëse kompania ka humbur projekte të rëndësishme ku ka qenë e përfshirë, apo nëse kompania ka humbur disa nga furnitorët e mëdhenj dhe të rëndësishëm të saj.

Nëse aplikuesi përdor një procedurë të posaçme, siç është tranziti, apo magazinimi doganor, në përgjithësi, aplikuesi duhet tashmë ta ketë demonstruar mundësinë e burimeve të mjaftueshme financiare për të plotësuar detyrimet e tij, sipas këtyre procedurave. Kështu p.sh. për tranzitin e brendshëm, nëse aplikuesit i është lëshuar një autorizim për të përdorur garancinë globale, garancinë e reduktuar ose cdo lloj garancie tjetër sipas përcaktimeve në nenet 84 – 94 të K D, kjo gjë duhet të mbahet në konsideratë nga autoritetet doganore, sepse tregon që aplikuesi ka demonstruar tashmë posedimin e burimeve të mjaftueshme financiare për të përmbushur detyrimet që mund të lindin gjatë procedurës së tranzitit. Në këto raste dhe nëse aplikuesi nuk ka aktivitete të tjera që

lidhen me doganat nuk ka nevojë që autoritetet doganore të ri-shqyrtojnë apo të bëjnë kontrolle të tjera.

2.III.2.4. Aplikuesi nuk ka asete neto negative, me përjashtim kur mund të mbulohen

Autoritetet doganore duhet të marrin në shqyrtim dy tregues kryesorë në lidhje me pasqyrat financiare dhe bilancin e pagesave, për të vlerësuar kriterin e aftësisë së provuar të pagesës: pozitën e aktiveve neto korrente (aktivet korrente minus pasive korrente) dhe pozitën e aktiveve neto (totali i aktiveve minus totalin e pasiveve).

- pozicioni i aseteve neto korrente është një tregues i rëndësishëm për të kuptuar nëse aplikuesi ka kapital të mjaftueshëm për kryerjen e veprimtarive të tij ditore. Autoritetet doganore duhet të bëjnë një krahasim midis aktiveve korrente neto gjatë tre llojeve të llogarive, për të evidentuar tendencat e rëndësishme gjatë tri viteve dhe për të shqyrtuar arsyet për këto ndryshime, nëse aktivet neto korrente kalojnë nga një situatë pozitive në negative, apo nëse aktivet neto korrente bëhen gjithmonë e më shumë negative. Kjo mund të ndodhë për shkak të kushteve tregtare apo rritjes së kostove. Autoritetet doganore duhet të bëjnë një vlerësim për të kuptuar nëse kjo ndodh për shkak të faktorëve afatshkurtër apo nëse kjo ndikon në likuiditetin afatgjatë të biznesit;
- pozicioni i aktiveve neto është një tregues i rëndësishëm i qëndrueshmërisë financiare afatgjatë të aplikuesit dhe aftësisë së tij për të paguar borxhet. Që një biznes të plotësojë kriterin e aftësisë së provuar paguese duhet të ketë asete neto pozitive. Në rastet kur asetet neto përfshijnë aktive të patrupëzuara të rëndësishme, si p.sh. emrin e mirë (GoodWill) autoritetet doganore duhet të mbajnë në konsideratë nëse këto aktive të patrupëzuara kanë ndonjë vlerë reale tregu. Autoritetet doganore duhet gjithashtu të mbajnë në konsideratë natyrën e biznesit dhe jetëgjatësinë e tij. Në disa rrethana mund të jetë praktikë e zakonshme që një biznes të ketë asete neto negative, si p.sh. kur një kompani themelohet nga kompania mëmë për qëllime kërkimore dhe zhvillimore, kur pasivet mund të financohen nga një hua nga kompania mëmë apo nga një institucion financiar. Po kështu, bizneset e reja shpesh mund të fillojnë tregtinë me humbje, me asete neto negative, sapo ato krijohen, ndërsa zhvillojnë produktet e tyre apo krijojnë bazën e klientelës, përpara se të fillojnë të kenë fitime për investimet e tyre në vitet në vijim. Në këto rrethana, asetet negative neto mund të mos jenë tregues që duhen theksuar për të treguar se një biznes nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet e tij ligjore.

Llogaritë e përkohshme apo llogaritë e administrimit më të fundit midis deklaratave të fundit të firmosura financiare dhe datës aktuale duhet të merren gjithashtu në shqyrtim, për të përcaktuar nëse ka pasur ndryshime të rëndësishme në pozitën financiare të aplikuesit, të cilat mund të kenë ndikim tek aftësia e provuar paguese .

Në rast se aplikuesi ka shqetësime, ai mund të ndërmarrë një sërë masash për të përmirësuar pozitën e tij të aseteve neto. Kështu, p.sh. mund të gjenerohet kapital shtesë. Për kompanitë shumëkombëshe, asetet neto negative shpesh mund të krijohen nga transaksionet apo pasive midis grupit. Në këto rrethana, pasivet shpesh mund të mbulohen nga një garanci nga kompania mëmë (apo grup tjetër).

2.III.3. Financim me kredi/hua nga një person tjetër apo institucion financiar

Nëse aplikuesi financohet nga një hua nga një person apo institucion tjetër financiar, autoritetet doganore mund të kërkojnë një kopje të rastit të biznesit dhe dokument nga banka e aplikuesit, apo ndonjë dokument tjetër të barasvlershëm. Autoritetet doganore duhet të krahasojnë kazusin e biznesit dhe/ose dokumentin e kredisë me cash flow, bilancin dhe parashikimet e fitimit-humbjeve më të fundit, për të garantuar që aplikuesi funksionon brenda një overdraft-i të miratuar dhe është në përputhje me parashikimet momentin që ka përfunduar kazusin e biznesit. Rastet kur ka dallime të rëndësishme duhen hetuar.

Megjithatë, autoritetet doganore mund të kërkojnë evidenca të mëtejshme, si p.sh. letër dorëzanie nga një huadhënës apo nga ndonjë bankë dhe të përcaktojnë periudhën e kredisë dhe termat dhe kushtet e saj. Autoritetet doganore duhet të kontrollojnë pozitën e raportuar në llogari, për të parë konsistencën me dorëzanimin apo instrumentin bankar. Në rastet kur aplikuesi është pronar i vetëm, apo kur partneriteti dhe asetet personale përdoren për të mbështetur likuiditetin e biznesit, autoritetet doganore duhet të posedojnë një listë të aseteve personale dhe të binden që kjo listë është e besueshme.

Nga kompania mund të kërkohet informacion shtesë në lidhje me huanë, si p.sh. emri i kreditorit, qëllimi i kredisë dhe kushtet e saj. Ky informacion duhet të kontrollohet dhe krahasohet me dokumente të tjera financiare (si p.sh. bilancet, deklaratat e fitimit dhe humbjeve), për të mundësuar një vlerësim të situatës globale financiare të operatorit ekonomik.

2.III.4. Letrat e patronazhit dhe garancitë nga kompania mëmë (apo ndonjë grup tjetër)

Letrat e patronazhit janë dokumente që lëshohen zakonisht nga kompania mëmë (apo ndonjë grup tjetër), që afirmojnë qasjen e një kompanie vartësie të kompanisë mëmë për financim. Letrat e patronazhit janë të zakonshme në rastet kur kompania e kontrolluar ka asete negative neto dhe përdoren për të mbështetur opinionin e auditit si fakt për opinionin e auditit që kompania ka burime të mjaftueshme financiare për të vijuar punën si zakonisht. Ato mund të jenë të kufizuara në kohë. Ato përfaqësojnë një deklaratë me shkrim të qëllimit për të vijuar mbështetjen financiare të kompanisë që aplikon, por nuk janë detyrimisht dokument detyrues ligjor.

Gjatë gjyqimit të aftësisë së provuar paguese të një dege të kontrolluar duhet të mbahet në konsideratë se kjo kompani mund të operojë me garanci nga kompania mëmë dhe

autoritetet doganore mund të kontrollojnë llogaritë e asaj kompanie mëmë që jep mbështetje për tu siguruar që i ka mundësitë për ta bërë një gjë të tillë.

Vlen të theksohet se letrat e patronazhit shpesh nuk përfaqësojnë marrëveshje detyruese kontraktuale ligjore dhe rrjedhimisht nuk përbëjnë një garanci të zbatueshme nga ana juridike. Në rastet kur aplikuesi është i varur nga mbështetja financiare e kompanisë mëmë (apo ndonjë grup tjetër), për të plotësuar kriterin e aftësia së provuar paguese, autoritetet doganore, kur është e përshtatshme duhet të garantojnë që mbështetja që jepet është detyrim juridik dhe marrëveshje kontraktuale. Në rast të kërkesës së një garancie si evidencë mbështetjeje nga kompania mëmë (apo ndonjë grup tjetër), ajo duhet të jetë detyruese nga pikëpamja juridike, sipas legjislacionit kombëtar të shtetit anëtar ku pranohet, përndryshe nuk mund të mbahet në konsideratë gjatë vlerësimit të plotësimit të këtij kriteri. Për të qenë dokument detyrues ligjor, dhe marrëveshje kontraktuale duhet të përmbajë një dispozitë për pagesën pa kushte të detyrimeve të degës. Në kohën e nënshkrimit duhet të jetë përgjegjësia ligjore e palës që nënshkruan pagesa e çdo borxhi doganor që nuk është shlyer nga aplikuesi.

2.III.5. Aplikuesi është i themeluar në Republikën e Shqipërisë për një periudhë më pak se tre vjet

Në rastet kur aplikuesi është i themeluar në territorin e Republikës së Shqipërisë për më pak se tre vjet nuk është e mundur të bëhet një kontroll i detajuar financiar, siç do të ishte në rastin e kompanive që kanë më shumë vite që janë krijuar. Mungesa e informacionit në lidhje me historikun financiar të aplikuesit e rrit nivelin e riskut për autoritetet doganore. Në këto rrethana, aftësia e provuar paguese do të gjykohet sipas pikës 2, tënenit 51, të VKM nr. 651/2017, , mbi bazën e të dhënave dhe informacionit që disponohet momentin e paraqitjes së aplikimit. Këtu mund të përfshihen raporte afatmesme dhe *cash floë*, bilanci dhe parashikimet për humbjet dhe fitimet më të azhornuara, të paraqitura nga drejtorët/partnerët/pronari i vetëm.

Autoritetet doganore duhet t'u kushtojnë vëmendje edhe atyre aplikimeve nga biznese që kanë hyrë në proces likuidimi, për të shmangur pasivet dhe që kanë nisur edhe një herë nga e para me një emër tjetër. Në rastet kur autoritetet doganore kanë informacion që personat që kontrollojnë aplikuesin kanë pasur kontroll të mëparshëm mbi një biznes që bie në këtë kategori dhe biznesi i ri është i njëjti si personi i mëparshëm juridik që ka hyrë në proces likuidimi, ky informacion mund të përdoret për të parë nëse aplikuesi ka një pozitë financiare mjaftueshmërisht të shëndoshë për të përmbushur kriterin e aftësisë së provuar paguese.

Nga ana tjetër, autoritetet doganore duhet të mbajnë parasysh rastin kur aplikuesi ka më pak se tre vjet ekzistencë, si rezultat i një ri-organizimi të kompanisë, por që aktiviteti ekonomik ka mbetur i pandryshuar. Për vlerësimin e këtij kriteri, autoritetet doganore mund të shqyrtojnë llogaritë e kompanisë, llogaritë e administrimit, pasqyrat financiare apo dokumente të tjera të kompanisë së mëparshme, me kusht që të mos ketë ndryshuar aktiviteti ekonomik.

Seksioni IV – Standarde praktike kompetencash apo kualifikimesh profesionale që lidhen direkt me aktivitetin që kryejnë

2.IV.1. Të përgjithshme

Shkronja (d), e Nenit 41 të VKM nr. 651/2017, kërkon ekzistencën e një kriteri shtesë për autorizimin OEAD në lidhje me standardet praktike të kompetencave/aftësive profesionale dhe kualifikimeve profesionale që lidhen direkt me aktivitetin. Sipas nenit 52 të VKM nr. 651/2017, kriteri konsiderohet i përmbushur, nëse plotësohet një prej kushteve të mëposhtme:

a) Aplikuesi ose personi i ngarkuar me çështjet doganore të aplikuesit plotëson një nga standardet praktike të kompetencës në vijim:

- ka një eksperiencë praktike të provuar me një minimum prej 3 vitesh në çështjet doganore;
- ka standardet e cilësisë në lidhje me çështjet doganore të miratuara nga një organ i standardizimit shqiptar apo evropian.
- është i licencuar nga DPD bazuar në kriteret e udhezimit nr.05 date 28.03.2019 “për zbatimin praktik të procedurave për miratimin dhe funksionimin e përfaësimit në doganë”

b) Aplikuesi ose personi i ngarkuar me çështjet doganore të aplikuesit ka përfunduar me sukses trajnimin që mbulon legjislacionin doganor në fuqi, në masën e përfshirjes së tij në aktivitetet që kanë të bëjnë me doganat, të mbajtura nga një nga organet në vijim:

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- një institucion shkollor i njohur për qëllime të sigurimit të kualifikimit të tillë nga DPD-ja ose një institucion publik përgjegjës për trajnim profesional;
- një shoqatë profesionale apo tregtare e njohur nga DPD-ja ose e akredituar në Republikën e Shqipërisë, me qëllim dhënien e një kualifikimi të tillë.

c) Në rastet kur aplikuesi përdor një person të kontraktuar, kriteri do të konsiderohet si i përmbushur në rast se personi i kontraktuar është një OEAD.

Të gjitha mundësitë konkrete për të treguar plotësimin e secilit prej dy kushteve (standardet praktike të kompetencave apo kualifikimeve profesionale) janë të barasvlershme dhe mund të zgjidhen nga aplikuesi; megjithatë, ato duhet të reflektojnë përfshirjen specifike të aplikuesit në aktivitetet që lidhen me doganat dhe rolin e tij në zinxhirin e furnizimit, statusin e tij dhe procesin e organizimit të biznesit në kompaninë e aplikuesit.

Vlen të theksohet se personi që përgjigjet për aspektin doganor të aplikuesit mund të jetë një nga punonjësit e aplikuesit ose një person i kontraktuar. Aplikuesi duhet të provojë që

personi i kontraktuar është personi që përgjigjet për çështjet/aspektin doganor të aplikuesit.

2.IV.2. Standardet praktike

2.IV.2.1. Eksperiencë praktike e provuar, prej të paktën tre vjetësh në çështje që lidhen me doganat

Me “standarde praktike” nënkuptohet që aplikuesi ose personi që përgjigjet për aspektet doganore të biznesit të aplikuesit duhet të demonstrojë që ka përvojë në lidhje me aspektin doganor. Nuk mjafton thjesht njohja teorike e legjislacionit doganor. Megjithatë, një përvojë minimale në aspektin doganor nuk ka të bëjë me periudhën menjëherë përpara paraqitjes/dorëzimit të aplikimit, por mund të ketë afat kohor më të gjatë. Përvoja e personit do të duhet të vlerësohet nga Administrata Doganore.

Përvoja tre vjeçare duhet të përfshijë rolin e aplikuesit në zinxhirin e furnizimit, si psh:

1. një eksportues/prodhues sipas përkufizimit të këtij udhëzimi mund të provojë tre vjet përvojë në praktikë si mbajtës i një autorizimi për hyrjen tek të dhënat e deklaruesit, duke hequr detyrimin që mallrat të paraqiten për përdorimin e procedurës doganore të eksportit për një periudhë së paku trevjeçare apo të luajë rolin e “eksportuesit” në një procedurë të zakonshme/normale doganore eksporti gjatë tri viteve të fundit.
2. Agjenti doganor sipas përkufizimit të këtij udhëzimi mund t’i provojë tre vjet përvojë me anë të një autorizimi për thjeshtimin doganor (në rastet kur është e zbatueshme) ose duke qenë i kontraktuar në këtë fushë për një periudhë minimalisht tre vjeçare.
3. Një transportues sipas përkufizimit të këtij udhëzimi mund ta demonstrojë përvojën e tij në praktikë, nëse ai është mbajtës i një autorizimi për procedurë të thjeshtuar në lidhje me tranzitin doganor apo një dërgues i autorizuar sipas Konventës TIR, gjatë tre viteve të fundit, apo që ka një kontratë dhe ka lëshuar dokumente transporti, si edhe deklarata përmbledhëse gjatë tre viteve të fundit.

Verifikimi i përmbushjes/plotësimit të kriterit

Vlen të theksohet se verifikimi i plotësimit të kriterit lidhet vetëm me kohëzgjatjen e përvojës profesionale. Shkeljet apo devijime të ndryshme nga plotësimi i kriterit nuk e ndikojnë përvojën profesionale trevjeçare, por duhet të mbahen në konsideratë gjatë ekzaminimit të plotësimit të kriterit në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, rregullave tatimore dhe sistemet e kontrollit të brendshëm që trajtohen në këtë udhëzim .

a) Aplikuesi

Në rast se personi që duhet të plotësojë kushtin e tre viteve përvojë praktike në lidhje me çështjet doganore është aplikuesi, në formën e personit juridik apo fizik, ai mund të demonstrojë përmbushjen e këtij kushti me një apo më shumë nga mundësitë e mëposhtme:

Në rast të paraqitjes së një aplikimi duhet të merren në konsideratë elementët e mëposhtëm alternativë:

- Kryerja e aktivitetit doganor (si p.sh. import/eksport/tranzit) apo e formaliteteve doganore, së paku për tre vjet. Për vlerësimin e tri viteve përvojë në çështjet doganore, Administrata Doganore të mbajë në konsideratë llojin e aktivitetit të biznesit për të cilin bëhet fjalë (p.sh. aktivitet permanent apo sezonal, pak deklarata por me vlerë të lartë). Një provë tjetër mund të jetë edhe numri NUIS/EORI i aplikuesit në kutitë 2, 8, 14 apo 50 të deklaratës doganore apo pagesa e detyrimeve doganore dhe/ose garancive e siguruar për të drejtat doganore. Vlen të theksohet se prania e thjeshtë e aplikuesit në një prej kutive të sipër përmendura të deklaratës doganore nuk do të nënkuptojë që aplikuesi është direkt i përfshirë në kryerjen e formaliteteve doganore. Në këtë rast është e rëndësishme që doganat të dinë nëse formalitetet doganore kryhen nga aplikuesi (brenda kompanisë) apo nga palët e treta (si p.sh. agjentët doganore). Në rast se është kjo e dyta, aplikuesi nuk përjashtohet nga përgjegjësia që formalitetet të kryhen siç duhet. Me fjalë të tjera, nëse formalitetet doganore kryhen nga palë të treta herë pas here dhe rrjedhimisht nuk mbulohen nga përkufizimi i personit të kontraktuar, ky kriter mund të plotësohet nga aplikuesi në rast se ka një organizim të brendshëm që lejon supervizionin dhe kontrollin e formaliteteve doganore nga palë të treta.
- kur është mbajtës i një autorizimi të posaçëm që lëshohet në kuadrin e zbatimi të Kodit Doganor dhe që lidhet me VKM nr. 651/2017, , për së paku tre vjet, në lidhje me aktivitetin doganor të realizuar.
- shërbimet e ndërmjetësimit doganor për së paku tre vjet, gjë që mund të provohet përmes deklaratave doganore dhe gjithë dokumenteve të tjera të nevojshme; evidencë pagese/apo garanci e siguruar për të drejtat doganore, prania e numrit EORI në kutinë nr. 14 të deklaratës doganore.

Organizimi i transportit të mallrave në tregtinë ndërkombëtare për llogari të një eksportuesi, një importuesi apo një personi tjetër, kontrollon dhe përgatit dokumentacionin për të përmbushur kërkesat e doganës dhe/ose vepron si transportues dhe lëshon kontratën e vet të transportit gjë që mund të kontrollohet përmes policës apo faturës së ngarkesës, dokumenti i transportit ajror.

Autoritetet doganore duhet të përdorin gjithë informacionin dhe të dhënat që disponojnë në lidhje me autorizimet që i janë dhënë aplikuesit dhe deklaratën e paraqitur mbi bazën e bankës së të dhënave dhe sistemeve elektronike.

Një tjetër element që doganat duhet të mbajnë në konsideratë është dokumenti zyrtar i aplikuesit që përcakton qartazi aktivitetin e tij ekonomik dhe objektivin e përgjithshëm të kompanisë së aplikuesit (si p.sh. një ekstrakt nga regjistri zyrtar, nëse ekziston).

Në rast se aplikuesi ka më pak se tre vjet jetë nga koha e themelimit, si pasojë e një ri-organizimi të kompanisë, autoritetet doganore do të marrin në konsideratë aktivitetet doganore që ka pasur kompania e mëparshme si të pandryshuara.

b) Personi që përgjigjet për çështjet doganore të aplikuesit (deklarim i drejtëpërdrejtë)

1) punonjësi i aplikuesit që përgjigjet për çështjet doganore

Kriteri mund të plotësohet edhe nga një punonjës i aplikuesit që përgjigjet për aspektet doganore. Punonjësi është personi që mban pozicionin brenda organizatës së aplikuesit (përmes organigramës, strukturës operative, udhëzimeve të punës apo përmes masave të tjera organizative) të personit që përgjigjet për aspektet doganore, si p.sh. personi që përgjigjet për zyrën e import-eksportit, apo një punonjës që në zyrë menaxhon aspektet doganore.

Qëllimi

Në rast se personi që tek aplikuesi luan rolin e punonjësit që përgjigjet për çështjet doganore duhet të ekzistojë një marrëdhënie pune që krijon një marrëdhënie juridike midis punëdhënësit (aplikuesi) dhe punëmarrësit. Kjo nënkupton që punonjësi, për llogari të aplikuesit, kryen punë apo shërbime për çështjet doganore, sipas disa kushteve të caktuara përkundrejt një shpërblimi.

Vlen të theksohet se në varësi të organizimit të brendshëm të aplikuesit mund të ketë më shumë se një punonjës që përgjigjet për aktivitetin doganor. Në këtë rast, kushti duhet të plotësohet nga të gjithë punonjësit përgjegjës.

Në rast se një punonjës tjetër bëhet personi që përgjigjet për çështjet doganore të biznesit të aplikuesit, operatori ekonomik e ka për detyrë të informojë administratën doganore që mund të vlerësojë nevojën reale për vlerësimin e situatës së re mbi bazën e informacionit të ofruara (p.sh. emri i personit (ave) të përfshirë në rotacion dhe përvoja e tyre në çështjet doganore brenda kompanisë).

Verifikim i plotësimi:

Në rast se punonjësi që përgjigjet për aspektet doganore të biznesit të aplikuesit ka më pak se tre vjet pune për aplikuesin, punonjësi mund të demonstrojë plotësimin e kriterit

përmes evidencave se ka punuar më parë me çështje të ngjashme në një tjetër kompani. Në këtë rast prova e plotësimit të kriterit do të duhet të sigurohet nga kontrata e mëparshme e punës apo nga struktura organizative e kompanisë tjetër, nga një deklaratë nga kjo kompani ku të shprehet qartë statusi i punonjësit në kompaninë e mëparshme apo provë tjetër që njihet nga autoritetet doganore. Në rast se aplikuesi është një SME, sidomos një kompani mikro apo e vogël (si p.sh. biznes familjar), mund të ketë një strukturë të ndryshme menaxhimi apo organizative, pa një dallim real të roleve të brendshme apo pozicionit të punës. Në këtë rast, deklarata formale e aplikuesit mund të konsiderohet si e mjaftueshme.

2) Një person i kontraktuar nga aplikuesi (Përfaqësim i tërthortë)

Kriteri konsiderohet i plotësuar vetëm në ato raste kur marrdhëniet midis palëve janë të rregulluara mbi bazë marrëveshje ose kontrate.

Qëllimi

Në këtë rast aplikuesi përfaqësohet në mënyrë të tërthortë ka gjithmonë një kontratë përkundrejt shpërblimit ku përcaktohen shërbimet që duhet të ofrohen nga personi i kontraktuar. Zakonisht kjo kontratë përfshin një draft të termave dhe kushteve. Kohëzgjatja e kontratës përcaktohet në fillim të pjesës integrale të kontratës që bën fjalë për aktivitetin që kontraktohet.

Ka disa arsye për kontraktimin e aktiviteteve doganore. Kështu p.sh. SME-të shpesh për arsye ekonomike dhe menaxhimi, nënkontraktajnë funksione të rëndësishme me kompani të specializuara që kanë nivel informacioni teknik që nuk e arrijnë dot aplikuesi. Disa shembuj të nënkontraktimit janë:

Agjentët doganorë, për kryerjen e formaliteteve doganore. Kompleksiteti dhe zhvillimi i vazhdueshëm i legjislacionit doganor ka detyruar kompanitë të nënkontraktajnë profesionistë. Ky opsion është me efikas si kosto, sesa operacionet e brendshme për arsye të shkallës ekonomike, ekspertizës, teknologjisë dhe nxitjes që sjell konkurrenca në sektorin privat. Spedicionerë ndërkombëtarë, për të kryer formalitetet logjistike dhe doganore. Spedicioneri nuk i lëviz mallrat, por vepron si ekspert i rrjetit logjistik. Spedicioneri kontakton me transportues për lëvizjen e mallit dhe ka përvojë për përpilimin e dokumentacionit dhe përpunimin doganor, si edhe në aktivitete të tjera të së njëjtës gamë.

Vëmendje e posaçme i kushtohet faktit që në rast të shërbimeve strategjike të nënkontraktuara tek personat e kontraktuar, aplikuesi duhet të garantojë që dijet dhe kompetencat që kërkohen për ofrimin e shërbimit të jenë konstante gjatë periudhës së kontraktimit. Personi që plotëson kriterin dhe aplikuesi duhet të jenë të lidhur, sipasparagrafit 1, të nenit 40, i KD që përcakton se kriteret duhet të përmbushen nga

operatori ekonomik i cili aplikon për Statusin e OEA. Rrjedhimisht, operatori ekonomik duhet ta ketë të qartë se ekziston mundësia e nënkontraktimit të “aktiviteteve”, por jo përgjegjësia. Siç përmendet më lart, cilësia e dobët e shërbimit mund të krijojë eventualisht probleme përse i takon plotësimin të kriterëve të tjera, duke çuar madje deri në pezullimin apo heqjen e autorizimit.

Në këtë kontekst, në rastet kur aplikuesi nënkontraktin menaxhimin e aspekteve doganore tek një personi i kontraktuar, kontrata apo çdo lloj tjetër marrëveshjeje duhet tu vihet në dispozicion autoriteteve doganore për të sqaruar kapacitetet dhe përgjegjësinë e personit të kontraktuar dhe për të provuar plotësimin e kriterit.

Verifikimi i plotësimin të kriterit:

Në rast se aktivitetet doganore nënkontraktohen tek një palë e tretë, D.P.D -ja duhet të kontrollojë plotësimin/përmbushjen e kushtit përmes:

1) verifikimit nëse aplikuesi ka një marrëdhënie që i kalon tre vjetët me personin e kontraktuar. Për ta provuar këtë, D.P.D-ja mund të kontrollojë ekzistencën e një kontrate, mandati apo çfarëdo lloj tjetër marrëveshjeje midis aplikuesit dhe personit të kontraktuar që specifikon qartë veprimet dhe përgjegjësitë e personit të kontraktuar për llogari të aplikuesit (kontrata apo mandati janë kopje që i mban aplikuesi) ose

2) në rast se marrëdhënia mes tyre ka më pak se tre vjet, bëhet verifikim nëse personi i kontraktuar ka autorizim për thjeshtim doganor, në rastet kur është e zbatueshme, si edhe nëse ka kryer formalitete doganore gjatë tri viteve të fundit.

Siç përcaktohet nga pika 2, e Nenit 22 e VKM nr. 651/2017, , kushti i "standardeve praktike të kompetencave" do të konsiderohet si i plotësuar nëse personi i kontraktuar është OEAD.

Në rast të aktiviteteve doganore të nënkontraktuara mjafton që ose aplikuesi, ose një punonjës i aplikuesit që përgjigjet për aspektet doganore ose personi i nënkontraktuar të plotësojë kriterin. Nëse aplikuesi ua nënkontraktin aktivitetet doganore më shumë se një personi, atëherë kriteri duhet të plotësohet nga të gjithë.

Vlen të theksohet se në rast se aplikuesi ka një zyrë të brendshme apo departament që është i përfshirë në çështjet doganore dhe lejon supervizionin dhe kontrollin e formaliteteve doganore që janë nënkontraktuar, kriteri konsiderohet si i përmbushur nga aplikuesi.

2.IV.3. Kualifikimet profesionale

Spektri

Sipas pikës 1, të shkronjave b, të nenit 52 të VKM nr. 651/2017, , kriteri do të konsiderohet i përmbushur nëse aplikuesi apo personi që përgjigjet/mbulon aspektet doganore të tij e ka përfunduar me sukses trajnimin në lidhje me legjislacionin doganor, që lidhet me aktivitetet doganore, që ofrohen nga një prej autoriteteve të mëposhtme:

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- një institucion shkollor i njohur për qëllime të sigurimit të kualifikimit të tillë nga DPD-ja ose një institucion publik përgjegjës për trajnim profesional;
- një shoqatë profesionale apo tregtare e njohur nga DPD-ja ose e akredituar në Republikën e Shqipërisë, me qëllim dhënien e një kualifikimi të tillë.

Verifikimi i plotësimit të kriterit

Institucione publike apo private, si p.sh. universitete, shkollat e doganave, apo shkolla të tjera specifike apo profesionale, shoqata tregtare që ofrojnë kurse të ndryshme për përgatitjen për njohjen e autorizimeve/akreditimit/regjistrave profesionalë për operatorë specifikë ekonomikë (si p.sh. profesioni i agjentit doganor).

Organi që bën trajnimin duhet të vërtetojë përfundimin me sukses të kursit nga pjesëmarrësi në trajnim.

Aplikuesi apo personi që përgjigjet për aspektet doganore të aplikuesit që janë të autorizuar apo certifikuar, apo që kanë licencë për ushtrimin e aktivitetit profesional që lidhet me aspektet doganore (si p.sh. agjentët doganorë apo spedicionerë) mund të japin prova për plotësimin e kriterit, si p.sh. përfundimi me sukses i një trajnimit mbi aspektet doganore.

Gjithashtu është e mundur që një person brenda kompanisë që ka fuqinë juridike të përfaqësojë kompaninë ta ketë përmbushur me sukses trajnimin në çështjet doganore (një person që në kompaninë e aplikuesit përgjigjet për shërbime ndërmjetësimi, si p.sh. presidenti apo një anëtar i bordit të cilët kanë përfunduar me sukses provimin për agjent doganor). Në këtë rast aplikuesi përmbush kushtin e kualifikimit profesional përmes këtij personi.

Po kështu është e mundur në rastet kur ende nuk ka programe akreditimi apo regjistra profesionalë, por janë organizuar trajnime specifike për çështjet doganore (si p.sh. programe në shkollën e mesme apo takime me organe publike që ofrojnë shërbime arsimore), këto lloje trajnime do të njihen nga autoritetet doganore si të mjaftueshëm në një kontekst specifik profesional. Pavarësisht inkurajohet zhvillimi i mëtejshëm i kurrikulave të trajnimit për çështjet doganore.

Autoritetet doganore ose institucionet arsimore publike ose private që përmenden mësipër duhet të organizojnë trajnime për plotësimin e kushtit të kualifikimit profesional duke ju referuar edhe informacionit të publikuar në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave www.dogana.gov.al

Ky ëbsite është një instrument që përmban një sërë informacionesh të rëndësishme të cilat duhet të demonstrohen nga çdo tregtar apo individ që punon në sektorin privat dhe që ka të bëjë me zbatimin e procedurave dhe legjislacionit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Seksioni V – Standardet e duhura të sigurisë dhe mbrojtjes

2.V.1. Të përgjithshme

Sipas shkronjës (dh) të nenit 41, të K D, një OEA i autorizuar për sigurimin dhe sigurinë duhet të plotësojë standardet e duhura përkatëse, të cilat do të konsiderohen si të plotësuar në rastet kur aplikuesi demonstroi se ka ndërmarrë masat e duhura të sigurimit dhe sigurisë në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit, duke përfshirë në zonat e integritetit fizik, kontrollit të aksesit, proceseve logjistike dhe trajtimin e llojeve specifike të mallrave, personelit dhe identifikimit të partnerëve të biznesit. Neni 53 i VKM nr. 651/2017, shpjegon më tej kërkesat që duhet të plotësohen. Duhet të përcaktohet qartë që kriteri i sigurisë dhe mbrojtjes është i vetmi që mbart vlerë për një operator ekonomik që aplikon për OEAS.

Njëkohësisht është e rëndësishme që ekzaminimet e kriterëve të sigurimit dhe sigurisë të kryhen për të gjitha hapësirat që lidhen me aktivitetin doganor të aplikuesit. Kështu, për ilustrim, një magazinë ku mallrat, që nuk janë në mbikëqyrje doganor, por që janë për qëllim eksporti (dhe rrjedhimisht do të hyjnë në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit) duhet të jetë e sigurtë/siguruar. Përndryshe, në një magazinë ku mbahen vetëm mallra të qarkullimit të lirë që do të shiten jashtë Republikës së Shqipërisë, territori doganor mund të mos jetë i përshtatshëm për aspektet e sigurisë. Kështu që gjatë përgatitjes së aplikimit, operatorët duhet të jenë në gjendje të evidentojnë aktivitetet për të gjitha hapësirat e tyre.

Vetëm në rast se ka një numër të madh ndërtesash, ku periudha e autorizimit nuk e lejon ekzaminimin e të gjitha objekteve, por autoritetet doganore nuk kanë asnjë dyshim që aplikuesi i ka standardet e sigurisë për kompaninë, njësoj si në të gjitha objektet e tjera të tij, D.P.D mund të vendosë të ekzaminojë vetëm një përqindje përfaqësuese të atyre objekteve. Ky vendim mund të rishikohet gjatë procesit të monitorimit. Kështu që objektet që nuk janë vizituar më parë të mund të përfshihen në planin e monitorimit.

Duke qenë se çdo kompani ka strukturë të ndryshme dhe modelin e vet të biznesit, masat për sigurinë nga ana e aplikuesit duhet të konsiderohen nga autoritetet doganore rast pas rasti. Qëllimi i këtij seksioni nuk është të japë një listë gjithëpërfshirëse të të gjitha masave të sigurisë që aplikuesi duhet të zbatojë për të përmbushur kërkesat e sigurisë për

OEA, por të shërbejë si udhëzues për të kuptuar konceptin e sigurisë së OEA. Disa ilustrime të zgjidhjeve të ndryshme të masave që mund të merren jepen në shpjegimet e pyetësorit të vetëvlerësimit.

Standardet e sigurisë së Aplikuesit do të konsiderohen si të përshtatshme/të duhurat vetëm në rast se të gjitha kushtet e përmendura në pikën 1, të Nenit 53 të VKM nr. 651/2017, janë të mundura për tu verifikuar nga autoritetet doganore dhe konsiderohen si të plotësuar. Megjithatë, për qëllimet e Nenit 53 pika 1 nga shkronja (a) deri te shkronja (c) të VKM nr. 651/2017, disa mangësi të vogla në një kusht mund të justifikohen nga anët pozitive tek një kusht tjetër. Kuptimi dhe qëllimi i dispozitës duhet të mbahet gjithmonë në konsideratë, dmth., që janë marrë masat e duhura për të ulur nivelin e riskut për ta sjellë atë në një nivel të pranueshëm. Kështu p.sh. mund të ketë mangësi në lidhje me kontrollet paraprake që kryhen për personelin e përkohshëm. Megjithatë aplikuesi njih dhe menaxhon me efikasitet këtë risk, përmes kontrollit të nevojshëm në mënyrë që ky personel të mos ketë akses të pakontrolluar tek mallrat që hyjnë në zinxhirin e furnizimit apo në zonat e biznesit që janë sensitive nga pikëpamja e sigurisë. Në këtë perspektivë duhet të pasqyrohet se ndërgjegjësimi dhe zbatimi në praktikë i konceptit OEA nga ana e aplikuesit dhe punonjësve të tij mund të shmangë një risk të vogël për shkak të mungesës së kontrolleve fizike. Nga ana tjetër, edhe masat më të mira të sigurisë fizike mund të dështojnë po nuk pati ndërgjegjësim të plotë nga stafi kompetent.

Ndërsa disa nga kriteret që paraqiten në [Pjesën 2 tek “Kriteret OEA” të këtij Udhëzuesi](#) mund të kontrollohen mbi bazën e dokumentacionit që paraqitet apo në vend, kriteri i sigurisë duhet të përfshijë gjithmonë kontrolle fizike në vendndodhjen e aplikuesit.

Vëmendje i duhet kushtuar një qasjeje graduale në varësi të riskut në zona të ndryshme.

Duhen mbajtur në vëmendje dispozita e pikës 2, të Nenit 50 të VKM nr. 651/2017, :

- *Kur aplikuesi është mbajtës i një certifikate të sigurisë e të mbrojtjes, të lëshuar në bazë të një konvente ndërkombëtare ose të një standardi ndërkombëtar të Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim, apo nga një standard evropian i një organi evropian standardizimi, këto certifikata merren parasysh kur kontrollohet pajtueshmëria me kriteret e përcaktuara në shkronjën “d”, të nenit 41, të Kodit.*
- *Kriteret do të konsiderohen të përmbushura në masën që është vërtetuar se kriteret për lëshimin e certifikatës janë identike ose ekuivalente me ato të përcaktuara në shkronjën “d”, të nenit 41, të Kodit.*
- *Kriteret do të konsiderohen të përmbushura kur aplikuesi është mbajtës i një certifikate të sigurisë e të mbrojtjes, të lëshuar nga një vend tjetër me të cilin Republika e Shqipërisë ka lidhur një marrëveshje që parashikon njohjen e asaj certifikate.*

Informacion i detajuar mbi Njohjen Reciproke dhe zbatimin e saj jepet në [Pjesën 6 të këtij Udhëzuesi](#).

2.V.2. Siguria e ndërtesës

Për të parandaluar cënimin/prekjen/ngacmimin e mallrave, por edhe për të mbrojtur të dhënat dhe dokumentacionin sensitiv, aplikuesi do të garantojë që *“ndërtesat që do të përdoren për operacionet në lidhje me autorizimin OEAS janë të mbrojtura nga ndërhyrjet e paligjshme dhe janë të ndërtuara me material që i reziston hyrjes së paligjshme”*.

Qëllimi i masave të sigurisë është të sigurojnë ndërtesat për të parandaluar ndërhyrjet e paligjshme dhe në rast të prekjes/shkeljes së perimetrit të bëjnë të mundur:

- të mos lejojnë personat e paautorizuar (p.sh. gardhe, kode, dritare të brendshme dhe të jashtme, porta dhe gardhime të siguruara me aparatura mbyllëse);
- zbulim të shpejtë të ndërhyrjes (p.sh. monitorim i aksesit apo masa kontrolli, si p.sh. sisteme të brendshme/të jashtme alarmi në rast të hyrjes së personave të paautorizuar apo sistem CCTV (me qark të mbyllur);
- reagim i shpejtë ndaj ndërhyrjeve (p.sh. sistem transmetimi në distancë (*remote*) tek një menaxher apo kompani sigurie në rast se bie alarmi).

Ky kusht duhet të reflektohet gjithmonë në kontekstin e kontrollit të aksesit dhe sigurisë së kargove në tërësi. Në rast se aplikuesi dëshiron të mbrojë pronën e tij (mallra, të dhëna, ndërtesa) nuk mund t’i ndajë masat për sigurinë e ndërtesës nga kontrolli i aksesit dhe sigurisë së kargove.

Gjithashtu, për qëllimet e analizës së riskut, aplikuesi, si edhe autoritetet doganore do të mbajnë në konsideratë karakteristikat e veçanta të çdo vendndodhjeje. Në disa raste kjo mund të jetë vetëm një ndërtesë që njëkohësisht shërben edhe si kufi i jashtëm për godinën e kompanisë; në të tjera raste, një hapësirë administrative mund të gjendet në një zonë të mirë siguruar dhe kontrolluar si: port i lirë, zonë industriale, park logjistik etj. në disa raste edhe rampa e ngarkimit për mallrat që hyjnë dhe dalin do të jetë pjesë e jashtme.

Edhe planimetria e hapësirës administrative (si p.sh. gjendet në një zonë ku kriminaliteti është i lartë apo pranë një zone të re ndërtimi, apo nëse është ngjitur me ndërtesa të tjera, pranë rrugëve apo hekurudhës) mund të ketë ndikimin e vet në masat që do të merren.

Planimetria mund të ndikojë gjithashtu tek vlerësimi i kriterëve të Nenit 53 pika 1 shkronja (a) të VKM nr. 651/2017, iguria e ndërtesës” dhe (b) “kontrollat e aksesit”. Aspektet që do të mbahen në konsideratë gjatë vlerësimit të këtij kushti mund të jenë, fjala vjen, që një gardh të jetë në anën e një pjerrtësie, bankine apo në kufi me ndonjë vijë ujore duke e bërë aksesin të vështirë.

Gjatë kontrollit të këtij kushti është shumë e rëndësishme të mbahet në konsideratë që çdo aplikant duhet të garantojë sigurinë e ndërtesave të tij dhe kontrollin e aksesit. Megjithatë kur bëhet vlerësimi i mënyrës sesi kjo arrihet, do të mbahen në konsideratë

karakteristikat specifike të **SME-ve**. Kështu p.sh. një prodhues i madh mund të ketë një gardh apo mur që mbulon të gjithë perimetrin, roje dhe CCTV etj., ndërsa agjenti doganor që punon për një perimetër shumë të kufizuar mund të mjaftohet me sigurimin e dyerve, dritareve dhe vendit ku mban dosjet.

2.V.3. Kontrolli i duhur i aksesit

Për të garantuar aksesin tek hapësirat dhe për të parandaluar cenimin e mallrave të aplikuesit, ai duhet të marrë *“masat e duhura për të parandaluar aksesin e paautorizuar në zyra, zonat e transportit detar, dokun e ngarkimit, zonat e kargove dhe pika të tjera”*.

Ka raste kur masat e jashtme të sigurisë si: gardhet, portat dhe ndriçimi duhet të jenë të detyrueshme (kur mallrat ruhen jashtë ndërtesave, kur muret e ndërtesave nuk konsiderohen si perimetër i jashtëm apo kur mbrojtja dhe aksesit i të gjitha ndërtesave nuk është e mjaftueshme). Nga ana tjetër, ka raste kur nuk është e nevojshme dhe nuk është e mundur të ngrihet një mur i jashtëm në të gjithë perimetrin. Ky mund të jetë rasti nëse aplikuesi jep me qira një pjesë të parkut industrial apo logjistik dhe mallrat nuk ruhen jashtë, si edhe kur kërkesat e sigurisë fizike si p.sh. siguria e ndërtesës janë të nivelit të lartë.

Të gjithë zonat sensitive nga aspekti i sigurisë duhet të mbrohen nga aksesit i paautorizuar nga palë të treta, por edhe vetë personeli i papunë i aplikuesit apo që nuk ka autorizim për atë nivel sigurie duhet të jenë të përjashtuar. Këtu përfshihet jo vetëm kontrolli i aksesit të personave të pa-autorizuar, por edhe i mjeteve dhe mallrave të paautorizuara.

Duhet të ketë procedura të zbatueshme për mënyrat e reagimit ndaj incidenteve të sigurisë, në rast të një aksesit të pa-autorizuar apo përpjekjeve për akses (p.sh. kontaktohet policia, stafi i brendshëm i sigurisë dhe sipas rastit edhe autoritetet doganore). Në këtë kuadër është gjithashtu e rëndësishme që të mbahet parasysh se koncepti i sigurisë i OEA është parandalimi i incidenteve. Ndaj është e nevojshme të dihen paraprakisht raste të shkeljes së sigurisë përpara se ato të kenë ndikim në sigurimin dhe sigurinë e zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit. Një ilustrim mund të jetë sistemi CCTV që vetëm regjistron, por nuk monitorohet. Për disa raste kjo mund të jetë e mjaftueshme, por nuk është kështu për OEAS.

Gjatë kontrollit të këtij kushti, ka rëndësi të madhe të mbahen mirë në konsideratë karakteristikat e posaçme të **SME-ve**. Ndonëse SME-të duhet të plotësojnë të njejtat kushte si ndërmarrjet e mëdha përsa u takon procedurave të kontrollit të brendshëm për aksesin, për to mund të jetë me vend një tjetër zgjidhje kur vjen fjala tek kontrolli i aksesit. P.sh.:

- shumicën e kohës, bizneset e vogla dhe mikro nuk kanë burime të mjaftueshme për të vendosur punonjës të posaçëm për monitorimin e aksesit në zonë. Në këtë rast, një gardh me sistem intercom duhet të bëjë kontrollin e aksesit me sistem *remote* apo në distancë të hapësirës administrative;

- udhëzime për detyrimin që dyert e zonës së ngarkimit të jenë të mbyllura gjatë gjithë kohës dhe portat të kenë zile për shoferët që duan të hyjnë në dok për parandalimin e aksesit të pa-autorizuar në zonat e kargove;
- kompanitë e mëdha u japin dokument identifikimi të gjithë stafit dhe vizitorëve, ndërsa në rastin e SME-ve kjo mund të mos të jetë e nevojshme.

2.V.4. Siguria e ngarkesave (kargove)

Për të garantuar integritetin e ngarkesave dhe për të shmangur praktikat e parregullta në qarkullimin e mallrave brenda zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit, aplikuesi duhet *“të marrë masa për trajtimin e mallrave që kërkojnë mbrojtje nga hyrjet e paautorizuara apo shkëmbimi apo keqtrajtimi i mallrave dhe nga cënimi i njërive të ngarkesave”*.

Këto masa, sipas rastit përfshijnë:

- integritetin e njërive të ngarkesave (duke përfshirë përdorimin e plumbçeve dhe inspektimin në 7 pika (nga jashtë, dyert e brendshme/jashtme, nga anët djathtas dhe majtas, nga muri kryesor, tavani/çatia, dyshemeja/brenda);
- proceset logjistike (duke përfshirë zgjedhjen e agjencisë specionere dhe mjetin e transportit);
- mallrat hyrëse (duke përfshirë kontrollin e cilësisë dhe sasisë, plumbçet, kur është e përshtatshme);
- magazinimin e mallit (duke përfshirë kontrollin e stokut);
- prodhimin e mallrave (duke përfshirë kontrollin e cilësisë);
- paketimin (ambalazhimi i mallrave (duke përfshirë informacionin në ambalazh);
- ngarkesën e mallrave (duke përfshirë kontrollin e cilësisë dhe sasisë dhe plumbçet).

Kur është e përshtatshme dhe e mundur, masat e sipërpërmendura duhet të jenë të dokumentuara dhe të regjistruara.

Është e rëndësishme që shkeljet e integritetit të ngarkesave/njërive të ngarkesave të kapen sa më shpejt të jetë e mundur, të raportohen tek departamenti/personi që mbulon çështjet e sigurisë, të hetohet dhe të regjistrohet për të marra masat e duhura. Ndaj është shumë e rëndësishme që kompetencat dhe përgjegjësitë ndërmjet palëve të përfshira të përshkruhen dhe të bëhen të ditura qartë.

Saç përmendet në pikën [2.V.2. të këtij Udhëzuesi](#), siguria e ngarkesave është e pandarë nga siguria e ndërtesës dhe kontrolli i aksesit, duke qënë se qëllimi më i lartë i masave për sigurinë dhe mbrojtjen është të sigurojë mallrat, përmes parandalimit të aksesit të paautorizuar tek ngarkesat (në zonat e transportit me anije, dokun e ngarkimit dhe zonat e ngarkesave).

Për më tepër, gjatë kontrollit të këtij kushti ka rëndësi të madhe të mbahen mirë në konsideratë, tiparet specifike të SME-ve. p.sh.:

- dyer dhe gardhe të mbyllura, vendosja e tabelës që tregon pronësinë dhe udhëzimet të jenë të mjaftueshme për të kufizuar aksesin, vetëm tek personat e autorizuar në zonat e kufizuara (këto udhëzime mund të bëhen pjesë e procedurave të përgjithshme që ka aplikuesi për sigurinë);
- për të parandaluar aksesin e paautorizuar në zonat e prodhimit, ngarkim-shkarkimit, zonat e ngarkesave dhe zyrave, vizitorët mund të shoqërohen dhe të firmosin kur hyjnë në një regjistër të veçantë.

Së fundi, siguria e ngarkesave është e pandarë nga “Siguria e Partnerit të Biznesit” sepse kur mallrat në njësitë e ngarkesave hyjnë në zinxhirin e furnizimit, ato shpesh vendosen nën përgjegjësinë e partnerit të biznesit.

2.V.5. Siguria e Partnerit të Biznesit

2.V.5.1. Të përgjithshme

Partner biznesi është një term që përdoret për të përshkruar një subjekt tregtar me të cilin një tjetër subjekt ka një formë marrëdhënieje biznesi për përfitimin reciprok të palëve. Për qëllimet e OEA-s, rëndësi kanë partnerët e biznesit që janë përfshirë drejtpërdrejtë në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit.

Të gjithë operatorët ekonomikë në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit që hyjnë në kategoritë eksportues/prodhues dhe importues/blerës mund të konsiderohen si partnerë biznesi me njëri-tjetrin, në varësi të rrethanave.

Marrëdhënia me partnerin e biznesit mund të jetë kontraktuale, në rastet kur të drejtat dhe detyrimet e palëve përcaktohen me kontratë ligjore. Përndryshe, mund të jetë një marrëdhënie e lirë, pa bazë ligjore ose diçka e ngjashme (kur ka dokumentacion, por është thjesht deklaratë faktesh apo qëllimi). Mund të ketë edhe marrëdhënie ku njëra palë, si p.sh. objektet dhe infrastruktura e transportit të jenë në pronësi shtetërore dhe kjo përcakton parametrat e shërbimit të palës tjetër, dmth. të transportuesit, të cilat ai mund t'i pranojë ose jo, por ka fare pak influencë mbi ata parametra.

Përzgjedhja e partnerit të biznesit është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe aplikuesit për Statusin e OEA duhet të kenë një proces të qartë dhe të verifikueshëm për përzgjedhjen e partnerit të tyre të biznesit.

Nga këndvështrimi i OEA-s, partneri i biznesit, sipas përkufizimit të nenit 53, pika 1, gërma “ç” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

mund të ketë mundësinë për të aplikuar për statusin e OEA-s, por nëse zgjedh të mos e ushtrojë atë mundësi apo nëse është i themeluar në një shtet ku nuk është i mundur të merret Statusi i OEA, ai duhet t'i paraqesë fakte të mjaftueshme partnerit OEA në mënyrë që të plotësojnë një nivel të pranueshëm të standardeve të sigurisë. Skenari ideal do të ishte që një numër maksimal pjesëmarrësish në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit të kenë Statusin e OEA apo një status ekuivalent me të.

2.V.5.2. Identifikimi i Partnerit të biznesit

Gjatë shqyrtimit të zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit në kontekstin e një vetëvlerësimi OEA është e rëndësishme që të jetë i qartë roli i çdo partneri biznesi.

Roli i partnerit të biznesit përcakton nivelin e riskut, nivelin e ndërgjegjesimit për sigurinë që kërkohet prej tij dhe masat që do të zbatohen nga OEA për zbutjen e risqeve të evidentuara. Disa nga përgjegjësitë e partnerit të biznesit të OEA mund të jenë:

- **prodhuesit dhe mbajtësit e magazinës** duhet të garantojnë dhe nxisin ndërgjegjësimin që hapësirat të plotësojnë një standard të pranueshëm sigurie që parandalon cenimin e mallrave që janë në prodhim dhe/ose magazinim/ruajtje si dhe të parandalojnë aksesin e paautorizuar;
- **importuesit/spedicionerët/eksportuesit/agjentët doganorë** duhet të garantojnë që agjentët e palëve të treta të kenë njohuri mbi procedurat dhe sistemet, si edhe me dokumentacionin që duhet të shoqërojë mallin si në transit ashtu edhe për çlirim për qarkullim të lirë;
- **transportuesit** duhet të sigurojnë që transporti i mallrave të mos ndërpritet në mënyrë të panevojshme dhe të ruhet integriteti i mallrave nga ndërhyrjet e paautorizuara gjatë kohës që mallrat janë nën mbikqyrjen e tyre.

2.V.5.3. Kërkesat e sigurisë për partnerin e biznesit

Neni 53, pika 1, gërma “ç” e VKM nr.651/2017 përcakton se standardet e sigurisë në lidhje me partnerin e biznesit do të konsiderohen si të përshtatshme “*nëse aplikuesi ka marrë masa që lejojnë identifikimin e qartë të partnerit të biznesit dhe të garantojë përmes zbatimit të marrëveshjeve kontraktuale apo masave të tjera, sipas modelit të biznesit të aplikuesit, që partneri i biznesit garanton sigurinë e pjesës së tij në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit.*”

Një OEA është pikë së pari përgjegjës për pjesën e vet në zinxhirin e furnizimit, për mallrat që i ka vetë në ruajtje dhe për objektet/ambjentet e veta. Kur merr statusin OEA, ky status i takon vetëm personit që ka aplikuar për të. Megjithatë, OEA varet gjithashtu nga standardet e sigurisë së partnerëve të vet të biznesit, me qëllim që të garantojë sigurinë e mallrave nën mbikqyrjen e tyre. Është e rëndësishme që aplikuesi t'i ketë të qarta rolet e partnerit të tij të biznesit në zinxhirin e furnizimit dhe të bëjë çdo përpjekje

për të garantuar që partneri i vet i biznesit të veprojë konform kërkesave të sigurisë së OEA-s.

Çdo aplikues duhet të sigurohet që partneri i vet i biznesit të ketë dijëni mbi detyrimet dhe kërkesat e sigurisë dhe të përpiqet kur është e përshtatshme dhe e mundur, që në varësi të modelit të biznesit të ketë marrëveshje kontraktuale me shkrim apo marrëveshje të ngjashme. Nëse është e nevojshme, aplikuesi, kur hyn në marrëveshje kontraktuale me një partner biznesi duhet të bëjë çdo përpjekje të mundshme për të garantuar që pala tjetër kontraktuale të vlerësojë dhe rrisë sigurinë e zinxhirit të furnizimit, dhe të përfshijë detaje për mënyrën sesi do të arrihet kjo, bashkë me fakte. Menaxhimi i riskut që lidhet me partnerin e biznesit është shumë i rëndësishëm. Ndaj, aplikuesi duhet të mbajë dokumentacion mbështetës për këtë aspekt, për të treguar përpjekjet e tij dhe të partnerit të biznesit për realizimin e kërkesave apo që ka marrë masa zbutëse për trajtimin e risqeve të evidentuara.

Aplikuesi duhet të jetë i qartë se cilët janë partnerët e tij të rinj të biznesit. Gjithashtu, OEA, me të marrë autorizimin, kur është duke menduar për partner të ri potencial biznesi, duhet të përpiqet të marrë informacion në lidhje me ato aspekte të biznesit të partnerit të ri që kanë lidhje me Statusin e OEA.

Disa nga shembujt sesi një OEA, apo aplikues mund të rrisë zinxhirin e tij të sigurisë janë:

- të bashkëpunojë me OEA të tjerë apo ekuivalentë të tyre;
- sipas rastit, kur është e përshtatshme dhe e mundur sipas modelit të tij të biznesit të hyjë në marrëdhënie kontraktuale për sigurinë me partnerin e vet të biznesit;
- nën-kontraktorët (si p.sh. transportuesit) të zgjidhen mbi bazën e përmbushjes së rregullave të caktuara të sigurisë dhe ndonjëherë të kërkesave të detyrueshme ndërkombëtare.
- kontratat përfshijnë klauzola që e ndalojnë nën-kontraktorin nga nënkontraktime të mëtejshme tek palë të panjohura. Kjo duhet të zbatohet gjithmonë në rastet e transportit ajror të pakove/letrave nga një dërgues i njohur;
- plumbçet duhet të përdoren për të gjitha modalitetet, për të zbuluar shkelje apo prishje gjatë pikave të hyrjes në zonën e ngarkesave. Kontenierët e ngarkuar duhet të jenë të plumbosura, nga palët që kanë mbushur kontenierin, menjëherë pas përfundimit të procesit të mbushjes, me një plumbçe sipas standardit ISO17712; 2013;
- kontenierët e mbushur inspektohen në ambjentet e nënkontraktorit, terminal dhe ambjentet e marrësit për të verifikuar nëse ato janë të plumbosura;
- informacion i përgjithshëm nga organet përgjegjëse për regjistrimin e kompanive (kur është e mundur) dhe produktet e partnerit (mallra me risk dhe sensitive) merren në konsideratë përpara hyrjes në një marrëdhënie kontraktuale;
- aplikuesi/OEA organizon apo kërkon audit nga palë të treta të partnerit të biznesit për tu siguruar që plotësohen detyrimet dhe kërkesat e sigurisë;
- aplikuesi/OEA, kur është e përshtatshme dhe e mundur, sipas modelit të vet të biznesit, kërkon një deklaratë sigurie ku reflektohen modelet përkatëse të palëve në biznes, dhe rolet e përgjegjësitë.

Një shembull i një deklaratë sigurie që mund të përdoret jepet bashkëlidhur në rastet kur aplikuesi dëshiron të plotësojë kërkesat e përcaktuara në nenin 53 pika 1 gërma “ç” të VKM nr.651/2017, përmes një deklaratë sigurie nga një partner i caktuar biznesi. Megjithatë, në rast se përdorimi i një deklaratë sigurie zgjidhet si mekanizëm i përshtatshëm dhe i mundur për modelin e biznesit, aplikuesi duhet të jetë në gjendje të garantojë që detyrimet e mbuluara prej tij zbatohen nga partneri i biznesit.

- aplikuesi/ OEA përdor transportues që janë të pajisur me certifikata ndërkombëtare apo evropiane të sigurisë;
- aplikuesi/OEA hyn në marrëveshje jo-kontraktuale për të identifikuar specifikisht çështje të rëndësishme që lidhen me sigurinë, sidomos kur janë evidentuar dobësi potenciale në vlerësimin e sigurisë.

Si autoritetet doganore ashtu edhe operatorët ekonomikë duhet të mbajnë në konsideratë faktin që masat e sipërpërmendura janë thjesht treguese dhe nuk janë shteruese. Përzgjedhja e një mase apo një tjetre apo një kombinim i masave varet ndjeshëm nga roli i partnerit të biznesit në zinxhirin e furnizimit dhe risqet dhe modeli i tij i biznesit.

Pavarësisht nga masat që ka marrë aplikuesi për të plotësuar këtë kërkesë, është e rëndësishme që të ekzistojnë procedura për monitorimin e marrëdhënieve me partnerin e biznesit, si edhe që këto procedura të rishikohen e përditësohen vazhdimisht.

Në rast se aplikuesi/OEA ka informacion se një partner biznesi, që është pjesë e zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit nuk është duke i përmbushur standardet e sigurisë dhe të mbrojtjes, atëherë ai do të marrë menjëherë masat e duhura për të rritur sigurinë e zinxhirit të furnizimit, në maksimumin e mundësisë së vet.

Përsa u takon dërgesave që janë marrë në dorëzim nga partnerë tregtarë të panjohur rekomandohet që aplikuesi/OEA të marrë masat e duhura për zbutjen e risqeve të sigurisë në lidhje me atë transaksion specifik në një nivel të pranueshëm.

Kështu p.sh. në rast se kemi të bëjmë me një ngarkesë me avion/apo postë ajrore nga një partner i panjohur tregtar për të cilin nuk mund të provohet se ka marrë masat e duhura të sigurisë, atëherë këto duhet të kalojnë përmes një agjenti të rregulluar.

Kjo merr vlerë të posaçme në rastet kur aplikuesi/operatori ekonomik i autorizuar ka një partner biznesi që është i ri, apo i përkohshëm, apo kur është i përfshirë në transporte të ngarkesave voluminoze, si p.sh. postë dhe postë ekspres.

Në rast se kemi të bëjmë me disa nënkontraktime, përgjegjësia për sigurinë e zinxhirit të furnizimit kalon nga aplikuesi/OEA (p.sh. një eksportues) tek vetë partneri i biznesit (p.sh. spedicioneri). Praktikisht partneri i biznesit është ai që është angazhuar zyrtarisht për sigurimin e këtij malli për llogari të aplikuesit/OEA. Megjithatë, në rast se

“nënkontraktori i shkallës së parë” (p.sh. spedicioneri) përdor palë të treta, i takon atij të kontrollojë zbatimin e masave të sigurisë së nënkontraktorit/ve të mëtejshëm (p.sh transportuesi apo spedicionerë të tjerë).

Në rast se operatori ekonomik i autorizuar ndeshet me vështirësi përputhshmërie, ai duhet të kontaktojë pa vonesë me autoritetet doganore, në lidhje me to,.

2.V.6. Siguria e personelit

Siguria e personelit, bashkë me sigurinë fizike, kontrollin e aksesit, sigurinë e partnerit të biznesit etj. është një nga aspektet kryesore të sigurisë. Vlen të theksohet se ky kusht nuk lidhet me “sigurinë në punë“, duke qenë se kjo është jashtë gamës së kriterit të sigurisë dhe mbrojtjes.

Për të parandaluar futjen e personelit të paautorizuar që mund të përfaqësojë një risk për sigurinë, aplikuesi do të *“kryejë në përputhje me legjislacionin në fuqi një kontroll sigurie të punonjësve të ardhshëm që mund të punësohen në pozicione delikate për sigurinë dhe të kryejë kontroll të historikut të punonjësve aktualë në mënyrë periodike, dhe në varësi të rrethanave”*. Për zbatimin në praktikë të kësaj kërkesë duhet të mbahen në konsideratë elementët e mëposhtëm si nga autoritetet doganore, ashtu edhe nga aplikuesi:

- të gjithë operatorët ekonomikë duhet të kenë/zbatojnë procedura/sisteme të përshtatshme për të përmbushur këtë kërkesë, dhe autoritetet doganore duhet të jenë në gjendje/ta kenë të mundur që ta verifikojnë një gjë të tillë;
- aplikuesi, si punëdhënës është përgjegjës për t’i bërë këto kontrole, ndërsa autoritetet doganore verifikojnë nëse ato janë kryer dhe nëse janë të mjaftueshme për të garantuar përputhshmërinë sipas legjislacionit në fuqi;
- spektri dhe qëllimi i këtyre kontrolleve duhet të jetë i qartë. Parimi i proporcionalitetit duhet të respektohet, dmth. “veprimet nuk duhet ta tejkalojnë atë që është e nevojshme për të arritur qëllimin”.

Masa dhe vlerësimi i plotësimit të kushtit varet nga masa, struktura organizative dhe lloji i aktivitetit të biznesit të një operatori ekonomik. Rrjedhimisht, verifikimi i posaçëm përshtatet sipas aplikuesit. Megjithatë, fushat kryesore që duhet të kontrollohen në çdo rast janë:

- Politikat e punësimit të aplikuesit

Organizimi dhe procedurat e përgjithshme për punësimin e personelit të ri duhet të jenë të qarta, duke përfshirë edhe kush ka përgjegjësi për to. Politikat e aplikuesit duhet të pasqyrojnë të gjitha masat e arsyeshme parandaluese që do të mbahen në konsideratë gjatë punësimit të stafit të ri, në pozicione delikate të sigurisë, për të verifikuar që këta persona nuk kanë qenë të dënuar më parë në lidhje me çështje sigurie, doganore apo

vepra të tjera penale që kanë të bëjnë me sigurinë e zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit, si edhe të bëjë kontrolle të vazhdueshme për personelin ekzistues që punon në pozicione pune delikate, sipas legjislacionit në fuqi.

Metodat e kontrollit të sigurisë mund të përfshijnë kontrolle bazë, si p.sh. verifikimi i identitetit dhe vendbanimit, kontrolli i lejes së punës, nëse është e nevojshme, vetë-deklarimi i gjendjes penale dhe kontrolle referencash apo historiku punësimi të mëparshëm.

Aplikuesi duhet të ketë kërkesa sigurie që kanë të bëjnë me personelin e përkohshëm dhe me personat e punësuar nga agjencitë. Të tilla standarde sigurie kërkohen për punonjësit e përhershëm dhe të përkohshëm si dhe për ato që punosohen nga agjenci për shkak të ndjeshmërisë (sensitivitetit) të pozicionit të punës. Në rast se aplikuesi ka përdorur një agjenci punësimi për rekrutimin e personelit, aplikuesi duhet të specifikojë në kontratën me agjencinë, nivelin e kontrollit të sigurisë që duhet të bëhet për personin përpara dhe pas punësimit në pozicione pune sensitive për sigurinë. Auditimi doganor mund të kërkojë të verifikojë se si aplikuesi kontrollon stafin e jashtëm dhe për këtë qëllim aplikuesi duhet të ketë në regjistrat e tij evidenca të standardeve që ka aplikuar.

- Punonjës që punojnë në pozicione sensitive për sigurinë

Gjatë përcaktimit të konceptit “pozicione pune sensitive për sigurinë“ duhet të bëhen analizat e duhura të riskut dhe të mbahen në konsideratë që këto nuk janë vetëm pozicione menaxhimi, por edhe pozicione që lidhen direkt me trajtimin, magazinimin dhe lëvizjen e mallrave. Kështu në këtë kontekst disa pozicione sensitive mund të jenë:

- Pozicionet e punës që kanë përgjegjësi për aspektet e sigurisë, doganore dhe të punësimit;
- Pozicionet e punës që lidhen me mbikqyrjen e ndërtesave dhe të pritjes;
- Pozicionet e punës që përshkruhen në seksion 6 të Pyetësorit të vetëvlerësimit të cilat lidhen me mallrat që hyjnë/dalin si dhe magazinimin.

Këto kontrolle mund të bëhen edhe për personelin ekzistues të këtyre departamenteve, të cilët nuk konsiderohen si sensitive nga këndvështrimi i sigurisë, por që lëvizin me punë në këto pozicione.

Për pozicione kritike për sigurinë e lartë, kërkohet kontroll nga autoritetet përkatëse të policisë, për të verifikuar rastet e shkeljeve/ndjekjeve penale të kryera ose jo. Punonjësit përkatës informojnë punëdhënësin për rastet e shkeljeve, procedurave gjyqësore dhe/ose dënimeve të tjera të kryera ose jo. Ata gjithashtu duhet të informojnë në lidhje me punë apo aktivitete të tjera që kanë qënë subjekt i çdo risku sigurie.

Rekomandohet gjithashtu që personeli i punësuar të mos figurojë në asnjë nga listat e zeza të legjislacionit vendas apo ndërkombëtar.

Çdo kontroll që kryhet duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale që rregullon përpunimin e të dhënave personale në kushte të ndryshme. Në një sërë rastesh ka dispozita që bëjnë të mundur trajtimin e të dhënave personale vetëm në rast se personi në fjalë jep pëlqimin e tij për këtë veprim. Ndaj për të lehtësuar procesin për disa pozicione pune mund të përfshihet një klauzolë e posaçme në kontratë që kërkon nga personi dhënien e pëlqimit për të lejuar kontrolle të kësaj natyre.

- Politikat dhe procedurat kur personeli largohet nga puna apo pushohet

Aplikuesi, për punonjës të cilët nuk punojnë më në atë detyrë, duhet të ketë procedura që lejojnë heqjen e shpejtë të identifikimit, hyrjen në ambjente apo në sistemet e informacionit.

Siç përmendet tek shënimet shpjeguese të Pyetësorit të Vetëvlerësimit (shih pikën 6.11 “*Siguria e personelit*”), të gjitha këto kërkesa për sigurinë që zbatohen në lidhje me politikat e punësimit të aplikuesit duhet të jenë të dokumentuara.

2.V.7. Ofruesit e jashtëm të shërbimit

Aplikuesi mund të ketë gjithashtu marrëdhënie kontraktuale biznesi me partnerë të tjerë, duke përfshirë kompani që ofrojnë shërbime pastrimi, katering, ofrues shërbimesh për programe kompjuterike (softuerë), kompani të jashtme sigurimi apo kontraktorë afatshkurtër. Në kontekstin e OEA-s, këto palë do të njihen si ofrues shërbimesh.

Neni 53, pika 1, gërma “dh” e VKM nr. 651, datë 10.11.2017, specifikon që *“aplikuesi duhet të ketë procedurat e duhura të sigurisë për çdo shërbim të kontraktuar me ofrues të jashtëm shërbimi”*.

Ndonëse ofruesit e jashtëm të shërbimit nuk luajnë ndonjë rol direkt në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit, ata mund të kenë një ndikim me rëndësi për sa i takon sigurisë dhe sistemit doganor të aplikuesit. Rrjedhimisht, në lidhje me masat e sigurisë dhe mbrojtjes së aplikuesit, këto masa duhet të zbatohen për ta si edhe për partnerët e tij të biznesit.

Në rastet kur disa prej kushteve të ‘OEA për mbrojtjen dhe sigurinë’ përmbushen nga ofruesi i shërbimit për llogari të një aplikuesi OEA, kjo do të duhet të verifikohet si pjesë e auditimit.

Një shembull tipik është kushti për kontroll aksesi, kur aplikuesi ka kontraktuar një kompani sigurie për të përmbushur detyrimet e tij në këtë fushë. Kushti për kontrollin e aksesit duhet të verifikohet përmes vlerësimit të mënyrës sesi ofruesi i shërbimit e plotëson këtë kusht për llogari të OEA-s. Ndonëse OEA mund ta nënkontraktojë shërbimin tek një palë e tretë, është po OEA ai që ka përgjegjësinë për plotësimin e kriterit dhe të sigurojë që ofruesi i shërbimit i plotëson kërkesat.

2.V.8. Programe ndërgjegjësimi për aspekte të sigurisë

Me qëllim shmangien e mungesës së duhur të ndërgjegjësimin, aplikuesi “do të sigurohet që i gjithë personeli që ka përgjegjësi për aspekte të sigurisë të marrë pjesë regullisht në programe për rritjen e ndërgjegjësimin për aspektet e sigurisë”. Aplikuesi duhet të zhvillojë mekanizma për edukimin dhe trajnimin e stafit për politikën e sigurisë, njohjen e shmangieve nga këto politika dhe për të kuptuar veprimet që duhen marrë në raste të shkeljeve të sigurisë.

Në veçanti, aplikuesi duhet:

- të edukojë personelin dhe kur është e përshtatshme edhe partnerin e biznesit, përsa u takon risqeve të zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit;
- t’u japë material didaktik, udhëzime dhe trajnime për identifikimin e ngarkesave potencialisht të dyshimta, për të gjithë personelin e përfshirë në zinxhirin e furnizimit, si p.sh. punonjësit e sigurisë, punonjësit e ngarkim-shkarkimit, personelit që merret me dokumentacionin e ngarkesave, si dhe personelit që punon në zonën e dokut. Këto trajnime duhet të jenë kryer përpara se operatori ekonomik të aplikojë për statusin OEA;
- të ketë dokumente për metodat didaktike, udhëzimet dhe trajnimet e organizuara me qëllim rritjen e ndërgjegjësimin;
- të ndërgjegjësojë punonjësit për procedurat që ka kompania për identifikimin dhe raportimin e incidenteve të dyshimta;
- të organizojë trajnime specifike për punonjësit për integritetin e ngarkesave, për njohjen e rreziqeve potenciale për sigurinë dhe për ruajtjen e kontrollit të aksesit;
- të rishikojë dhe përditësojë përmbajtjen e trajnimeve, sa herë që nevojiten rregullime. Përmbajtja e trajnimeve duhet të reflektojë çdo kërkesë specifike që lidhet me aktivitetin specifik të biznesit të një operatori ekonomik, si p.sh. posta ajrore/pakot ajrore.

Nuk ka ndonjë shpeshësi të caktuar për organizimin e trajnimeve për aspektet e sigurisë. Megjithatë, duke qenë se personeli, ndërtesat dhe qarkullimi mund të ndryshojnë, niveli i ndërgjegjësimin duhet të ruhet përmes trajnimeve të vazhdueshme.

Gjithashtu, për të gjithë punonjësit e rinj dhe për punonjësit e kompanisë që e kanë marrë rishtazi detyrën është e nevojshme që ata të trajnohen në lidhje me zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit.

Mekanizmat e sipërpërmendur për edukimin dhe trajnimin e personelit për aspekte të politikave të sigurisë duhet të jenë në përputhje me sipërmarrjen. Kështu p.sh. për SME-të e vogla, autoritetet doganore mund të pranojnë edhe trajnime verbale por të dokumentuara dhe kujtesa të kërkesave bazë të sigurisë dhe mbrojtjes ose thjeshtë një njoftim ndërgjegjësimi nga ana e stafit.

Shpeshtësia dhe intensiteti i trajnimeve për sigurinë mund të ndryshojë nga një punonjës tek tjetri brenda një sipërmarrjeje për shkak të përgjegjësive dhe mundësive individuale të influencës në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit.

Aplikuesit dhe punonjësit e tyre inkurajohen të përdorin një instrument të Komisionit Europian që quhet “AEO eLearning tool” për të marrë njohuri të përgjithshme mbi konceptin e OEA dhe kërkesat që lidhen me sigurinë të publikuar në faqen e D.P.D-së ëëë.dogana.gov.al

2.V.9. Personi i caktuar i kontaktit

Neni 53, pika 1, gërma “ë” e VKM nr. 651, datë 10.11.2017, parashikon që *"aplikuesi të caktojë një person kontakti kompetent për aspektet e sigurisë"*. Ky person kontakti duhet t'i njoftohet D.P.D. Vlen të theksohet se ky kusht nuk lidhet me aspektin e “sigurisë në vendin e punës”, duke qenë se është jashtë fushës së kriterit të sigurisë dhe mbrojtjes.

Ky person duhet të jetë personi i kontaktit për çdo çështje që ka lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen që lind nga brenda kompanisë dhe nga D.P.D.

Pavarësisht se ky funksion mund të jetë i nënkontraktuar ose jo, aplikuesi duhet të sigurohet që ky person të jetë plotësisht i përgjegjshëm për të gjitha çështjet specifike të sigurisë së kompanisë dhe të jetë i autorizuar për të marrë dhe komunikuar materiale sensitive të sigurisë.

PJESA 3, Procesi i aplikimit dhe autorizimit

Procesi i paraqitjes së aplikimit për Operator Ekonomik të Autorizuar (OEA)

3.I.1. Përcaktimi i vendit ku paraqitet aplikimi:

Aplikimi për marrjen e një autorizimi OEA duhet të paraqitet *pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave*, në bazë të nenit 45, pika 2, të VKM nr.651, datë 10.11.2017.

3.I.2. Bizneset e mëdha

Sipas nenit 6, pika 32, e Kodit Doganor, *“Vendndodhje e përhershme biznesi” është zyra qendrore ose dega e biznesit, ku janë gjithmonë burimet e nevojshme njerëzore dhe ato teknike, nëpërmjet të cilave kryhen pjesërisht ose tërësisht operacionet e një personi që ka marrëdhënie me doganën.*

Marrja dhe pranimi i aplikimit

Procesi i përgjithshëm që ndiqet kur paraqitet një aplikim për një autorizim OEA përshkruhet në nenet 27 dhe 40 të Kodit Doganor si dhe në nenet 19-21, 27 dhe 29, si dhe 45-46 të VKM nr. 651, datë 10.11.2017.

Fillimisht aplikuesi duhet të plotësojë kushtet për paraqitjen e aplikimit, sipas përcaktimeve në pikën 1, të nenit 19, të VKM nr.651/2017.

Deri në implementimin e sistemit të informatizuar OEA sipas Planit të punës së ministrit të Financave dhe Ekonomisë, kolona 2 e aneksit A, të shtojcës A, të VKM nr.651, datë 10.11.2017, nuk do të zbatohet por *do të zbatohen të dhënat e përcaktuara në anekset përkatëse të shtojcës C*, të këtij vendimi.

Kështu, *aplikimi për një autorizim OEA* duhet të bëhet me shkrim ose në formë elektronike, në përputhje me speciminin e përcaktuar në *aneksin 12, të shtojcës C*, të VKM Nr.651/2017.

Së bashku me aplikimin paraqitet edhe *Pyetëtori i Vetëvlerësimit*, në përputhje me *aneksin 13, të shtojcës C*, të VKM Nr.651/2017.

Me marrjen e formularit të aplikimit, autoritetet doganore e shqyrtojnë atë dhe vendosin për t'a pranuar ose jo.

Për këtë mbahen në konsideratë këta elementë të përgjithshëm:

- aplikimi duhet të paraqitet sipas kërkesave të nenit 27 të Kodit Doganor dhe nenit 19 të VKM nr. 651/2017;
- aplikimi duhet të shoqërohet me PyetëSORIN e Vetëvlerësimit, sipas Aneksit 13, të shtojcës C, të VKM nr.651/2017, të plotësuar në mënyrën e duhur, siç përcaktohet në nenin 45 të VKM nr. 651/2017;
- Autoritetet doganore duhet të kenë të gjithë informacionin e nevojshëm për të pasur mundësinë të kontrollojnë aplikimin dhe për të vendosur pranimin ose refuzimin e tij. Kjo mund të arrihet përmes aksesit në bazën e të dhënave që disponohen ose duke i kërkuar aplikuesit t'i paraqesë këto të dhëna bashkë me aplikimin;
- Sipas rastit, dogana duhet të përdorin burime të tjera informacioni si p.sh.: bazat e të dhënave brenda institucionit, kontaktet me autoritete të tjera, informacion nga faqja e internetit e kompanisë etj.;
- Në rast se kërkohet informacion shtesë, autoritetet doganore duhet ta kërkojnë atë nga aplikuesi sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së aplikimit sipas nenit 27 të Kodit Doganor;
- Në rastin kur autoritetet doganore përcaktojnë se aplikimi nuk përmban gjithë informacionin që kërkohet, ato i kërkojnë aplikuesit të sigurojë informacionin e kërkuar brenda afateve të arsyeshme kohore që nuk kalojnë 30 ditë, sipas nenit 29, pika 2 të VKM nr. 651/2017;

- Autoritetet doganore duhet gjithmonë të informojnë aplikuesin për pranimin e aplikimit dhe datën e pranimi; ato gjithashtu duhet ta informojnë aplikuesin në rast mos-pranimi të aplikimit, duke parashtuar edhe arsyet që kanë çuar në mos-pranim (Neni 27 pika 2 i Kodit Doganor);

Sapo aplikuesi merr njoftimin që aplikimi i tij është pranuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, rekomandohet që ai të bëjë maksimumin për të përshpejtuar procesin në përgjithësi. Rekomandohet që të shikohen në veçanti këto aspekte:

- konsolidimi i informacionit dhe evidencave të njërive/departamenteve të ndryshme në lidhje me procesin e aplikimit për OEA;
- dhënia e informacionit - rekomandohet që njësitë përgjegjëse të njohin përgjegjësitë specifike përsa u takon procesit/kërkesave të përgjithshme OEA dhe të jenë të gatshme të sigurojnë informacionin e nevojshëm;
- *folloë-up* – kompania duhet të marrë masa për korrigjimin e dobësive të zbuluara gjatë plotësimit të pyetësorit të vetëvlerësimit dhe të zbusë risqet. Dogana duhet të informohet për problemet me përputhshmërinë. Gjithashtu rekomandohet që dogana të informohet në lidhje me masat e marra;
- *konsultimet me doganat* – të sqarohet çdo dyshim që ka kompania me administratën doganore.

Procesi i analizës së riskut dhe auditimi

Vlen të theksohet se termi auditim doganor mbulon lloje të ndryshme kontrolli apo vlerësimi doganor që kryhen nga dogana, për të garantuar që operatorët ekonomikë të veprojnë sipas procedurave dhe legjislacionit doganor. Auditimi mbulon auditimin paraprak, auditimin aposterior dhe rivlerësimin.

Auditimi paraprak është proces që kryhet nga dogana përpara lëshimit të çdo autorizimi doganor. Në kontekstin e OEA, auditimi paraprak është auditimi që pason aplikimin për OEA dhe shërben për të verifikuar nëse aplikuesi i përmbush kriteret e caktuara në nenin 41, të Kodit Doganor. Si rrjedhojë e auditimit paraprak, audituesi mund të jetë në gjendje të:

- japë një gjykim në lidhje me përmbushjen e kushteve për dhënien e statusit OEA;
- të identifikojë risqet që mbeten dhe të propozojë veprime të mëtejshme;
- të identifikojë elementë të procedurave të operatorit që kërkojnë monitorim nga afër dhe të këshillojë aplikuesin të përmirësojë apo forcojë kontrollet dhe procedurat përkatëse.

Në kohën e marrjes së statusit duhet të bëhet dallimi midis monitorimit dhe rivlerësimit. **Monitorimi** bëhet në vazhdimësi nga autoritetet doganore, duke monitoruar aktivitetin e përditshëm të OEA-s, duke përfshirë vizitat në vend. Ai ka për qëllim zbulimin e hershëm të çdo sinjali për mos-përputhshmëri dhe çon në masa të menjëhershme në rast se zbulohen vështirësi apo mos-përputhshmëri.

Rivlerësimi nënkupton se diçka është zbuluar dhe duhet të merren veprime për të verifikuar nëse operatori ekonomik vazhdon t'i përmbushë kriteret e OEA-s. Në këtë kontekst është e qartë se nga monitorimi mund të lindë nevoja për rivlerësim.

3.III.1. Mbledhja dhe analiza e informacionit

Për të bërë një analizë të riskut dhe për një auditim efikas është e rëndësishme që Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të mbledhë sa më shumë informacion në lidhje me operatorin ekonomik. Informacioni mblidhet me qëllim që:

- të kuptohet më mirë biznesi i një operatori ekonomik dhe mjedisi në të cilin ai operon;
- të përftohet një panoramë e organizimit të biznesit të operatorit ekonomik, si edhe e proceseve dhe procedurave;
- të hartohet një plan auditit, sipas rezultateve të vlerësimit të riskut;
- të përgatitet auditit (ekip i mirë auditit, fokusi i auditit, etj.);
- të verifikohet sa më shumë të jetë e mundur plotësimi i kriterëve.

Informacioni që mund të marrin autoritetet doganore nga burime të ndryshme përfshin:

- baza të dhënash të brendshme;
- informacion i brendshëm (rezultatet e kontrolleve të mëparshme, apo auditit; autorizime të tjera që i janë dhënë apo hequr dhe dokumentet mbështetëse, shqyrtim i deklaratave të mëparshme doganore, etj.);
- informacion i kërkuar dhe i dhënë nga autoritete të tjera;
- informacion i dhënë nga vetë operatorët ekonomikë (si p.sh. Pyetësi i Vetëvlerësimit);
- informacion publik (lajme, internet, studime, raporte, etj.);
- çdo informacion tjetër të duhur, duke përfshirë imazhe, fotografi, harta etj.

I gjithë informacioni i mbledhur duhet të vlerësohet me kujdes për të vlerësuar saktësinë dhe rëndësinë përkundrejt objektivit të auditit. Duhet të jetë e qartë se mbledhja e informacionit është një proces dinamik dhe mund edhe të ndodhë që “informacioni të kërkojë më shumë informacion”. Aplikuesi duhet ta ketë të qartë këtë dhe të jetë i gatshëm tu japë doganave çdo informacion shtesë që atyre u duhet. Edhe kur të ketë nisur shqyrtimi, audituesit mund të kërkojnë dhe të mbledhin informacione të tjera shtesë që i

shtojnë vlerë rezultatit. Duhet gjithashtu të mbahet në konsideratë se informacioni ndryshon dhe ndonjëherë ka vlerë vetëm për momentin që është mbledhur. Ndaj është e rëndësishme që informacioni të jetë i azhurnuar. Për të garantuar që administrata doganore është e azhurnuar me ngjarjet që mund të ndikojnë në rezultatin e fazës së aplikimit si dhe më pas, është e rëndësishme të gjendet dhe komunikohet me aplikuesin kur duhet më shumë informacion.

3.III.2. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME)

Bazuar në ligjin Nr.8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar,” ndërmarrje të vogla dhe të mesme quhen ato subjekte ku punësohen më pak se 250 persona dhe që realizojnë një xhiro vjetore më të vogël se 250 milionë lekë.

Për qëllimet e autorizimit të OEA-s dhe kërkesat për përputhshmëri duhet gjithashtu të mbahet në konsideratë se SME-të janë të ndryshme nga madhësia, kompleksiteti i biznesit, llojit të mallrave të trajtojnë, pozicioni në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit etj. Për shembull:

- një aplikues me 51 punëmarrës që importon gota trajtohet ndryshe nga një aplikues me 249 punëmarrës që importon armë dhe që ka zbatuar masa të ndryshme sigurie;
- një agjent doganor me 4 të punësuar që vepron si nënkontraktor për një prodhues tjetër me 150 punonjës ilustron gjithashtu diversitetin e situatës së SME-ve.

Sipas të dhënave të një studimi të kryer nga INSTAT në vitin 2018, 99,8 % të ndërmarrjeve aktive e zënë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat mbulojnë 79,8 % të numrit total të të punësuarve në vendin tonë.

Ato gjithashtu po shndërrohen në një pjesë esenciale të zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit. Në disa raste, ato mund të përfaqësojnë pjesën më të madhe të operatorëve ekonomikë në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit, dhe shpesh veprojnë si nënkontraktorë për kompani më të mëdha.

Duke mbajtur parasysh, vështirësitë e mundshme për SME-të për të hyrë në procesin e autorizimit, si edhe për ta bërë statusin e OEA-s më të hapur edhe për SME-të, në legjislacionin për OEA është futur fleksibiliteti për minimizimin e kostove dhe barrierave. Edhe në rastin kur kriteret për OEA-t zbatohen për të gjitha bizneset pavarësisht nga madhësia e tyre, neni 54 i VKM nr. 651/2017 parashtron detyrimin ligjor që *"autoritetet doganore të mbajnë në konsideratë karakteristikat specifike të operatorëve ekonomikë, në veçanti të kompanive të vogla dhe të mesme, gjatë shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve për operator ekonomik të autorizuar"*. Paralelisht me këtë udhëzues, specifikat e SME-ve, përsa i takon autorizimit OEA do të trajtohen me shembuj.

3.III.3. Aktivitete specifike ekonomike

3.III.3.1. Operatorët ekspres

Roli i agjencive të transportit dhe transportuesve në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit përshkruhet në [Pjesën 1, Seksioni II.4](#) paragrafi (f) i këtij Udhëzuesi. Brenda këtij sektori të tregtisë ka një nën- sektor tjetër që dallon: *operatorët ekspres*. Në këtë nën-sektor futen një numër relativisht i vogël i operatorëve ekonomikë, por që kanë volume të rëndësishme transaksionesh; në disa shtete të BE-së, ky nën-sektor përfaqëson një të tretën e të gjithë ngarkesave të importit dhe afro 50% të të gjitha dërgesat për eksport.

Ky nën-sektor ka një sërë tiparesh dalluese:

- volume të larta transaksionesh;
- rëndësia e shpejtësisë së transportit dhe zhdoganimit të shpejtë – afate të shpejta të dorëzimit janë një instrument i rëndësishëm në marketing për këto biznese dhe kanë rëndësi për klientët;
- kanë një numër të madh dhe gamë të gjerë partnerësh biznesi, që nga klientët e zakonshëm, deri tek ata klientë privatë që përdorin këto shërbime vetëm një herë;
- operatorët ekonomikë shpesh luajnë rolin e agjentit/përfaqësuesit doganor, përveç rolit të agjencisë së transportit;
- duke qenë se mënyra e transportit është kryesisht me avion këta operatorë ekonomikë operojnë sipas Rregullores (EC) Nr. 300/2008² dhe plotësojnë kërkesat e Rregullores Zbatuese të Komisionit (EU) 2015/1998³ për shumicën e bizneseve të tyre;
- kanë ngarkesa në avionët e tyre apo marrin çanta të ngarkuara dhe paketime të tjera nga transportues të tjerë ajrorë;
- operatorët ekonomikë shpesh kanë autorizime nga autoritetet doganore për të përdorur procedura të thjeshtuara doganore.

Duke pasur parasysh këto tipare dalluese ekzistojnë një sërë risqesh për këtë nën-sektor që kërkojnë vëmendje të posaçme, kur operatorët ekonomikë aplikojnë për statusin OEA, p.sh.:

- niveli i shkeljeve në vlerësimin e kriterit të përputhshmërisë me doganat. Autoritetet doganore duhet t'i kushtojnë vëmendje volumit të madh të transaksioneve dhe të vlerësojnë nëse shkeljet janë sistematike; të vlerësojnë cilësinë e kontrollit dhe procedurave të brendshme të operatorëve ekonomikë, me qëllim evidentimin dhe korigjimin e gabimeve– shih [Pjesën 2 “kriteret OEA” të këtij Udhëzuesi](#);

➤ ² Rregullorja (EC) Nr 300/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11 mars 2008 “Mbi rregullat e përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, duke shfuqizuar Rregulloren (EC) Nr. 2320/2002.

➤ ³ Rregullorja Zbatuese e Komisionit (EU) 2015/1998, datë 5 nëntor 2015 parashtron masat e hollësishtme për zbatimin e standardeve bazë të përbashkëta për sigurinë ajrore

- siguria e të dhënave gjatë vlerësimit të sistemit të një operatori nga pikëpamja tregtare dhe e transportit, kur është e përshtatshme. Duke pasur parasysh volumin e madh të të dhënave, autoritetet doganore do të duhet të marrin masa për të mbrojtur sistemet e operatorit ekonomik nga aksesit i paautorizuar dhe duhet të ketë procedura për përpunimin e informacionit në sistemet që përdorin operatorët ekspres;
- gjatë vlerësimit nëse ekzistojnë standardet e duhura të sigurisë;
- shkelje të marrëveshjeve të rëna dakord për sigurinë, me riskun e dorëzimit të mallrave të pasigurta. Duke pasur parasysh gamën e gjerë të partnerëve të biznesit, autoritetet doganore do të duhet të vlerësojnë procedurat për përzgjedhjen e partnerëve të biznesit dhe menaxhimin e risqeve që lidhen me partnerët e panjohur tregtarë;
- personat që infiltrohen/hyjnë në biznes dhe që mund të jenë risk për sigurinë. Duke pasur parasysh volumet e mëdha të biznesit, autoritetet doganore do të duhet të vlerësojnë procedurat për kryerjen e kontroleve paraprake për punonjësit e rinj si për ata të përhershëm, ashtu edhe për ata që janë të përkohshëm;
- mosnjohja si duhet e kërkesave të sigurisë. Autoritetet doganore do të duhet të vlerësojnë procedurat për të organizuar trajnime që të mbulojnë risqet që lidhen me sigurinë në kuadrin e lëvizjes së mallrave ekspres.

3.III.3.2. Operatorët postarë

Operatori postar ka veçantitë e veta dhe duhet t'u kushtohet vëmendje e posaçme karakteristikave dhe risqeve të lidhen me këtë veprimtari. Duke qenë se supozohet se kriteri për aftësinë e provuar pagueuse do të vlerësohet njësoj si për operatorët e tjerë, fokusi do të jetë tek disa aspekte specifike që lidhen me kritere të tjera të OEA.

Kontrolli i përputhshmërisë

Një operator postar ka të bëjë me shpërndarjen e një shërbimi për një numër të vogël klientësh/përdoruesish, qëndrueshmëria e të cilëve nuk është e lehtë për tu kontrolluar. Pasojat lidhen me probleme të ndryshme përsa u takon detyrimeve doganore dhe me sigurinë e kontrollit të përputhshmërisë doganore. Shembuj të risqeve në fushat që lidhen me operacionet doganore mund të jenë:

- numri i lartë i pakove “të vogla”, dmth, peshë e vogël/pako me vlerë;
- deklaratat që bëhen nga klientët (kryesisht individë) nuk plotësohen mirë: me gabime në deklarata, në lidhje me vlerën dhe gabime në përshkrim të

përmbajtjes së pakos, mungesë dokumentesh mbështetëse që shoqërojnë deklaratat dognore dhe vështirësitë në përmbushjen e kërkesave doganore (mungesë certifikatash/licencash etj.);

- vonesa në shpërndarje e shkaktuar nga transportuesi;
- risk i lartë i pakove që humbasin/nuk dihet ku janë vendosur.

Rrjedhimisht, gjatë procesit të auditimit të kriterit të pajtueshmërisë doganore, përvec mbajtjes në konsideratë të shkallës dhe llojit të operatorit ekonomik, audituesi duhet të marrë në konsideratë edhe rastet e numrit të shkeljeve në krahasim me totalin e transaksioneve vjetore, me qëllim vlerësimin e riskut potencial. Menaxhimi i procedurës për hyrjen në regjistrat e deklaruesit duke hequr detyrimin që mallrat të paraqiten dhe procedura e magazinimit doganor janë elementët më të rëndësishëm që do të vlerësohen, duke vlerësuar gjithashtu edhe risqet e mbetura.

Sistemet e kontabilitetit dhe ato të logjistikës

Një nga risqet që do të mbahet në konsideratë është menaxhimi i inventarëve ku raportohen posta/pako të padërguara (p.sh. kur ka qenë e pamundur të gjendet përfituesi ose kur përfituesi nuk është paraqitur për t'i marrë). Në lidhje me këtë aspekt kritik është e nevojshme të bëhet një vlerësim i kostove të magazinimit (dhe kostove të shkatërrimit, nëse specifikohet në rregulla) apo të kostove që lidhen me kthimin te dërguesi. Kjo mund të ketë ndikim të rëndësishëm në ndjekjen e operacioneve doganore dhe atyre të kontabilitetit dhe ndikim në organizimin logjistik, si edhe në menaxhimin, kostot, sigurinë e stokut dhe magazinës.

Një situatë e tillë operative kërkon që sistemi IT të jetë i strukturuar në mënyrë të tillë që të garantonë ndjekjen e të gjitha operacioneve doganore, si të eksportit ashtu edhe të importit, si edhe sigurinë e të dhënave përkatëse.

Gjatë vlerësimit të efikasitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm është e rëndësishme të kontrollohet nëse ka persona që përgjigjen për monitorimin e kontrollit të përputhshmërisë me rregullat dhe procedurat doganore, dhe si zbulohen dhe mbulohen risqet përkatëse. Duhet të vlerësohet ndikimi i ngjarjeve të ndryshme të mundshme negative në aktivitetin e operatorit si dhe efikasiteti i procedurave të ndjekura për zgjidhjen e rasteve të papajtueshmërisë doganore.

Gjithashtu, po prapë në lidhje me kontrollin e brendshëm është e rëndësishme të kontrollohet se cilat baza të dhënash dhe cilat procedura informacioni janë përdorur për ruajtjen e të dhënave në lidhje me klientët dhe ngarkesat.

Një tjetër aspekt që duhet të vlerësohet është menaxhimi i transportit tokësor, sidomos nëse ka të bëjë me një operator aeroportual, rast në të cilin është e nevojshme të vlerësohet sa të besueshëm janë shoferët që do të marrin pakot.

Kërkesat e sigurisë

Në këtë kontekst, rekrutimi i personelit është aspekt shumë i rëndësishëm. Ka rëndësi t'i kushtohet vëmendje numrit të punëtorëve të rastit dhe shpeshësisë që ata punësohen. Sa më i madh të jetë numri i tyre dhe sa më shpesh të punësohen aq më i madh është rreziku potencial i infiltrimit me qëllim kryerjen e aktiviteteve të paligjshme, siç janë: bomba si pako, drogë etj.

Kriteret për përzgjedhjen që përdoren gjatë rekrutimit të personelit që do të punojë me operacione të posaçme, si p.sh. personat në kontakt direkt me mallra sensitive nga magazina apo zona me risk të lartë duhet të vlerësohen me shumë kujdes.

Gjithashtu është e nevojshme të kontrollohet shpeshësia me të cilin operatori e kryen monitorimin e personelit, sipas legjislacionit në fuqi. Kontratat me punonjësit duhen parë me shumë kujdes.

I gjithë personeli, pavarësisht nga lloji i kontratës me të cilën ata janë të punësuar duhet të jetë mirë i trajnuar nga ana profesionale, sidomos në lidhje me procedurat dhe rregullat doganore. Për të pasur një standard të lartë cilësor në aplikimin e procedurave të sigurisë është e nevojshme të ketë një nivel të duhur trajnimit, duke përfshirë personelin që punon me skanimin e mallrave të veçanta.

Për të garantuar sigurinë në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit, një operator postar duhet:

- të ketë udhëzime për sigurinë dhe të trajnojë stafin në lidhje me risqet e aktivitetit postar;
- të ketë organizim të mirë të brendshëm, që lejon rritjen e shpeshësisë së inspektimeve gjatë ngjarjeve me risk specifik apo pas raporteve specifike të shërbimeve të inteligjencës;
- të trajnojë inspektorët e postës në pikat e sigurisë dhe t'i përditësojë ata me informacion për identifikimin e ngarkesave që mund të jenë potencialisht të rrezikshme, duke mbajtur në konsideratë tregues risku si p.sh:
 - nuk tregohet emri i dërguesit;
 - përfitues sensitivë (institucione politike, diplomatike, financiare, fetare, shtypi etj.);
 - prania e shenjave apo markimeve që shmang kontrollin, si p.sh.: "Të mos ekspozohet ndaj rrezeve X", "Konfidenciale", "nuk kërkon inspektim postar", "të mos hapet" etj.;
 - tipare të pazakonta makroskopike apo kimike (si p.sh. pako e nxehtë, prania e aromave të pazakonta, humbje apo përhapje e lëndës, ç'ngjyrosje e paketimit, pika vajore, zhurma që vijnë nga brenda etj.).

Një operator postar duhet gjithashtu të marrë masa nga aspekti logjistik/organizativ i hapësirave që përdoren për magazinimin e pakove përmes sa më poshtë vijon:

- të ketë zona të veçanta ku mund të kryhet kontrolli i sigurisë për pakot që kanë mbërritur apo që nisen;
- të mbajë ta ndara fizikisht mallrat që i nënshtrohen kontrollit nga ato që ende nuk janë inspektuar;
- t'u kërkojë klientëve të përdorin produkte të cilave mund t'u garantohet gjurmimi;
- të hartojë një plan reagimi për identifikimin, izolimin dhe neutralizimin e një rreziku të kapur;
- të krijojë një zyrë kontakti sigurie për doganat, policinë, shërbimet inteligjente, autoritetet shëndetësore, sipas llojit të shërbimit që ofrohet dhe rëndësisë së tij.

Si konkluzion, duke pasur parasysh shkallën dhe karakteristikat specifike të shërbimit që ofrohet nga operatorët postarë, si edhe numrin e transaksioneve, si edhe me qëllim që të ketë procedura të sigurta nga pikëpamja doganore, logjistike, ajo e kontabilitetit dhe sigurisë është e rëndësishme që të gjitha procedurat të standardizohen me rigorozitet, bashkë me protokolle të brendshme procedurash të detajuara që përdoren në punë çdo ditë.

3.III.3.3. Transportues hekurudhor

Në përgjithësi, auditimi që i bëhet një transportuesi hekurudhor nuk dallon shumë nga transportuesit e tjerë. Madje mund të thuhet se operatorët hekurudhorë përfaqësojnë një risk më të ulët për shkak të natyrës së modalitetit të transportit. Megjithatë, planifikimi i aktivitetit të auditimit dhe vlerësimi i risqeve ndihmon në përcaktimin e disa tipareve të veçanta për operatorët hekurudhorë:

- operatorët hekurudhorë kanë **marrëveshje** dhe konventa ndërkombëtare detyruese (COTIF, CIM). Këto marrëveshje mund të vendosin kërkesa që lidhen me plumbçet dhe integritetin e ngarkesës. Një element që mund të trajtohet është përgjegjësia gjatë transportit;
- trafiku hekurudhor i nënshtrohet **rregulloreve dhe certifikatave të sigurisë hekurudhore** si në lidhje me sigurinë e pasagjerëve, ashtu edhe më atë të ngarkesave. Këtu mund të përfshihen kërkesa për sistemet e menaxhimit të sigurisë, sigurisë së personelit dhe sistemet e kontrollit të brendshëm;
- operatorët hekurudhorë veprojnë në një mjedis të fragmentuar nga pikëpamja rregullatore. Operacionet hekurudhore mund të rregullohen dhe monitorohen nga **disa autoritete kombëtare**;
- mjedisi i punës përmban disa elementë që kontrollohen shpesh nga palë të treta që përgjigjen për infrastrukturën si: shinat, stacionet hekurudhore,

terminalët e kontenierëve, apo palë të treta përgjegjëse për njësitë e ngarkesave;

- aplikuesi mund të ketë një strukturë të ndërlikuar organizative, shumë vende pune dhe një gamë të gjerë operacionesh. Operacionet gjithashtu mund të ndahen në: mallra dhe pasagjerë;
- operatorët hekurudhorë mund të punojnë me një sërë partnerësh biznesi, zakonisht të njohur. Këta mund të jenë agjenci rrugore, operatorë magazinash, operatorë portesh dhe ofrues shërbimesh për sigurinë e stacioneve hekurudhore. Ngarkim-shkarkimi i mallrave/kontenierëve nga vagonët mund të jetë përgjegjësi e transportuesit. Megjithatë, ngarkim-shkarkimi i mallrave zakonisht është përgjegjësi e pasagjerit. Operatorët hekurudhorë nuk përgjigjen për ngarkimin apo shkarkimin e mallit dhe as palët e treta që lidhen me ta. Vetëm në rastet kur operatorët hekurudhorë ofrojnë shërbim për pako dhe shërbime të tjera logjistike mund të kenë përgjegjësi për trajtimin e mallrave;
- gjatë transportit, disa persona mund të jenë të përfshirë në administrimin e dokumenteve apo në kontrollin e vagonëve të mallrave. Vetëm në rastet kur operatorët hekurudhorë ofrojnë vetë shërbim për pako dhe shërbime të tjera logjistike, administrojnë mallrat në pikat e transferimit, qendra logjistike apo magazina.

Gjatë vlerësimit të riskut dhe auditit të një operatori hekurudhor që aplikon për Statusin e OEA duhet të mbahet në konsideratë:

- për të kuptuar më mirë mjedisin e biznesit, autoritetet doganore duhet të kërkojnë nga aplikuesi tu bëjë një prezantim të shkurtër mbi rregulloret, marrëveshjet dhe konventat ku ai merr pjesë apo aderon, përpara auditimit;
- gjatë përgatitjes për auditim, audituesit duhet të kenë një panoramë të qartë të zonave dhe hapësirave, godinave, zyrave të përfshira në operacionet doganore, për të përcaktuar nëse aplikuesi e ka situatën nën kontroll. Këto janë vendet ku administrohen dokumentet doganore, njësitë e ngarkesave dhe mallrat;
- parandalimi i aksesit të paautorizuar tek mallrat dhe njësitë e ngarkesave nënkupton metoda survejimi të sigurisë, sidomos në stacione të hapura hekurudhore dhe gjatë transportit/ngarkim-shkarkimit dhe ndalimeve;
- gjurmimi i njërive të ngarkesave, procedurat e sigurisë që lidhen me kalimin e kufirit (kamera survejimi, skanim), peshimi i mallit dhe pika inspektimi (sidomos pas magazinimit afatgjatë);
- procedurat e plumbosjes, duke përfshirë udhëzimet për rastin e shkeljes së procedurave të sigurisë;
- identifikimi i partnerit të biznesit dhe përfshirja e kërkesave të sigurisë në kontrata, edhe për partnerët *ad hoc*. Për shkak të delegimit të aktiviteteve kryesore (ngarkim/shkarkim/survejim sigurie) aplikuesi duhet të menaxhojë risqet që lidhen me partnerin e biznesit përmes zbatimit të kërkesave në kontrata dhe monitorimit të tyre. Gjithashtu procedurat në rast të shkeljes së

- sigurisë luajnë një rol të rëndësishëm për përforcimin e sigurisë së zinxhirit të furnizimit;
- organizimet e seminareve për aspekte të sigurisë;
 - procedura për informimin dhe administrimin e rasteve të shkeljeve të sigurisë, si kërkesa kryesore.

3.III.4. Faktorë që lehtësojnë procesin e autorizimit

3.III.4.1. Të përgjithshme

Operatorët e ndryshëm ekonomikë, për shkak të aktiviteteve të tyre ekonomike duhet të përmbushin standarde dhe rregullore të ndryshme, përveç kërkesave OEA. Programi për OEA përpiqet të marrë në konsideratë dhe të bazohet mbi standardet dhe certifikimet/autorizimet ekzistuese, pa përfshirë kërkesat për certifikatë/autorizim për tu bërë OEA.

Operatorëve ekonomikë jo gjithmonë u duhet të kenë status OEA për të pasur një autorizim për një thjeshtim, e parashikuar kjo në legjislacionin doganor, ndërsa për disa nga këto thjeshtime ata duhet të përmbushin disa kritere OEA, apo pjesë të kritereve OEA për të marrë autorizimin përkatës.

Me qëllim përshpejtimin e përpunimit të aplikimeve dhe për të shkurtuar kohën që nevojitet për auditim, autoritetet doganore, kurdoherë që të jetë e mundur duhet të përdorin informacionin paraprak që kanë në lidhje me aplikuesin. Dhe këtu mund të përfshihet informacion nga:

- aplikime të mëparshme për autorizime doganore dhe rezultate të proceseve;
- informacion që autoriteti doganor e ka marrë paraprakisht apo informacion që e kanë autoritete të tjera publike dhe që ua ka vënë në dispozicion AD;
- rezultatet e auditeve doganore;
- procedura doganore/deklarata që ka bërë aplikuesi;
- standarde ekzistuese të aplikueshme dhe certifikata/autorizime që mban aplikuesi;
- rezultate ekzistuese të vlerësimeve apo auditeve të kryera sipas legjislacionit shqiptar, në masën që ato kanë rëndësi për shqyrtimin e kritereve (neni 54, pika 2, e VKM nr. 651/2017), si dhe konkluzionet ekzistuese të ekspertëve përkatës (neni 54, pika 3, e VKM nr. 651/2017).

Megjithatë, në varësi të rrethanave të çdo rasti, duke mbajtur kryesisht në konsideratë kohën me të cilën lidhet ky informacion, autoriteteve doganore mund t'u duhet të marrin edhe një herë në shqyrtim apo të kërkojnë konfirmim nga autoritetet e tjera, për tu siguruar që informacioni (pjesërisht apo plotësisht) është ende i vlefshëm.

Vëmendje e veçantë do tu kushtohet rasteve ku legjislacioni përcakton njohjen automatike të standardeve të sigurisë dhe mbrojtjes, dmth:

- Në rastet kur aplikuesi është mbajtës i një certifikate/autorizimi për sigurinë dhe mbrojtjen të lëshuar në bazë të një konvente ndërkombëtare apo të një standardi ndërkombëtar të një Organizate Ndërkombëtare për Standardizim apo të një enti evropian të standardizimit, këto certifikata do të merren parasysh gjatë kontrollit të pajtueshmërisë me kriteret e sigurisë dhe mbrojtjes.

Kriteret do të konsiderohen të përmbushura deri në masën që është e përcaktuar se kriteret për lëshimin e asaj certifikate janë identike ose ekuivalente me ato të parashikuara në nenin 41, shkronja “dh” të Kodit Doganor.

Kriteret do të konsiderohen të përmbushura në rastet kur aplikuesi është mbajtës i një certifikate sigurie të lëshuar nga një vend i tretë me të cilin Shqipëria ka një marrëveshje që e njeh atë certifikatë/autorizim.

Kjo është e vlefshme vetëm për certifikata të lëshuara nga certifikues të akredituar ndërkombtarisht ose nga autoritete kompetente vendase.

Gjithashtu ka një sërë standardesh dhe certifikatash ndërkombëtare dhe kombëtare, si edhe konkluzione të dhëna nga ekspertët në fushën e ruajtjes së të dhënave, aftësisë paguese apo standardeve të sigurisë dhe mbrojtjes që mund të pranohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sipas nenit 54, pika 3, të VKM nr.651/2017. Në këto raste, paraqitja e një certifikate nuk nënkupton që kriteri korrespondues OEA është automatikisht i përmbushur dhe si i tillë nuk do të kontrollohet më. Në fakt, autoriteti doganor mund të përcaktojë nëse dhe deri në çfarë mase përmbushet kriteri.

Në këtë kontekst ka disa tregues të ndryshëm që duhen marrë në konsideratë për të vlerësuar nëse dhe në çfarë mase certifikata apo standardi është i vlefshëm apo ndihmon në procedurën e aplikimit për OEA. Disa nga këta tregues janë:

- Kush e ka lëshuar certifikatën/autorizimin ose kush e ka kompetencën për të dhënë standardin? A jepet certifikata/autorizimi nga një autoritet apo nga një palë e tretë? A është e akredituar ndërkombtarisht pala e tretë?
- Në çfarë mënyre lëshohet certifikata/autorizimi? A bëhen këto kontrolle nga ndonjë autoritet (shembuj në [Pjesa 3, Seksioni III, pika 4.2. e këtij Udhëzuesi](#)), nga pyetëtori i vetëvlerësimit të një operatori apo ka ndonjë verifikim që bëhet nga ndonjë palë e tretë e pavarur apo e akredituar?
- A ka pasur audit në vend apo ka pasur vetëm verifikim dokumentesh?
- Për çfarë arsyeje aplikon operatori për certifikatën/autorizimin?

- A bëhet procesi i certifikimit/autorizimit nga vetë kompania apo kompania ka ndonjë konsulent?
- Certifikata/autorizimi është i vlefshëm për të gjithë kompaninë, për një pjesë të saj apo vetëm për një proces?
- Kur është lëshuar certifikata/autorizimi? Kur është bërë auditimi i fundit? Cilat ishin konkluzionet e auditit të fundit?

Lista e standardeve dhe certifikatave/autorizimeve që jepen më poshtë nuk është shteruese. Për shkak të morisë së aktiviteteve ekonomike të operatorëve ekonomikë dhe të elementëve të veçantë kombëtarë ajo përfshin vetëm ata që janë më të zakonshëm/hasen më shumë.

Vlen të theksohet se aplikuesit mund të paraqesin informacion për çdo standard që kanë plotësuar apo për certifikatat/autorizimet që mbajnë dhe që kanë ndikim për kriteret OEA, tek autoritetet doganore. Më pas, autoriteti kompetent doganor do të shqyrtojë nëse ato mund të mbahen në konsideratë dhe deri në çfarë mase. Kjo është gjithashtu e vlefshme nëse një operator ekonomik është këshilluar nga një autoritet/institucion i pavarur, në rastet që ndikojnë kriteret OEA, pa çuar në certifikim/autorizim.

Gjithashtu vlen të theksohet se për tu bërë një OEA nuk është e nevojshme të mbash ndonjë nga certifikatat/autorizimet apo të këshillohesh nga palë të treta. Nëse disponohen të tilla certifikata/autorizime, ato mund të jenë të dobishme për autoritetet doganore (shih gjithashtu shënimet shpjeguese të Pyetësorit të Vetëvlerësimit për seksionet 3 dhe 6, në lidhje me sistemin kontabël dhe atë të logjistikës, si edhe me kërkesat e sigurisë).

Është gjithmonë përgjegjësi e aplikuesit të vërtetojë se i përmbush kriteret OEA.

3.III.4.2. Certifikatat/autorizimet që lëshohen nga dogana apo autoritete të tjera shtetërore

a) Autorizimet ekzistuese doganore

Kur një operator ekonomik aplikon për statusin OEA duhet të mbahen në konsideratë të gjitha autorizimet e tjera doganore që ai ka marrë.

b) certifikatat e lëshuara nga agjencitë apo autoritetet e aviacionit

Autoritetet e aviacionit miratojnë entitetet që do të merren me administrimin e ngarkesave ajrore. Në varësi të rolit në zinxhirin e furnizimit, enteve mund tu jepet statusi i një agjenti të rregulluar (AR) apo RC nga autoritetet e lartpërmendura, ndërsa Agjenti i Llogarisë (AC) caktohet direkt nga RA.

RA janë kompani si: agjenci, spedicionerë, apo njësi të tjera që punojnë me linjat ajrore dhe bëjnë kontrollin e sigurisë, janë të njohura apo janë caktuar nga autoriteti kompetent për ngarkesat, pakot apo postën ekspres.

Një DNJ (dërgues i njohur) është një dërgues që e nis mallin apo postën për llogari të vet dhe procedurat e të cilit plotësojnë rregullat dhe standardet e zakonshme, për të lejuar ngarkimin e pakove, postës apo ngarkesave në avion.

- siguria e ndërtesave
- kontroll i saktë i aksesit
- siguria e ngarkesave (ngarkesës)
- siguria e personelit

Për këtë arsye, në fushat e lartpërmendura ka shumë gjasa të ketë kushte që janë të zakonshme dhe për rrjedhojë të konsiderohen si të përmbushura .

Në rast se aplikuesi për OEAS është miratuar si KC ose si RA duhet të vlerësohet siç duhet nëse aplikuesi ka aktivitete të tjera biznesi dhe nëse “po”, ato duhet të shqyrtohen. Nuk duhet të ketë njohje automatike të elementëve të sigurisë, por njëkohësisht edhe duplikimi dhe ri-ekzaminimi i të njëjtave fusha dhe veprime duhet të përjashtohet.

Ndonëse nuk ekziston një njohje juridike e statusit AC, ndiqen objektiva të ngjashme në mënyrë që statusi AC të jetë i dobishëm edhe gjatë procedurës së autorizimit për OEA.

c) Kodi ndërkombëtar për sigurinë e anijeve dhe objekteve portuale (ISPS)

IMO-ja ka miratuar si pjesë të konventës detyruese, ndërkombëtare “Siguria e jetës në det (SOLAS)”, një kod ndërkombëtar detyrues për sigurinë e anijeve dhe mjeteve portuale, që titullohet “Kodi ndërkombëtar për Sigurinë e anijeve dhe objekteve portuale (ISPS-Code)”. Në këtë kod përshkruhen përgjegjësitë e qeverive, kompanive detare, kapitenerive, personelit përkatës, porteve, mjeteve portuale dhe personelit, për të kryer vlerësimin e riskut dhe analizën e riskut dhe për të zhvilluar, ruajtur dhe përmirësuar planet e sigurisë për kompanitë që bëjnë transport detar dhe mjetet e tyre, si edhe për portet dhe mjetet portuale, me qëllim parandalimin e incidenteve të sigurisë për anijet apo facilitetet portuale që përdoren në tregtinë ndërkombëtare.

Kërkesat e sigurisë së Kodit ISPS përfshijnë masa për sigurinë fizike, duke përfshirë kontrollin e aksesit në anije dhe objektet portuale, si edhe ruajtjen e integritetit të ngarkesave dhe njësisve të ngarkesave. Këto masa duhet të dokumentohen siç duhet në një plan sigurie që i paraqitet Autoritetit të caktuar për sigurinë e anijeve dhe atë portuale. Plani i sigurisë i miratuar nuk është vetëm një mjet i dobishëm për të vlerësuar kriterin e sigurisë për OEA, por gjithashtu do të merret në konsiderohet nga autoriteti doganor edhe për ato elementë në planin e sigurisë që janë identike apo që korrespondojnë me kushtet OEA si të pajtueshme me këto kushte (Neni 53, pika 2, e VKM nr.651/2017).

Anijeve dhe objekteve portuale që plotësojnë kërkesat e kodit ISPS u lëshohen certifikatat që e provojnë këtë, por duhet theksuar se kontrolli i pajtueshmërisë doganore

për kompanitë e transportit detar me pjesët përkatëse të kodit ISPS që i nënshtrohen vlerësimit të detyrueshëm nga administratat kombëtare detare, në bashkëpunim me Agjencinë Evropiane për Sigurinë Detare të BE (EMSA);
Ky validim i kompanisë së transportit detar duhet të konsiderohet gjithashtu në kontekstin e autorizimit OEA.

d) programet OEA apo programe të ngjashme në vendet e treta

Në disa vende ka një program sigurie dhe mbrojtjeje në përputhje me konceptin OEA të Kornizës ECO SAFE. Edhe në rast se nuk ka njohje reciproke midis BE-së dhe një vendi specifik, fakti që një operator ekonomik validohet/certifikohet sipas këtij programi është e rëndësishme që në kontekstin e autorizimit OEA të mbahet në konsideratë nga autoriteti kompetent doganor në procesin e shqyrtimit për dhënien e statusit OEA.

e) TIR (Transports Internationaux Routiers) Transporti ndërkombëtar rrugor

Në kuadrin e UNECE, në vitin 1975 u hartua Konventa Doganore për Transportin Ndërkombëtar të Mallrave në kuadrin e TIR Carnets në vitin 1975 (Konventa TIR e vitit 1975).

Konventa TIR administrohet nga UNECE që gjithashtu administron Manualin TIR. Manuali përmban jo vetëm tekstin e Konventës, por edhe të gjithë informacionin në lidhje me zbatimin e saj në praktikë.

Me interes të veçantë në kuadrin e autorizimit për OEA është aksesin e kontrolluar për procedurat TIR që përbën një nga shtyllat e Konventës TIR. Sipas nenit 6 të Konventës TIR, aksesin në procedurat TIR do të sigurohet nga autoritetet kompetente vetëm për ata operatorë transporti që i plotësojnë kushtet minimale të parashtruara në Aneksin 9, Pjesa 2 e Konventës, dmth:

- eksperiencë e provuar dhe aftësi për të qenë pjesë e transportit ndërkombëtar;
- pozita të shëndosha financiare;
- njohuri të provuara në aplikimin e TIR;
- nuk ka pasur shkelje të rënda apo të përsëritura në lidhje me legjislacionin doganor dhe atë tatimor;
- premtim me anë të një deklaratë me shkrim për tu angazhuar për të qenë në përputhje me legjislacionin doganor dhe për të paguar shumat e detyruara në rast të shkeljeve apo parregullsive.

Me interes të veçantë nga këndvështrimi i një autorizimi OEA mund të jetë edhe miratimi i mjeteve rrugore dhe kontenierëve. Konventa TIR përcakton se mallrat do të transportohen në kontenierë apo mjete rrugore, ku rimorkioja është e ndërtuar në mënyrë të tillë që lejon akses tek pjesa e brendshme kur plumboset. Në rast se kontenieri apo rimorkioja përmbush kërkesat e Konventës, autoritetet përkatëse kombëtare të miratimit ose inspektimit lëshojnë certifikatat e miratimit për mjetet rrugore apo për kontenierët.

f) të tjera

Kontrolli i verifikueshëm i pajtueshmërisë doganore me kërkesat dhe standardet e sigurisë të përcaktuara nga organizatat ndër-qeveritare, si p.sh.: IMO, UNECE, OTIF, UPU mund gjithashtu të përbëjnë kontroll të plotë ose të pjesshëm të pajtueshmërisë doganore me kriteret OEA, deri në masën që kërkesat janë identike apo të krahasueshme.

3.III.4.3 Standarde tregtare dhe certifikata

a) Certifikatat sipas ISO 27001

ISO 27001 është një standard mbarëbotëror nga ISO që ka të bëjë me sigurinë e teknologjisë së informacionit dhe me mbrojtjen e sistemeve të informacionit elektronik. Ky standard përfshin rregullore mbi teknologjinë e informacionit, teknologjinë e sigurisë dhe sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ai specifikon kërkesat për prodhimin, futjen, monitorimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë bazuar mbi informacion të dokumentuar. Një certifikatë ISO 27001 aplikohet për sektorë të ndryshëm, dmth., sipas kërkesave dhe objektivave të sigurisë së informacionit, menaxhimit efikas të kostos të risqeve të sigurisë, garantimit të kontrollit të pajtueshmërisë doganore me ligjin dhe rregulloret.

b) ISO 9001:2015 (nëse kombinohen me ISO 14001:2009)

Standardi ISO 9001 i krijuar nga ISO përfshin propozime thelbësore për përmirësimin e menaxhimit të cilësisë në ndërmarrje. Qëllimi i këtij standardi është të rrisë efikasitetin e kompanisë dhe të përmirësojë sigurinë e cilësisë. Kërkesat e klientit duhet të plotësohen me një proces cilësor. Në fund të fundit, qëllimi është rritja e kënaqësisë së klientit.

Për procedurën e aplikimit për OEA mund të jetë e dobishme një certifikatë ISO 9001:2015 për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

c) ISO 28000:2007

Sipas ISO 28000:2007, kompanitë mund të certifikohen që kanë një sistem të përshtatshëm për menaxhimin e sigurisë të zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit.

ISO 28000:2007 është një standard kuadër dhe kërkesat për siguri në këtë standard janë shumë të përgjithshme.

Megjithatë, një tjetër standard ISO në serinë ISO 28000, ISO 28001:2007, përfshin kërkesa dhe objektiva shumë më specifike që duhet të përputhen me kriteret ECO SAFE's AEO.

d) Certifikatat TAPA (Shoqata për mbrojtjen e aseteve të transportuara)

TAPA është një bashkim i personave që janë përgjegjës për sigurinë dhe logjistikën në fushën e prodhimit dhe logjistikës. Objektivi i kësaj shoqate ndërkombëtare është mbrojtja në veçanti e mallrave me çmime të larta nga vjedhjet dhe humbja gjatë magazinimit, apo transportit. Certifikatat TAPA lëshohen mbi bazën e standardeve të sigurisë së ngarkesës të përpiluara nga organizata TAPA. Kontrollat që lidhen me pajtueshmërinë doganore me standardet bëhen nga një organ asnjë certifikimi (TAPA, certifikatat A ose B) apo në një vetë-vlerësim nga kompania (certifikata C, TAPA). Standardet e sigurisë së ngarkesave TAPA përfshijnë udhëzime për sigurinë e ndërtesave, pajisjeve dhe proceseve gjatë magazinimit dhe transportit të mallrave.

Një certifikim i suksesshëm (certifikatat A dhe B) sipas kërkesave të standardeve të sigurisë së ngarkesës nga TAPA kërkon një adherencë ndaj standardeve të sigurisë fizike të nivelit të lartë nga ana e mbajtësit të certifikatës.

Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se certifikatat e TAPA-s lëshohen për site (pjesë) individuale dhe jo për të gjithë kompaninë.

3.III.5. Kompanitë mëmë/të kontrolluara, me sisteme dhe procedura të përbashkëta

Pavarësisht nga mënyra sesi është krijuar juridikisht kompania, aplikuesi duhet të përmbushë kriteret përkatëse në parim.

Specifikat e aktiviteteve të deleguara janë shpjeguar në pjesën 2 “Kriteret OEA” të këtij udhëzuesi. Të njëjtat parime janë të zbatueshme nëse aktivitetet kontraktohen brenda një grupi kompanish.

Megjithatë, përsa u takon kompanive mëmë/të kontrolluara ka disa faktorë që duhen mbajtur në konsideratë dhe që mund të influencojnë analizën e riskut dhe procesin e auditit. Si fillim, lidhja duhet të sqarohet, nëse ka ndonjë ndikim në proceset administrative dhe/ose operative.

Ka raste kur kompania e kontrolluar merr pavarësi që ia jep kompania mëmë. Shpesh ka marrëveshje për transferimin e fitimit ose marrëveshje të ngjashme mes filialeve të kompanive. Në disa raste aktivitetet specifike nën-kontraktohen brenda grupit me një kontratë, që mund të çojë në një kompani që nuk ka fare personelin e vet.

Në raste të tjera ka njësi të specializuara që plotësojnë detyrat për të gjitha kompanitë e grupit.

Në të gjitha këto raste, lidhja mund të influencojë në mundësitë që të ndodhë një risk dhe ky impakt mund të jetë si pozitiv, ashtu edhe negativ.

Mund të ketë rëndësi praktike për shqyrtimin e një aplikimi OEA që në rastin e proceseve të përbashkëta të kompanive të lidhura të mjaftojë kontrolli i këtyre proceseve vetëm një herë. Kjo vlen gjithashtu edhe nëse një njësi brenda grupit zhvillon aktivitete të veçanta për të gjitha filialet (shërbime të përbashkëta).

Kjo mund të përshpejtojë procesin e auditit dhe dijet specifike mund të rrisin cilësinë e proceseve. Njëkohësisht informacioni në lidhje me kompaninë e një grupi duhet të vlerësohet nën dritën e impaktit që mund të ketë mbi filialet përkatëse. Në rast se sistemi i kontrollit të brendshëm dështon në një nga kompanitë brenda korporatës, sistemi i

kontrollit të brendshëm në kompanitë e lidhura nuk duhet të vlerësohet automatikisht si i dështuar, por autoritetet doganore duhet të mbajnë në konsideratë dhe t'i shqyrtojnë ato sisteme (tërësisht ose pjesërisht).

3.III.6. Risku dhe analiza e riskut

3.III.6.1 Vlerësimi dhe menaxhimi i riskut të një operatori ekonomik

Organizimi i një operatori ekonomik mund të jetë një sistem kompleks që përfshin shumë procese të ndërlidhura. Një OEA duhet të përqendrohet tek proceset, menaxhimi i riskut, kontrollet e brendshme dhe masat për uljen e risqeve. Këtu duhet të përfshihen shqyrtimi i vazhdueshëm i këtyre proceseve, kontrolli dhe masat e marra për të zbutur apo ulur risqet që lidhen me lëvizjen ndërkombëtare të mallrave. Kontrolli i brendshëm është procesi që zbatohet nga një operator ekonomik për të parandaluar, zbuluar dhe trajtuar risqet, për të siguruar përshtatshmërinë e të gjitha proceseve. Një organizatë që nuk zbaton një sistem të brendshëm kontrolli apo kur ka prova që sistemi nuk po funksionon siç duhet, atëherë ky sistem është patjetër i rrezikuar.

Sistemet e menaxhimit të bazuara tek risku janë disiplina sipas të cilave operatorët ekonomikë në çdo industri vlerësojnë, kontrollojnë, monitorojnë dhe trajtojnë risqet. Për një OEA, kjo do të thotë që një operator ekonomik duhet të përcaktojë qartë në politikat/strategjitë e tij objektivat e pajtueshmërisë me rregullat doganore dhe ato të sigurimit të pjesës së tij të zinxhirit të furnizimit, sipas modelit të vet të biznesit. Sistemi i menaxhimit duhet të bëjë të mundur:

- një cikël të vazhdueshëm të identifikimit të nevojave apo kërkesave,
- vlerësimin e mjeteve më të mira për të garantuar përputhshmëri me kërkesat,
- zbatimin e një procesi menaxhimi për zbatimin e veprimeve të përzgjedhura të menaxhimit,
- monitorimin e performancës së sistemit,
- ruajtjen e provave të aplikimit të proceseve të përdorura për plotësimin e objektivave të biznesit dhe evidentimin e mundësive për përmirësime funksionale apo të biznesit, duke përfshirë mekanizmat e raportimit në lidhje me boshllëqe, gabime të rastësishme dhe gabime të mundshme strukturore.

E gjithë kjo duhet të shihet në kuadrin e pajtueshmërisë me kërkesat ligjore dhe rregullatore që zbaton organizata, ose që i kërkohet asaj të përmbushë.

Sa më shumë që një organizatë të jetë në dijeni të proceseve dhe risqeve që lidhen me aktivitetet e saj, aq më shumë është e mundur që proceset të mund të mirë menaxhohen. Kjo do të thotë që një organizatë duhet të jetë e qartë në lidhje me koncepte të tilla si:

menaxhimi i riskut; qeverisja; kontrolli (monitorimi, ri-vlerësimi; procesi i ri-zbatimit dhe/ose procedurat e ri-dizenjimit) dhe të ketë zbatuar procedurat e duhura për të mbuluar risqet më të rëndësishme dhe për të identifikuar risqe të reja.

Brenda organizatës së një operatori ekonomik duhet të ketë një person përgjegjës, ose në varësi të shkallës dhe kompleksitetit të tij, mbase dhe një njësi që përgjigjet për vlerësimin e riskut dhe për ngritjen dhe vlerësimin e kontrollit të brendshëm dhe masave të tjera.

Vlerësimi i riskut duhet të mbulojë të gjitha risqet që lidhen me mbajtjen e statusit OEA, duke treguar kujdes të posaçëm për rolin e operatorit ekonomik në zinxhirin e furnizimit, dhe duhet të përfshijë:

- çdo kanosje të sigurisë për ndërtesat dhe mallrat;
- probleme fiskale;
- besueshmërinë e informacionit që lidhet me operacionet doganore dhe logjistike të mallrave;
- gjurmë të qartë auditimi dhe parandalim dhe zbulim të mashtrimeve dhe gabimeve;
- marrëveshje kontraktuale për partnerët e biznesit në zinxhirin e furnizimit.

Vlerësimi i riskut për qëllime sigurie duhet të mbulojë të gjitha hapësirat/ambjentet që lidhen me aktivitetin doganor të një operatori ekonomik.

3.III.6.2. Analiza e riskut doganor dhe auditimi

Siç tregohet edhe më lart, një operator ekonomik duhet të jetë në gjendje të vlerësojë risqet e veta dhe të marrë masa për t'i mbuluar ato. Roli i doganës është të bëjë auditime për të vlerësuar se me sa efikasitet i trajton një operator ekonomik këto aspekte. A është i informuar aplikuesi mbi risqet më të rëndësishme dhe a është ai duke marrë masat e duhura për t'i trajtuar ato?

Për ta bërë këtë vlerësim dhe për të marrë vendimin e duhur nëse i duhet dhënë këtij operatori statusi OEA, autoritetet doganore duhet të:

- vlerësojnë riskun e operatorit ekonomik;
- hartojnë një plan të mirë auditimi që të reflektojë riskun;
- kryejnë auditimin;
- t'i japin rrugëzgjdhje çdo risku të papranueshëm për një operator ekonomik;
- marrin vendimin e duhur, për t'ia dhënë ose jo statusin OEA;
- monitorojnë dhe nëse është e nevojshme të rivlerësojnë operatorin ekonomik.

Operatori ekonomik duhet të zbatojë procedurat e duhura si dhe të marrë masat e përshtatshme në nivel menaxherial për të trajtuar risqet që lidhen me autorizimin për OEA. Në këtë kontekst, një operator ekonomik duhet të jetë i ndërgjegjshëm që është e

mundur të kontraktojë “aktivitete” por jo “përgjegjësi”. Në këtë kontekst, për konceptin OEA, një operator ekonomik duhet të jetë i ndërgjegjshëm për risqet që lidhen me aktivitetet e deleguara dhe duhet të marrë masa për t’i mbuluar ato dhe ti sigurojë fakte autoritetit doganor në lidhje me këtë.

Vlerësimi i riskut për një operator specifik ekonomik


Për autoritetin doganor, hapi i parë që i duhet të ndërmarrë është të mbledhë sa më shumë informacion të jetë e mundur në lidhje me aktivitetin e biznesit të operatorit ekonomik. Në vijim, autoriteti doganor mund të vazhdojë me vlerësimin e riskut duke përpunuar një plan auditi i cili zbatohet duke përdorur të gjithë informacionin e disponueshëm. Vlerësimi i riskut bëhet për të gjitha fushat përkatëse të riskut të aktivitetit të operatorit brenda zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit, sipas modelit të biznesit të operatorit ekonomik. Kjo do të bëhet për çdo fushë veçmas, duke marrë në konsideratë të gjitha risqet që lidhen me aktivitetin e operatorit ekonomik dhe që janë të përshtatshme për statusin OEA. Në këtë stad, ky është risku i vlerësuar sipas të gjithë informacionit që disponohet përpara auditimit dhe mbi bazën e efikasitetit të parashikuar të sistemit të brendshëm të kontrollit të organizatës së operatorit ekonomik. Ai duhet të drejtojë audituesit në përgatitjen e planit të auditimit.

Harta e riskut dhe modeli AEO COMPACT

Në “Udhëzuesin e Menaxhimit të Riskut” të OBD, risku nga këndvështrimi doganor në përgjithësi përkufizohet si: **“Mundësia për të mos qenë në përputhje me legjislacionin doganor”, por në kontekstin e këtij udhëzuesi del se ka një qasje më të gjerë dhe risku përkufizohet si:**

Mundësia që një veprim apo ngjarje të ketë ndikim negativ në mundësitë e organizatës për të qenë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e OEA-s. Dy elementë duhet të mbahen në konsideratë: gjasat që një ngjarje të ndodhë, por edhe impakti i saj, si edhe për të vlerësuar rëndësinë e riskut në fjalë. Këto dy dimensionë duhet të mbahen gjithmonë në konsideratë. Këto koncepte mund të vizualizohen përmes të ashtuquajturës matrice e riskut që shihni në skicën e mëposhtme

Mundësia



Risku nuk mund të eliminohet asnjëherë plotësisht, me përjashtim të rastit kur procesi dështon/ndërpritet. Në matricë tregohet se një risk që ka pasoja shumë të mëdha do të konsiderohej si i papranueshëm, por një situatë ku gjasat janë të ulta, ndërsa një risk pasojat e të cilit janë mesatarisht negative do të ishte i papranueshëm në një situatë ku gjasat janë të mëdha. Pra, qëllimi është të ulët niveli i riskut (impakti/gjasat) në një nivel të pranueshëm dhe përmes monitorimit të garantohet që ai nuk ndryshon.

Zakonisht kemi këto konsiderata:

- risku në zonën e **kuqe**, konsiderohet i lartë dhe duhen marrë masa për ta luftuar dhe për të ulur nivelin e tij;
- risku në zonën e **verdhë**, kërkon masa korrigjuese për ta çuar riskun në zonën e gjelbër, ose duke zbutur impaktin e tij, ose duke ulur probabilitetin që ky risk të ndodhë;
- kur risku është në zonën e **gjelbër** mund të konsiderohet si i pranueshëm, por që ka vend për përmirësime.

Këto dy dimensionet duhet të përdoren gjithashtu për të bërë prioritizimin e risqeve dhe për të marrë masat për t'i luftuar ato.

Është e qartë që risqet mund të kenë ndikime nga më të ndryshmet në varësi të perspektivës të palës së interesuar. Për shembull, një operator ekonomik dhe autoritetet doganore mund të kenë perspektiva të ndryshme mbi konceptin e sigurisë: objektivi i një operator ekonomik mund të jetë që të sigurohet kargoja nga risqet e vjedhjes, ndërsa doganat mund të përqendrohen tek mbrojtja e qytetarit dhe parandalimi i futjes së mallrave të paligjshme apo të rrezikshme në zinxhirin e furnizimit. Është e rëndësishme që vlerësimi që një operator ekonomik u bën risqeve të veta të mbulojë të gjitha risqet e biznesit të tij që lidhen me statusin OEA, duke pasur parasysh gamën e konceptit OEA dhe rolin e operatorëve ekonomikë në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit, sipas modelit të biznesit.

Si pjesë e procesit, një operator ekonomik jo vetëm që duhet të zbatojë dhe menaxhojë masat e përzgjedhura prej tij, por edhe duhet të sigurohet që këto masa funksionojnë, si edhe t'i rishikojë dhe rivlerësojë ato.

Kjo do të thotë që operatori ekonomik duhet të monitorojë vazhdimisht proceset përkatëse, duke kontrolluar që procedurat e zgjedhura prej tij të jenë të përshtatshme për të garantuar pajtueshmëri me proceset doganore. Operatori ekonomik duhet të dokumentojë punën që ka bërë, me qëllim menaxhimin e veprimeve të përmirësuara, por edhe për tua treguar ato autoriteteve doganore.

Si përmbledhje, operatori ekonomik duhet të ketë procedura dhe masa për të:

- përcaktuar saktë asetet dhe objektivat që rrezikohen (p.sh. për OEA-në është e qartë që ajo që është e rëndësishme është objekti për të vepruar në përputhshmëri me rregullat doganore dhe sigurimi i zinxhirit të furnizimit);
- evidentuar kërcënimet që vënë në rrezik asetet dhe objektivat e përcaktuara;

- monitoruar vazhdimisht faktin nëse asetet kërcënohen nga këto kanosje të evidentuara;
- vlerësuar riskun që lidhet me rolin e tij zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit, sipas modelit të vet të biznesit; mbuluar risqet, duke ndërmarrë veprime dhe duke zbatuar procedurat e duhura; dhe
- monitoruar efikasitetin e procedurave të zbatuara.

Për të pasur një proces të krahasueshëm të vlerësimit të riskut, kjo duhet të bazohet mbi një model të njohur të analizës së riskut. Në këtë kontekst rekomandohet përdorimi i Modelit AEO COMPACT⁴.

3.III.7. Auditimi dhe auditimi i bazuar tek risku

3.III.7.1. Përgatitja e një plani për auditimin (kontrollin e llogarive)

Audituesi (kontrollori i llogarive) ka përgjegjësi që të planifikojë dhe ta kryejë kontrollin për tu siguruar nëse një operator ekonomik vepron në përputhje me kriteret e përcaktuara. Audituesi duhet të përcaktojë një plan kontrolli, sipas risqeve të evidentuara për operatorin ekonomik specifikisht.

Ky **plan auditimi/kontrolli** do të shërbejë si udhëzuesi specifik që do të ndiqet gjatë kryerjes së kontrollit dhe do të specifikojë objektivat, gamën dhe metodat e kontrollit.

Plani i kontrollit duhet të jetë si përgjigje ndaj rezultateve të vlerësimit të riskut dhe të reflektojë informacion në lidhje me:

- risqet në çdo fushë, duke përcaktuar pikat/aspektet e kontrollit;
- Matricën e analizës së riskut;
- departamentet apo njësitë që do tu nënshtrohen kontrollit;
- administratën dhe personelin që do të intervistohen;
- cilat, si dhe kur janë transaksionet/testet e sigurisë që do të kryhen.

Veprimet në kuadrin e kontrollit dhe burimet e akorduara duhet të bazohen tek parimi i mëposhtëm: “sa më i lartë të jetë risku, aq më i madh kontrolli”.

3.III.7.2. Kryerja e aktiviteteve të kontrollit (auditimi)

Auditimi (kontrolli) është një proces sistematik i mbledhjes dhe vlerësimit me objektivitet të provave. Ky proces përfshin edhe komunikimin e rezultateve, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve përkatëse, dhe duke bërë një gjë të tillë, uljen në një nivel të pranueshëm të riskut që lidhet me aktivitetet specifike që kryhen nga operatori,. Një element shumë i rëndësishëm i auditit është vlerësimi i efikasitetit të

⁴ Operator ekonomik i autorizuar, Përputhshmëria dhe Partneriteti me Doganat dhe Tregtinë (TAXUD/2006/1452)

kontrollit të brendshëm dhe vlerësimit të riskut të një operatori ekonomik. Operatori ekonomik duhet të angazohet për vlerësimin, uljen dhe zbutjen e risqeve të evidentuara në biznesin e tij dhe t'i dokumentojë këto veprime. Me rëndësi është të mbahet në konsideratë që për SME-të, niveli i kontrollit të brendshëm duhet të jetë proporcional me nivelin e riskut, në varësi të gamës dhe objektivit të biznesit në fjalë. Megjithatë, edhe në ato raste kur operatorët ekonomikë e kanë bërë vlerësimin e riskut, vlerësimi i tyre jo gjithmonë mund të përkojë me kërcënimet dhe risqet e evidentuara nga autoritetet doganore.

Auditimi (kontrolli) duhet gjithmonë të jetë mbi baza risku dhe të përqendrohet tek fushat që kanë risk të lartë, me qëllim që të plotësojë objektivat e kontrollit në lidhje me operatorin ekonomik në fjalë. Auditimi i bazuar tek risku është një formë kontrolli që merr në analizë risqet e auditit, përcakton pragje të pranueshme mbi bazën e analizës së riskut dhe harton programe kontrolli që akordojnë një pjesë më të madhe të burimeve të auditit në zona ku risku është më i lartë. Kjo është e rëndësishme sepse një auditues mund të mos jetë në gjendje të kryejë procedura të detajuara auditimi në të gjitha fushat e kontrollit (p.sh. në rast se ka shumë objekte/ndërtesa). Kontrolli duhet të përqendrohet kryesisht tek identifikimi dhe vlerësimi i risqeve më të larta dhe tek kontrolli i brendshëm për të marrë masa dhe për të ulur ndikimin e risqeve të evidentuara në një nivel të pranueshëm, përpara dhënies së statusit OEA. Auditimi i bazuar tek risku karakterizohet kryesisht si audit sistemesh.

3.III.7.3. Menaxhimi i riskut jo-sistematik (risk i mbetur)

Auditimi i bazuar tek risku siguron treguesit e risqeve, si bazë mundësish për përmirësimin e menaxhimit të riskut të audituar dhe të proceseve të kontrollit. Kjo i jep mundësi operatorit ekonomik të përmirësojë veprimtarinë e veta nga rekomandimet për risqet që nuk kanë impakt në moment, si për pajtueshmërinë doganore ashtu edhe me sigurinë dhe mbrojtjen, por që mund të vënë në rrezik strategjitë operacionale dhe performancën e operatorit ekonomik në një periudhë afatgjatë. Një analizë e mirë risku shërben si bazë për të garantuar kontrollin e performancës.

Audituesit duhet të mbajnë në konsideratë që plani i kontrollit nuk është një dokument i ngurtë (është një dokument i gjallë), që dmth mund të ndryshojë sipas informacionit që audituesit marrin gjatë kontrollit. Një risk potencial që mund të jetë konsideruar si i ulët gjatë fazës së vlerësimit mund të rivlerësohet si i lartë, në momentin që procesi shikohet nga afër dhe procedurat gjykohen jo vetëm në letër, por edhe se si janë zbatuar.

Audituesit duhet të vlerësojnë gjithmonë çdo informacion shtesë në lidhje me fushat që konsiderohen si “të gjelbra” dhe të jenë të gatshëm të kontrollojnë procedurat përkatëse, në rast se risku i vlerësuar nuk është ai që tregojnë faktet.

Auditimi i bazuar tek risku përbëhet nga katër faza kryesore, duke filluar me identifikimin dhe priorizimin e risqeve, deri tek përcaktimi i riskut jo-sistematik, ulja e këtij risku në nivele të pranueshme dhe raportimi i rezultateve të kontrollit të një operatori ekonomik. Të gjitha këto arrihen përmes:

- përcaktimit të operacioneve të ndryshme të një operatori ekonomik, për të evidentuar dhe prioritzuar risqet, duke përfshirë ekzaminimin e planit të sigurisë, nëse ka një të tillë dhe vlerësimin e kanosjeve, si edhe evidentimin e masave dhe kontrolleve të brendshme;
- konfirmimit të strategjive të menaxhimit të një operatori ekonomik dhe procedurave dhe vlerësimit të kontrolleve, për përcaktimin e riskut jo-sistematik. Kur është e përshtatshme, këto kontrolle duhen testuar;
- menaxhimit të çdo risku jo-sistematik për ta çuar atë në nivele të pranueshme (masat e mëtejshme duhet të bien dakord me operatorin ekonomik, me qëllim uljen e ndikimit dhe/ose gjasave të një risku specifik dhe kalimi i të gjithë risqeve në “zonën e gjelbër”);
- informimit të operatorit ekonomik mbi rezultatet e kontrollit. Është e rëndësishme që audituesit t’u parashtrojnë aplikuesve risqet e evidentuara, duke përfshirë edhe rekomandimet për kapërcimin e tyre;
- monitorimit, dhe nëse është e nevojshme, ri-vlerësimit të kriterëve dhe kërkesave.

3.III.7.4. Raporti final dhe dokumentacioni i kontrollit (auditit)

Verifikimi dhe kontrollet që bëhen gjatë auditit dhe konkluzionet e audituesve duhet të dokumentohen me saktësi. Duhet të dokumentohet puna e bërë dhe jo thjeshtë të mblidhen prova dhe informacion. Kjo është e rëndësishme si për autoritetet doganore gjatë gjithë procesit të autorizimit, duke përfshirë menaxhimin e autorizimit ashtu edhe për operatorin ekonomik.

Raporti përfundimtar dhe dokumentacioni i kontrollit duhet të përmbajnë këtë informacion, në mënyrë të qartë dhe sistematike:

- panoramë të saktë të përgjithshme të një operatori ekonomik (bizneset e tij, rolin që ka në zinxhirin e furnizimit, modelin e biznesit, aktivitetin doganor etj.);
- pasqyrim të qartë dhe të saktë të punës që është bërë për plotësimin e kriterëve për OEA;
- përshkrim i qartë i të gjitha fushave të riskut që janë kontrolluar dhe veprimet pasuese të sugjeruara për aplikuesin;
- raport i qartë i veprimeve apo reagimeve që ka ndërmarrë aplikuesi apo për të cilat janë shprehur audituesit;
- rekomandim të qartë për të dhënë ose jo statusin, në varësi të rezultatit të auditit;
- në rast se nuk jepet statusi OEA, një argumentim të plotë dhe të detajuar përse nuk është dhënë statusi, duke përfshirë dhe çdo informacion të marrë, ku të përcaktohet nëse ato janë marrë përmes procedurës së “informacionit” dhe/apo “konsultimit”;
- një panoramë e përgjithshme e profilit të riskut të OEA dhe në rast se jepet statusi OEA, çdo rekomandim për monitorim dhe/ose rivlerësim.

Rrjedhimisht, raporti përfundimtar dhe dokumentacioni i kontrollit janë dokumente shumë të rëndësishme që pasqyrojnë të gjithë punën e bërë (analizën e riskut, planifikimin e kontrollit, kontrolle dhe vizita në objektet e aplikuesit, informacionin e marrë nga shtetet e tjera kur është rasti, profilin e riskut të një operatori ekonomik specifik, etj.) si përmbledhje, me tregues të qartë për veprimet në të ardhmen. |

Përpara shkrimit të raportit përfundimtar dhe dokumentacionit të kontrollit, në rast se ka paqartësi audituesi duhet t'i konfirmojë ato edhe një herë me operatorin ekonomik.

Seksioni IV – Vendim-marrja për dhënien e statusit

3.IV.1. Disa nga faktorët që duhet të mbahen në konsideratë përpara dhënies së statusit

Vendimi i autoriteteve doganore në lidhje me dhënien ose jo të statusit OEA bazohet mbi informacionin e mbledhur dhe të analizuar përmes fazave të ndryshme të procesit të autorizimit, që nga marrja e aplikimit deri tek përfundimi i plotë i procesit të auditimit.

Në mënyrë që autoritetet doganore të marrin një vendim duhet të merren në konsideratë këta faktorë:

- i gjithë informacioni paraprak që njihet në lidhje me aplikuesin nga autoriteti doganor, duke përfshirë edhe aplikimin për OEA bashkë me pyetëtorin e vetë-vlerësimit të plotësuar dhe gjithë informacioni tjetër mbështetës. Ky informacion mund të ketë nevojë për tu riparë, për tu përditësuar, me qëllim që të merren në konsideratë ndryshimet e mundshme, që mund të kenë ndodhur në periudhën nga data e marrjes dhe pranimit të aplikimit, deri në fund të procesit të autorizimit dhe marrjes së vendimit përfundimtar.
- të gjitha konkluzionet përkatëse në të cilat kanë dalë audituesit gjatë procesit të auditimit. Autoritetet doganore duhet të përpilojnë dhe zbatojnë metodat më efikase të komunikimit të brendshëm të rezultateve të auditit që kanë dalë nga ekipet e auditit për autoritete të tjera kompetente doganore të përfshira në vendim-marrje. Një dokumentacion i plotë i kontrolleve të bëra dhe raporti i auditit apo dokumente/mënyra të tjera rekomandohen si mekanizmi më i përshtatshëm;
- rezultatet e çdo vlerësimi të organizatës dhe procedurave të aplikuesit për arsye të tjera kontrolli.

Në fund të procesit, dhe përpara vendim-marrjes finale, D.P.D do të informojë aplikuesin, sidomos në rastet kur këto kushte ka gjasa të sjellin një vendim negativ. Në atë rast, aplikuesit do t'i jepet mundësia të shprehet, të përgjigjet ndaj vendimit dhe të japë informacion suplementar, me qëllim sigurimin e një vendimi pozitiv (Neni 27 (6) i Kodit Doganor).

Për të shmangur faktin që e drejta për tu dëgjuar mund të shkaktojë vonesa, përcaktohet një afat kohor prej 30 ditësh. Aplikuesi duhet të vihet në dijeni që mosreagimi brenda

kësaj periudhe do të konsiderohet si heqje dorë nga e drejta për tu dëgjuar. Në rrethana ku një person shprehet se do të heqë dorë nga e drejta për tu dëgjuar, ky fakt duhet të regjistrohet dhe të mbahet si provë, për të treguar që aplikuesit i është dhënë e drejta për tu dëgjuar.

Aplikuesi do të informohet nëse autoritetet doganore vendosin ose jo të ndryshojnë vendimin fillestar, mbi bazën e informacionit shtesë që iu është siguruar.

3.IV.2. Marrja e vendimit

Për marrjen e vendimit duhet të merren në konsideratë këta faktorë:

- Marrjen e vendimit nga strukturat e interesuara, ne masen e kompetencave që ato kanë, lidhur me vlerësimin për përmbushjen e kriterëve për dhenien e statusit OEA, mendim i cili ndikon në marrjen e vendimit nga DPD”
- kur vendimi është marrë, raporti përfundimtar i strukturës/grupit të auditit kompetent duhet të luajë një rol vendimtar për pajtueshmërinë ose jo me kriteret specifike të OEA, siç përshkruhet më lart;
- Administrata Doganore ka në dispozicion 120 ditë kalendarike për të marrë një vendim (neni 27, pika 3 e Kodit Doganor). Ky afat kohor *mund të shtyhet në këto raste*:
 - Nga D.P.D me 60 ditë të tjera kalendarike, nëse nuk është në gjendje të përmbushë afatin kohor prej 120 ditëve kalendarike për marrjen e vendimit. Aplikuesi duhet të informohet për këtë shtyrje, me të mbaruar afati prej 120 ditësh kalendarike (neni 46, pika 1, e VKM nr.651/2017
 - Me kërkesë të aplikuesit dhe sipas një marrëveshjeje me autoritetin doganor në fjalë. Gjatë kësaj shtyrjeje, aplikuesi bën ndryshime për të plotësuar kriteret dhe ia komunikon ato autoriteteve doganore. Periudha e zgjatjes/shtyrjes duhet të jetë e arsyeshme, duke pasur parasysh llojin e ndryshimeve/masave që do të bëhen (neni 27, pika 3, nën-paragrafi 3, i Kodit Doganor);
 - Nga D.P.D në rast të kërkesës së informacionit të nevojshëm shtesë nga ana e aplikuesit. Aplikuesit do ta përcjellin informacionin maksimumi brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës. Aplikuesi do të informohet mbi shtyrjen e afatit për vendim-marrjen.
 - Nga D.P.D me 30 ditë, në rast se aplikuesit i është dhënë e drejta për tu dëgjuar. Aplikuesi do të informohet për shtyrjen;
 - Nga D.P.D, në rastet kur D.P.D e ka zgjatur afatin për konsultim me autoritete të tjera doganore. Afati për vendim-marrje do të zgjatet me të njëjtën periudhë sa periudha e konsultimit. Aplikuesit do të informohet për shtyrjen e afatit të vendim-marrjes;
 - Nga D.P.D, në rast se autoritetet doganore po hetojnë për shkak të dyshimeve serioze për shkelje të legjislacionit doganor. Kjo shtyrje nuk duhet të kalojë nëntë muaj. Aplikuesi duhet të informohet mbi shtyrjen, me përjashtim kur kjo do të vinte në rrezik procesin;

- Nga D.P.D, gjatë procesit të hetimeve penale që ngrenë dyshime nëse aplikuesi, apo personat e listuar në aplikim plotësojnë kushtet për përputhshmëri me legjislacionin doganor dhe rregullat tatimore dhe nuk ka asnjë vepër të rëndë penale në lidhje me aktivitetin ekonomik. Shtyrja e afatit për vendim-marrje do të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme për të plotësuar këto procedura.

3.IV.3. Informimi i aplikuesit

Aplikuesi do të informohet me shkrim në këto rrethana:

- për pranimin e aplikimit (neni 27, pika 2, e Kodit Doganor);
- për shtyrjen e periudhës për marrjen e vendimit, sipas nenit 46, të VKM nr.651/2017;
- për periudhën e shtyrë për vendim-marrje për shkak të hetimeve nga autoritetet doganore, me përjashtim të rastit kur kjo gjë vë në rrezik hetimin (neni 21, pika 4, fjalia e fundit, e VKM nr.651/2017);
- periudhën e shtyrë për vendim-marrje për konsultim (neni 21, pika 3, e VKM nr.651/2017);
- afatin e shtyrë për vendim-marrje për shkak të kërkesës për informacion shtesë (neni 21, pika 1, e VKM nr.651/2017);
- periudha e shtyrë për shkak të së drejtës së aplikuesit për tu dëgjuar (neni 21, pika 2, e VKM nr.651/2017);
- edhe në ato raste kur nuk kërkohet shprehimisht nga legjislacioni do të ishte me vend që të informohej aplikuesi edhe në rastet kur aplikuesi kërkon një shtyrje për të bërë ndryshime/rregullime, që garantojnë plotësimin e kushteve dhe kriterëve (neni 27, pika 3, nën-paragrafi 3, i Kodit Doganor);
- edhe në ato raste kur nuk kërkohet shprehimisht nga legjislacioni do të ishte me vend që të informohej aplikuesi për periudhën e shtyrë për vendim-marrje, në rast se ka një proces hetimi penal (neni 46, pika 2, e VKM nr.651/2017).

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave gjithashtu do të informojë aplikuesin në lidhje me vendimin final për aplikimin që ka bërë. Në këtë kontekst vlen të theksohet se çdo vendim për mospranimin e një aplikimi duhet të shoqërohet me arsyetimin për mospranimin e tij dhe me të drejtën për ta ankimuar vendimin, sipas përcaktimit të nenit 45, të Kodit Doganor. Përpara miratimit të vendimit për mospranimin e një aplikimi, operatorit ekonomik duhet t'i jepet e drejta për tu shprehur (neni 27, pika 6, e Kodit Doganor).

Autoritetet doganore do ta informojnë operatorin ekonomik, me shkrim, përmes mjeteve të tilla (si me sistem IT, me email, ose me anë të një shkrese zyrtare).

3.IV.4. E drejta e ankimit

Neni 45, pika 1, paragrafi i parë i Kodit Doganor parashikon që *"Çdo person ka të drejtë të ankimojë vendimet e marra nga autoritetet doganore për refuzimin e një aplikimi apo vendimin për anulimin ose revokimin e një vendimi të favorshëm, i cili ka të bëjë me të drejtpërdrejt dhe individualisht"*. Personi që ushtron ankim ndaj një vendimi të autoritetit doganor duhet ta paraqesë ankimin në formën dhe sipas rregullave të caktuara ligjore. Në këtë rast, personi i interesuar mund të ankohet, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave vendos brenda 30 ditëve për pranimin ose jo të ankimit.

Neni 45, pika 1, paragrafi i dytë i Kodit Doganor parashikon që *"Çdo person mund të ushtrojë të drejtën e ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në rastet kur ka aplikuar pranë autoriteteve doganore për një vendim të favorshëm dhe nuk është respektuar afati i përcaktuar në pikën 3, të nenit 27."*

Në këtë rast, personi i interesuar mund të ankohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, brenda 15 ditëve nga data e mbarimit të këtij afati. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave vendos brenda 30 ditëve për pranimin ose jo të ankimit.

E drejta e ankimit mund të ushtrohet:

- a) duke paraqitur ankim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;
- b) pas përfundimit të procedurave të shqyrtimit të ankimit administrativ, duke iu drejtuar me padi gjykatës kompetente, sipas dispozitave në fuqi.

Në rast se anulimi apo revokimi i një vendimi të favorshëm shoqërohet edhe me sanksione, procedura e ankimit kryhet në përputhje me nenet 281 dhe 282 të Kodit Doganor.

PJESA 4, Shkëmbimi i informacionit me autoritete/institucione të tjera shtetërore

Seksioni 1 – Shkëmbimi i informacionit midis autoriteteve/institucioneve

Në kontekstin e procedurës për OEA, shkëmbimi i informacionit midis institucioneve është një faktor i rëndësishëm kur vjen fjala për garantimin e pajtueshmërisë së një operatori ekonomik me kriteret OEA. Kjo merr rëndësi të posaçme sepse në momentin që jepet autorizimi ai është i vlefshëm për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe vlerësimi i kriterëve për OEA duhet të bëhet përkundrejt të gjithë spektrit të aktivitetit doganor. Kjo mund të arrihet vetëm përmes informacionit efikas dhe procedurave të konsultimit midis institucioneve.

Legjislacioni i jep një rol drejtues administratës doganore e cila përgjigjet për pranimin e aplikimit dhe dhënien e autorizimit OEA. Ka dy procedura të ndryshme (elektronike nëpërmjet e-albania/zyrtare) për shkëmbimin e informacionit midis institucioneve për marrjen e gjithë informacionit të duhur për marrjen e vendimit përkatës.

4.I.1. Procedura e informacionit

Është e rëndësishme që autoriteti doganor të bëjë kontrollet e duhura për të konstatuar nëse ka ndonjë informacion me vlerë për aplikuesin. Çdo informacion i nevojshëm rreth aplikuesit, në lidhje me përputhshmërinë me kriteret OEA do t'i komunikohet autoritetit doganor, që të ketë mundësi që të marrë vendimin e duhur mbi bazën e të gjitha fakteve të disponueshme.

Informacioni i lartpërmendur zakonisht dërgohet përpara se të jepet autorizimi; pavarësisht se procedura është e disponueshme për shkëmbimin e informacionit në çdo kohë, pasi të jetë lëshuar autorizimi. Në rast se një institucion ka informacion të ri, ai duhet t'a dërgojë atë sa më shpejt të jetë e mundur tek Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke qenë se mund të ndikojë në kushtet që duhet të plotësohen nga OEA. Kjo është e mundur në kuadrin e nenit 60 të VKM nr.651/2017, që parashikon se autoritetet doganore (si D.P.D ashtu edhe autoritetet e tjera) duhet të monitorojnë përputhshmërinë me kushtet dhe kriteret. Në rast se informacioni del se ka rëndësi, kjo mund të bëjë që D.P.D ta nisë edhe një herë procesin e vlerësimit, sipas nenit 23, pika 1, të VKM nr.651/2017. Administrata doganore do të marrë në konsideratë informacionin e marrë ose gjatë fazës së autorizimit, ose gjatë fazës së monitorimit të autorizimit.

4.I.2. Procedura e konsultimit

Sipas nenit 56, pika 1, të VKM nr.651/2017, nëse vlerësohet e nevojshme, autoritetet doganore mund të konsultohen me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, sa i takon verifikimit të plotësimin të kriterëve të përcaktuara në nenin 41, të Kodit.

Konsultimet kryhen në qoftë se shqyrtimi i një ose më shumë kriterëve të përcaktuara në nenet 49 deri 54 nuk mund të bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për shkak të mungesës së informacionit apo për pamundësinë e kontrollit të tij. Në këto raste,

konsultimet do të bëhen brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, duke filluar nga data e komunikimit të informacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në mënyrë që të lejojnë lëshimin e “Certifikatës OEA” ose refuzimin e aplikimit, brenda afateve të përcaktuara.

Kur, pas shqyrtimit të kriterëve, sipas përcaktimit në nenin 54, institucioni i konsultuar vendos që aplikuesi nuk përmbush një ose më shumë kriterë, rezultatet e konsultimeve, të dokumentuara në mënyrë të rregullt, do të dërgohen te Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila refuzon aplikimin (neni 56, pika 2, e VKM nr.651/2017).

Refuzimi i aplikimit për OEA nuk cenon vendimet e favorshme të marra në lidhje me aplikuesin, në përputhje me legjislacionin doganor ekzistues, përveç rasteve kur dhënia e këtyre vendimeve të favorshme është e bazuar në përmbushjen e ndonjë prej kriterëve OEA, që provohen se nuk janë përmbushur gjatë shqyrtimit të aplikimit OEA (neni 57, i VKM nr.651/2017).

Ashtu si në rastin e procedurës së informacionit, edhe procedura për konsultimet zakonisht inicohet nga autoriteti doganor, në fillim të procesit, me qëllim që të merret informacion përpara se sa të lëshohet autorizimi. Megjithatë, kjo procedurë mund të inicohet në çdo kohë që D.P.D e konsideron si të nevojshme për të vlerësuar nëse një OEA vazhdon të jetë në përputhje me procedurat apo jo.

Procedura e konsultimit do të përdoret gjithashtu edhe gjatë monitorimit, sipas përcaktimit në nenin 31, pika 4, të VKM nr.651/2017.

Në veçanti, kur D.P.D vendos të bëjë rivlerësim, ajo duhet të vendosë nëse konsultimet me një (ose disa) institucione janë të nevojshme apo jo. Në rast se kjo del e nevojshme, atëherë D.P.D fillon konsultimet dhe pret rezultatet; përndryshe vazhdon me rivlerësimin vetë dhe më pas të gjitha rezultatet (pezullim, revokim, autorizimi OEA ende i vlefshëm) do t’u vihen në dijeni të gjitha shteteve anëtare, kur rezultatet të hyjnë në Sistemin e Operatorëve Ekonomik (EOS).

Këto konsultime janë të detyrueshme dhe autoriteti i konsultuar doganor do t’i kthejë përgjigje D.P.D-s, edhe në rast se rezultati është i favorshëm dhe aplikuesi rezulton të ketë plotësuar të gjitha kriteret për të cilat është kontrolluar. Kjo garanton që D.P.D të ketë informacionin e duhur në mbështetje të vendimit përfundimtar.

Përgjigja e institucioneve të konsultuara duhet të mbahet siç duhet në konsideratë nga administrata doganore, që ka një panoramë të përgjithshme të aplikuesit dhe është autoriteti kompetent për vendim-marrje në lidhje me plotësimin e kriterëve për të gjithë biznesin e një operatori ekonomik.

Mund të ketë edhe raste kur institucioni i konsultuar i konsideron kriteret si të papërmbushura, por D.P.D i konsideron si të mjaftueshme sqarimet e aplikuesit. Në këtë rast, institucioni në fjalë duhet të konsultohet edhe një herë.

4.I.3. Mjetet e komunikimit

I gjithë informacioni që lidhet si me "procedurën e informacionit", ashtu edhe më atë "të konsultimit" duhet të mbahet në konsideratë nëse informacioni për të cilin bëhet fjalë është sensitiv apo jo. Në këto raste, institucionet mund të përdorin të gjithë kanalet e disponueshme të komunikimit, duke përfshirë edhe kontaktet e rrjetit OEA.

Vlen gjithashtu të theksohet se D.P.D duhet të hartojë një akt të argumentuar administrativ për operatorin ekonomik në rast të një vendimmarrjeje negative.

Rrjedhimisht, në rast se autoriteti i konsultuar përcakton se aplikuesi nuk përmbush një apo më shumë kushte apo kritere për vendimmarrje pozitive, kjo duhet të dokumentohet dhe transmetohet në kohë pranë D.P.D.

Seksioni II – Parashikime të tjera për shkëmbimin e informacionit

Në kuadrin e procesit të autorizimit për OEA, një ndër elementët më të rëndësishëm është konsultimi dhe kur është e përshtatshme shkëmbimi i informacionit midis doganave dhe autoriteteve të tjera. Në varësi të rastit specifik dhe legjislacionit që rregullon nivelin dhe formën e konsultimit, shkëmbimi i informacionit me autoritete të tjera mund të jetë i ndryshëm.

Rasti i parë është kushti i përgjithshëm i specifikuar që, statusi OEA shpallet nga autoritetet doganore, pas konsultimeve me autoritetet kompetente. Nevoja për këto konsultime varet nga një sërë aspektesh, si p.sh. lloji i aktivitetit ekonomik të aplikuesit dhe mallrat e përfshira; mundësia e kontrolleve nga autoritetet doganore bazuar mbi informacionin që ato disponojnë për të përcaktuar nëse aplikuesi i përmbush detyrimet e tij, sipas legjislacionit përkatës (p.sh. masat për politikën tregtare, ndalime dhe kufizime specifike).

Rasti i dytë kur shkëmbimi i informacionit me autoritetet kompetente konsiderohet i nevojshëm është kur legjislacioni doganor në tërësinë e tij përcakton njohjen e statusit OEA. Në këto raste është legjislacioni specifik doganor që përcakton cilat janë autoritetet kompetente dhe rastet kur shkëmbimi i informacionit me to është i detyrueshëm për të garantuar zbatimin e duhur të njohjes reciproke.

Rasti i tretë mund të jetë: shkëmbimi i të dhënave bazohet në nivel kombëtar për të rritur cilësinë e autorizimeve OEA që nuk janë dhënë ende dhe autorizimeve/certifikatave të lëshuara nga autoritete të tjera kompetente shtetërore dhe/ose shmangia e kontrolleve të panevojshme të dyfishta për një operator ekonomik.

(a) Informacioni që do të shkëmbehet nga autoritetet doganore tek autoriteti përkatës kombëtar që përgjigjet për sigurinë e aviacionit civil

Autoritetet kombëtare doganore, në marrëveshje me autoritetin e duhur kombëtar që përgjigjet për sigurinë e aviacionit civil do të përcaktojnë modalitete të detajuara për shkëmbimin e informacionit, që nuk mbulohet nga sistemi elektronik i referuar në nenin 55, të VKM Nr.651/2017.

Në rastet kur është e zbatueshme, në veçanti kur statusi OEA është bazë për miratimin e autorizimeve apo lehtësirave sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 55, pika 2, të VKM Nr.651/2017, dhe kur është e zbatueshme, autoritetet doganore kompetente mund t'i japin autoritetit përkatës kombëtar përgjegjës për sigurinë e aviacionit civil, informacionin e mëposhtëm:

- a) autorizimet OEAS, duke përfshirë emrin e mbajtësit të autorizimit dhe kur është e zbatueshme, ndryshimin e tyre ose revokimin ose pezullimin e statusit të operatorit ekonomik të autorizuar dhe arsyet për to;
- b) çdo rivlerësim të autorizimeve OEAS dhe rezultatet e tyre.

Autoritetet kombëtare përgjegjëse për sigurinë e aviacionit civil do ta përdorin informacionin në fjalë vetëm për qëllime sigurie dhe do të zbatojnë masat e duhura teknike dhe organizative për mbrojtjen e këtij informacioni.

(b) Informacioni që do të shkëmbehet nga autoriteti kombëtar përgjegjës për sigurinë e aviacionit civil tek autoritetet doganore

Shkëmbimi i informacionit është i nevojshëm edhe nga autoriteti kombëtar përgjegjës për sigurinë e aviacionit civil tek autoritetet doganore, për të garantuar që statusi i agjentit të rregulluar apo dërguesit të njohur dhe çdo ndryshim përkatës të merret në konsideratë gjatë procesit të dhënies dhe menaxhimit të Statusit OEA.

Pikat 6.3.1.8 dhe 6.4.1.7 të Aneksit të Rregullores Zbatuese të Komisionit (EU) 2015/1998 parashikojnë që autoriteti përkatës tu vëre në dispozicion autoriteteve doganore çdo informacion që lidhet me statusin e agjentit të rregulluar apo dërguesit të njohur që mund të ketë rëndësi për autorizimin OEAS.

Modalitetet për shkëmbimin e këtij informacioni do të përcaktohen dhe për to do të bihet dakord me autoritetet doganore dhe autoritetin përkatës kombëtar për aviacionin.

(c) Fusha të tjera të shkëmbimit të informacionit

Autoritetet doganore mund të mbajnë në konsideratë rezultatet e vlerësimeve dhe kontrolleve të kryera sipas legjislacionit doganor, deri në masën që ato janë të përshtatshme për shqyrtimin e kritereve.

Si shembull i shkëmbimit të të dhënave në përfitim të autoritetit doganor, të autoriteteve të tjera shtetërore dhe të operatorit ekonomik janë programet përkatëse për mallrat me përdorim të dyfishtë dhe që ka një objektiv të krahasueshëm me programin OEA.

Autoritetet kombëtare që japin licencë për mallrat me përdorim të dyfishtë dhe autoritetet doganore inkurajohen të shkëmbejnë informacion për kompanitë e autorizuara OEA dhe për mbajtësit e autorizimeve globale të eksportit, në rast se kjo parashikohet në legjislacion.

PJESA 5, Menaxhimi i autorizimit

Seksioni I - Monitorimi

5.I.1. Të përgjithshme

Monitorimi nga një operator ekonomik dhe detyrimi për të informuar në lidhje me çdo ndryshim.

Monitorimi i vazhdueshëm është një ndër përgjegjësitë kryesore të një operatori ekonomik. Ai duhet të jetë pjesë e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Operatori ekonomik duhet të jetë në gjendje të demonstrojë se si kryhet monitorimi dhe rezultatet e tij. Operatori ekonomik duhet të shqyrtojë proceset, risqet dhe sistemet për të reflektuar çdo ndryshim të rëndësishëm për operacionet e tij. Autoritetet doganore duhet të jenë të informuara për këto ndryshime.

Autoritetet doganore mbikëqyrin kushtet dhe kriteret që duhen përmbushur nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi i favorshëm. Ato gjithashtu mbikëqyrin përputhshmërinë me detyrimet që rrjedhin prej vendimit. Kur personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, është regjistruar (themeluar aktiviteti) prej një periudhe për më pak se 3 vjet, autoritetet doganore duhet ta mbikëqyrin nga afër atë gjatë gjithë vitit të parë pas marrjes së vendimit.

Ka një detyrim ligjor sipas që mbajtësi i autorizimit OEA duhet të informojë autoritetet doganore, pa vonesë, për çdo faktor që lind pas vendimmarrjes, i cili mund të influencojë vazhdimësinë apo përmbajtjen e tij.

OEA duhet të informojë Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në lidhje me çdo ndryshim që lidhet me çdo miratim, autorizim apo certifikim që jepet nga autoritete të tjera shtetërore që mund të kenë ndikim në autorizimin OEA.

OEA duhet të sigurohet që ka dokumentacionin origjinal, duke përfshirë konstatime dhe raporte nga ri-validime, sipas kërkesës së autoriteteve doganore.

Për tu siguruar që OEA është i qartë për këtë detyrim, autoriteti kompetent doganor mund:

- të japë shembuj të informacionit që duhet t'i komunikohet autoritetit doganor në vendimin me shkrim, apo në shkresën që i dërgohet OEA pas dhënies së autorizimit OEA;
- t'i caktojë OEA-s një person kontakti brenda administratës doganore që përgjigjet për komunikimin e të gjithë informacionit që ka të bëjë me autorizimin;
- t'i dërgojë një e-mail (në e-mail ku Doganat i japin logon AEO një operatori ekonomik) personit të kontaktit OEA në kompani ku të theksohet detyrimi dhe të jepet mundësia për të komunikuar ndryshimet përkatëse;
- kur kryhet ndryshim personeli nga ana e administratës doganore, dërgohet një email “njoftimi” personit të kontaktit OEA në kompani ku të theksohet se ky informacion duhet t'i komunikohet personit të ri të caktuar nga administrata doganore;
- të dërgohet vazhdimisht (çdo vit) një pyetësor i shkurtër “kujtesë” (duke përdorur disa pyetje nga Pyetësori i Vetëvlerësimit) tek personi i kontaktit OEA (me e-mail) ku bëhen pyetje për ndryshime të mundshme të kriterëve përkatëse.

Monitorimi nga autoritetet doganore

Monitorimi bëhet vazhdimisht nga autoritetet doganore, duke përfshirë edhe monitorimin e veprimtarive të përditshme të OEA dhe vizita në objekt. Monitorimi ka për qëllim zbulimin e hershëm të çdo sinjali mospërputhshmërie dhe marrjen e masave në rast vështirësish apo mospërputhshmërie.

Sipas nenit 60 të VKM nr.651/2017, statusi OEA i nënshtrohet monitorimit. Për më tepër, duke marrë në konsideratë se periudha e vlefshmërisë së autorizimit OEA nuk është e kufizuar ka rëndësi të madhe që të vlerësohen vazhdimisht kriteret dhe kushtet e statusit OEA.

Njëkohësisht, monitorimi ndihmon që të kuptohet më mirë biznesi i OEA-s që mund të bëjë që autoritetet doganore t'i rekomandojnë OEA-s mënyra më të mira dhe më efektive të përdorimit të procedurave dhe rregullave doganore në përgjithësi.

Ndaj është e rëndësishme që autoriteti kompetent doganor të sigurohet që të krijohet sistemi për monitorimin e përputhshmërisë me kushtet dhe kriteret e autorizimit, në përputhje me OEA. Çdo masë kontrolli që merret nga autoritetet doganore duhet të regjistrohet.

Sipas nenit 60, të VKM nr.651/2017 .. “Autoritetet doganore duhet të informojnë DPD-në, pa vonesë, për çdo faktor që lind pas dhënies së statusit të OEA, i cili mund të ndikojë në vazhdimësinë apo përmbajtjen e tij. Kur një autoritet doganor revokon një vendim të favorshëm, i cili është marrë në bazë të statusit të OEA, ai njofton DPD-në.”.

Ndonëse legjislacioni nuk përcakton një formë specifike për krijimin e një sistemi të përgjithshëm monitorimi, mënyra më e saktë është që autoriteti kompetent doganor ta hartojë vetë planin e monitorimit. Ky plan mund të jetë një përmbledhje e të gjithë konstatimeve të çdo kontrolli dhe kur është e nevojshme mund të sugjerojë masa korrigjuese (edhe kur operatori është i lirë të gjejë zgjidhje tjetër nga ajo që i sugjerohet).

Monitorimi i operatorëve OEA nga autoriteti doganor mund të përfshijë:

- që masat korrigjuese të sugjeruara të zbatohen siç duhet nga OEA;
- të ndjekë operacionet e OEA, si edhe risqet ekzistuese, dhe të parandalojë lindjen e risqeve të reja.

Pavarësisht nga mënyra se si autoritetet doganore vendosin ta organizojnë monitorimin, dmth., si plan i posaçëm apo si pjesë e raportit përfundimtar, do të mbahen në konsideratë këto elemente:

- **rezultatet e kontrollit (auditit)** – monitorimi duhet të bazohet kryesisht mbi profilet e riskut të OEA-s, sipas vlerësimit të audituesve gjatë kryerjes së kontrollit, duke përfshirë edhe masat e rekomanduara që duhet të ndërmerren nga OEA;
- **zbatimi i nenit 53, pika 2, e VKM nr.651/2017**, kur aplikanti është mbajtës i një certifikate të sigurisë dhe të mbrojtjes të lëshuar në bazë të një konvente ndërkombëtare ose të një standardi ndërkombëtar të Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim, ose nga një standard evropian i një organi evropian standardizimi, këto certifikata merren parasysh kur kontrollohet pajtueshmëria me kriteret e përcaktuara në shkronjën “d”, të nenit 41, të Kodit.
– këto janë rrethana të rëndësishme që duhet të mbahen në konsideratë, duke qenë se në këto raste janë përdorur autorizime apo certifikata të lëshuara nga autoritete të tjera gjatë dhënies së statusit OEA;
- **sinjale të paralajmërimit të hershëm** – siç përmendet më lart, OEA është juridikisht i detyruar të informojë autoritetin kompetent doganor në lidhje me çdo ndryshim domethënës. Mundet që ndryshimet e bëra nga OEA t’i bëjnë autoritetet doganore të dalin me një vendim për ri-vlerësim. Është e rëndësishme që OEA të kuptojë qartë dhe drejt detyrimet e tij dhe mënyrën se si do t’i komunikojë këto ndryshime tek autoriteti doganor.

Është e nevojshme që autoritetit doganor t’i jepet mundësia të kontrollojë vazhdimisht dhe të bindet që operatori e ka biznesin e tij nën kontroll dhe që të kuptojë çdo risk apo ndryshim të rrethanave (A kanë lindur risqe të tjera? A është cilësia e organizimit

administrativ dhe sistemi i kontrollit të brendshëm po aq i mirë sa ishte gjatë auditimit?). Ka mënyra nga më të ndryshmet që autoritetet doganore të kuptojnë që në fillim nëse ka ndonjë risk/informacion të ri, p.sh.:

- kontrole të herë pas hershme të deklaratave të OEA;
 - inspektim fizik i mallrave;
 - analizë e informacionit që disponohet në bazën e të dhënave doganore;
 - çdo kontroll, i ndryshëm nga monitorimi apo ri-vlerësimi OEA (p.sh. auditim sipas një procedure të thjeshtuar apo një aplikim për statusin e magazinuesit të autorizuar);
 - vlerësim i ndryshimeve në etikën e kompanisë apo modelin tregtar.
- **monitorimi i risqeve** – risqet apo rrethanat e reja duhet të vlerësohen përmes monitorimit. Në rast se një nga elementët e vlerësimit të shpie në konkluzionin se operatori nuk po i trajton më siç duhet risqet e evidentuara, autoriteti doganor informon operatorin për këtë konkluzion. Më pas, operatori duhet të marrë masa korrigjuese. Mbetet detyrim i autoritetit doganor t'i vlerësojë këto përmirësime. Kjo nga ana e saj mund të çojë në konkluzionin se duhet bërë ri-vlerësim i një apo më shumë kriterëve dhe kushteve, apo që statusi i OEA-s duhet të pezullohet apo hiqet menjëherë.

Aktivitetet e planifikuara të monitorimit duhet të bazohen mbi analizën e riskut në faza të ndryshme (shqyrtim përpara dhënies së statusit, menaxhim i autorizimit të dhënë, etj.). Ka një sërë faktorësh influences:

- lloji i autorizimit – gjatë monitorimit të disa kriterëve si p.sh. aftësia paguese e provuar, kjo mund të bëhet nga zyra, ndërsa monitorimi i sigurisë për OEAS zakonisht kërkon vizitë në vend;
- stabiliteti i një operatori ekonomik – për ta parë nëse ndryshon shpesh vend, treg, personel, sisteme etj.;
- shkalla e biznesit dhe numri i hapësirave;
- roli i OEA-s në zinxhirin e furnizimit – nëse OEA ka akses fizik tek mallrat apo nëse vepron si agjent doganor;
- forca e kontrollit të brendshëm në procesin e biznesit dhe nëse proceset janë kontraktuar;
- nëse janë ndërmarrë veprime pasuese apo ka pasur përmirësime të vogla të proceseve apo procedurave të rekomanduara gjatë auditit OEA.

Rrjedhimisht, shpeshësia dhe natyra e aktiviteteve të monitorimit varet nga OEA-ja dhe risqet përkatëse. Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën e kriterit të sigurisë, rekomandohen vizita në vend për OEAS, çdo 3 vjet.

Vëmendje e posaçme duhet t'u kushtohet rasteve kur një operator ekonomik që i është dhënë statusi OEA ka më pak se tre vite pune. Në këtë rast, autoritetet doganore duhet të bëjnë një monitorim nga afër gjatë vitit të parë që i është dhënë statusi OEA.

Është gjithashtu e rëndësishme të mbahet në konsideratë që plani i monitorimit dhe sidomos vizitat në hapësirat e OEA duhet të bëhen në kontekstin e përgjithshëm të aktivitetit doganor.

Autoritetet doganore duhet të bashkërendojnë dhe të mbajnë në konsideratë çdo aktivitet tjetër auditimi/monitorimi i parashikuar për atë operator ekonomik. Duhet shmangur në maksimum duplikimi i kontrolleve.

Gjithashtu çdo informacion që disponohet nga institucionet e tjera mund të përdoret gjatë planifikimit të çdo aktiviteti monitorimi, për shmangien e duplikimeve, si nga ana e autoriteteve doganore ashtu edhe e operatorëve ekonomikë.

Nga monitorimi mund të dalin veprime specifike të autoritetit doganor. Këto veprime duhet të dokumentohen, në forma të tilla si p.sh.:

- përditësim i planit të monitorimit,
- përmirësim i raportit të auditimit,
- konkluzione dhe konstatime të përgjithshme të ekipit të auditit etj.,.

Në këtë dokumentacion do të përcaktohen kriteret që janë kontrolluar dhe rezultatet e këtyre kontrolleve.

Seksioni II – Rivlerësimi

Në bazë të nenit 23, të VKM Nr.651/2017, autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit duhet të bëjnë rivlerësim nëse një mbajtës autorizimi OEA vazhdon të jetë në përputhje me kushtet dhe kriteret e OEA në rastet e mëposhtme:

- a) Kur ka ndryshime në legjislacionin përkatës që ndikojnë në vendim;
- b) Kur është e nevojshme, si rezultat i monitorimit të kryer;
- c) Kur është e nevojshme për shkak të informacionit të dhënë nga mbajtësi i vendimit në përputhje me pikën 2, të nenit 28, të Kodit, ose nga autoritetet e tjera.

2. Autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit ia komunikon rezultatin e rivlerësimit mbajtësit të vendimit.

Në varësi të arsyes së rivlerësimit, mund të kalohet në një ri-shqyrtim të kriterëve dhe kushteve konkrete.

5.II.1. Rivlerësim pas ndryshimeve në legjislacionin doganor

Rivlerësimi kërkohet në rastet kur ka ndryshime në legjislacionin specifik doganor dhe që ka ndikim tek kushtet dhe kriteret që lidhen me statusin OEA.

Një nga shembujt mund të jenë ndryshimet në kriteret OEA, pas ndryshimeve në Kodin Doganor dhe të dispozitave zbatuese, si p.sh. kriteret të reja për standardet praktike profesionale të kompetencave apo kualifikimeve profesionale. Zakonisht legjislacioni kërkon që ri-vlerësimi të bëhet gjatë një periudhe specifike kalimtare (tranzitore).

5.II.2. Rivlerësim, pas rezultateve të një monitorimi që është kryer apo për shkak të informacionit nga mbajtësi i vendimit apo nga autoritete të tjera

Pikënisja për vendimmarrje për rivlerësim është që të ketë një indikacion të arsyeshëm që OEA nuk po plotëson më kriteret dhe kjo mund të vijë nga situata të ndryshme – si rezultat i një monitorimi që kanë bërë autoritetet doganore; si rezultat i kontrolleve nga dogana apo autoritete të tjera shtetërore; mbi bazën e informacionit të marrë nga doganat apo autoritete të tjera shtetërore; ndryshime të rëndësishme në aktivitetin e OEAs-ë etj. Varet nga D.P.D që të marrë vendim për çdo rast specifik, nëse do të bëhet një rivlerësim i të gjitha kushteve dhe kriterëve apo vetëm për ato kushte dhe kriteret për të cilat ka informacion për mospërputhshmëri. Gjithmonë ka mundësi që gjatë rivlerësimit të zbulohet se një nga kriteret ka nevojë të kontrollohet sërish.

Rivlerësimi bëhet nga D.P.D e cila vendos nëse do të nisë një rivlerësim dhe cilat do të jenë institucionet/ drejtoritë e tjera doganore që do të përfshihen.

Në rast se kompania fillon një proces ristrukturimi që ka ndikim, ajo duhet të informojë D.P.D-në, në mënyrë që të marrë masat e nevojshme, duke përfshirë edhe një rivlerësim.

Ndonëse, në përgjithësi rivlerësimi mund të ndryshojë nga një rast tek tjetri, duhet të mbahen në konsideratë elementët e mëposhtëm:

- a) ***spektri i rivlerësimit*** – kriteret dhe kushtet që do të kontrollohen apo verifikohen duke mbajtur në konsideratë arsyet për nisjen e rivlerësimit.
- b) ***metoda e rivlerësimit*** – do të jetë vetëm kontroll dokumentesh, apo do të kombinohet me një vizitë në vend, kur është e përshtatshme për kriteret specifike që po rivlerësohen;
- c) ***afatet*** – nuk ka ndonjë afat të specifikuar për kryerjen e një ri-vlerësimi. Megjithatë, kjo do të përcaktohet në varësi të numrit të kriterëve që do të kontrollohen, nëse do të ketë ndonjë vizitë në terren dhe zakonisht nuk duhet t'i tejkalojë të njëjtat afate për vendimin fillestar për OEA;
- ç) ***rivlerësimet ku përfshihen institucione të tjera*** -- në rastet kur rivlerësimi përfshin një rivlerësim të kriterëve në bashkëpunim me institucionet e tjera do të zbatohen rregullat për procedurat e konsultimit në Pjesën 4 “Shkëmbimi i informacionit

midis autoriteteve” të këtij udhëzimi. Zakonisht, autoriteti doganor përcakton nëse ka nevojë për një vizitë në terren, si pjesë e procesit të rivlerësimit.

- d) *autorizime të tjera doganore që ndikohen*** – kur bëhet një rivlerësimi këshillohet të përcaktohet nëse OEA ka autorizime apo thjeshtësime të tjera që janë të kushtëzuara nga përputhshmëria me kriteret OEA, si për shembull autorizimi për përdorimin e procedurave të thjeshtuara. Në këto raste duhet të mbahet në konsideratë dhe të shmanget çdo duplikim i rivlerësimeve, si përsa u takon burimeve doganore, ashtu edhe atyre të operatorit ekonomik.
- dh) *raporti i rivlerësimit*** – përsa u takon raporteve dhe rekomandimeve duhet të mbahet e njëjta qasje si për auditin fillestar. Është e rëndësishme që veprimet e propozuara të reflektohen në raport, si p.sh. pezullimi, revokimi dhe masat bashkë me afatet.
- e) *disponibiliteti i rezultateve*** - rezultatet e rivlerësimit duhet tu vihen në dispozicion strukturave doganore dhe kur është e nevojshme edhe institucioneve të tjera.

Seksioni III – Ndryshimi i Vendimit të Autorizimit

Në përputhje me nenin 32, të Kodit Doganor, pikën 1, të nenit 24 dhe pikën 1, të nenit 32, të VKM nr.651/2017 autorizimi OEA do të revokohet apo ndryshohet në rast se një apo më shumë nga kushtet për marrjen e atij vendimi nuk plotësohen më nga OEA.

Revokimi në kontekstin e OEA trajtohet me hollësi në pjesën 5.V të këtij Udhëzuesi.

Në kontekstin e OEA, disa shembuj të mundshëm të ndryshimeve në autorizim lidhen psh me emrin apo adresën e OEA. Këto ndryshime mund të bëhen vetëm pas rivlerësimit të plotësisht të kriterëve (në rast të një OEAS, zyra të reja).

Për këtë ndryshim të autorizimit do të njoftohet OEA. Çdo ndryshim duhet t’u komunikohet strukturave të tjera doganore dhe kur është e nevojshme, edhe institucioneve të tjera.

Gjithashtu, vlen të theksohet se aplikuesi duhet t’i komunikojë D.P.D, çdo ndryshim në lidhje me aplikimin.

Seksioni IV - Pezullimi

Pezullimi i statusit OEA nënkupton që një autorizim i lëshuar nuk është i vlefshëm gjatë një periudhe specifike.

Në përputhje me pikën 4, të nenit 28, të Kodit Doganor që ka lidhje me nenin 16, të VKM nr.651/2017, autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit e pezullon vendimin,

por nuk e anulon, revokon ose ndryshon atë në përputhje me nenet 28, pika 3, 31 ose 32, të Kodit Doganor, kur:

- a) autoriteti doganor gjykon se mund të ketë arsye të mjaftueshme për anulimin, revokimin ose ndryshimin e vendimit, por ende nuk disponon elementet e nevojshme për të vendosur mbi anulimin, revokimin ose ndryshimin;
- b) autoriteti doganor gjykon se nuk janë përmbushur kushtet sipas vendimit ose që mbajtësi i vendimit nuk respekton detyrimet sipas këtij vendimi dhe mbajtësit të vendimit mund t'i jepet kohë për të marrë masa për përmbushjen e kushteve ose respektimin e detyrimeve;
- c) mbajtësi i vendimit e kërkon pezullimin për shkak se përkohësisht nuk është në gjendje të përmbushë kushtet e përcaktuara sipas vendimit ose për të respektuar detyrimet e vendimit.

Në rastet e referuara në shkronjat “b” dhe “c”, më lart, mbajtësi i vendimit duhet të njoftojë autoritetin doganor kompetent për marrjen e vendimit, për masat që do të marrë për të siguruar përmbushjen e kushteve ose respektimin e detyrimeve, si dhe periudhën e kohës që i nevojitet për të marrë këto masa.

Gjatë periudhës së pezullimit, OEA nuk ka të drejtë të përfitojë nga përfitimet që i jepte statusi që mund të kenë pasoja serioze për të.

Bazuar në nenin 48, të VKM nr.651/2017, kur autorizimi OEA është pezulluar për shkak të mosrespektimit të ndonjë prej kriterëve të përmendura në nenin 41, të Kodit, çdo vendim i marrë në lidhje me atë OEA, i cili është bazuar në autorizimin e OEA në përgjithësi ose në ndonjë nga kriteret specifike, të cilat çuan në pezullimin e këtij autorizimi, do të pezullohet nga autoriteti doganor që e ka marrë atë vendim.

Pezullimi i një vendimi lidhur me zbatimin e legjislacionit doganor të marrë në lidhje me një OEA nuk duhet të çojë në pezullimin automatik të autorizimit të OEA.

Kur një vendim në lidhje me një person që është njëkohësisht OEAS dhe OEA për Thjeshtësimet Doganore, (OEAD), është pezulluar në përputhje me pikën 1, të nenit 24, të VKM nr.651/2017, për shkak të mospërmbushjes së kushteve të parashikuara të standardeve praktike të kompetencave apo kualifikimeve profesionale që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetin, (sipas shkronjës “d”, të nenit 41, të Kodit), autorizimi i tij si OEAD pezullohet, ndërsa autorizimi si OEAS mbetet i vlefshëm.

Kur një vendim në lidhje me një person që është njëkohësisht OEAS dhe OEAD është pezulluar në përputhje me pikën 1, të nenit 24, të VKM nr.651/2017, për shkak të mospërmbushjes së kushteve për standardet e duhura të sigurisë dhe mbrojtjes (sipas shkronjës “dh”, të nenit 41, të Kodit), autorizimi i tij si OEAS pezullohet, ndërsa autorizimi si OEAD mbetet i vlefshëm.

Pezullimi mund të jetë vijë si pasojë e një kontrolli gjatë një monitorimi apo rivlerësimi, ku janë zbuluar mangësi serioze, që do të thotë se mbajtësi i atij autorizimi, nga

pikëpamja e riskut, në rrethanat aktuale nuk mund ta mbajë statusin. Ky tregues mospërputhshmërie mund të lindë dhe si rezultat i informacionit të marrë nga autoritete të tjera, si p.sh. autoriteti i aviacionit civil, zyra e tatim – taksave, etj.

Përpara marrjes së vendimit për pezullim, autoriteti doganor kompetent duhet të njoftojë OEA-n në lidhje me konstatimet, vlerësimet dhe faktin që vlerësimi mund të çojë në një pezullim të autorizimit, në rast se nuk rregullohet situata. OEA-së i jepet e drejta për tu dëgjuar dhe mundësia për ta ndrequr situatën. Afati për komente dhe korrigjime është 30 ditë kalendarike nga data e komunikimit.

Përgjigjet duhet të vlerësohen me kujdes nga pikëpamja e riskut dhe nëse konstatohet se situata nuk është korrigjuar, statusi do të pezullohet për 30 ditë kalendarike. OEA duhet të njoftohet me shkrim.

Statusi i OEA mund të pezullohet me efekt të menjëhershëm, në rast se lloji apo shkalla e kërcënimit të sigurisë publike, shëndetit publik apo mjedisit e kërkon një vendim të tillë. Kjo mundësi duhet të përdoret me kufizim.

Në rast se iniciativa për pezullimin e statusit vjen nga mbajtësi i autorizimit i cili përkohësisht nuk është në gjendje të plotësojë ndonjë nga kriteret OEA, OEA duhet të paraqesë argumentin për këtë kërkesë dhe kur është e përshtatshme, të propozojë një plan veprimi ku të tregohen masat që do të ndërmerren dhe afatet. Për shembull, një operator po përmirëson apo ndryshon *prodhimin që ka lidhje me aspektin kompjuterik* dhe për një farë kohe ai nuk do të jetë në gjendje të ndjekë mallrat në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit. Atëherë ai kërkon pezullim dhe propozon një afat zbatimi.

Statusi mund të pezullohet në rast se plani i veprimit dhe arsyeja për shërbimin e kërkuar mund të konsiderohen si të arsyeshme. Përndryshe duhet të diskutohet si mundësi, revokimi i autorizimit me kërkesën e mbajtësit.

Megjithatë, duhet të mbahet në konsideratë se dallimi midis pezullimit me iniciativën e autoritetit doganor dhe pezullimit me iniciativën e OEA është shumë i rëndësishëm dhe pasqyrohet qartë në legjislacion. Ndaj nuk mund të përdoret qëllimisht nga OEA vetëm për ta shtyrë revokimin apo për të shmangur periudhën tre vjeçare nga dita e revokimit, që lejon paraqitjen e një aplikimi të ri.

Administrata Doganore duhet të bëjë një vlerësim shumë të kujdesshëm të efektit të pezullimit. Pezullimi nuk ka ndikim tek procedurat doganore që kanë nisur përpara këtij pezullimi dhe të cilat nuk kanë përfunduar ende.

Kur bie arsyeja për pezullim, autorizimi duhet të bëhet sërish i vlefshëm. Në rast se kjo nuk ndodh, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të marrë në konsideratë nëse duhet të revokohet autorizimi.

Seksioni V – Revokimi

Dispozitat për revokimin e autorizimit dhe rastet që mund të çojnë në revokim përcaktohen në nenin 32, të Kodit Doganor dhe në nenin 59 të VKM Nr.951/2017.

Sipas nenit 32, të Kodit Doganor një vendim në favor të aplikuesit revokohet kur:

- a) një apo më shumë nga kushtet, në bazë të të cilave është marrë një vendim, nuk ishin përmbushur ose nuk përmbushen më; ose
- b) me aplikim nga mbajtësi i vendimit.

Sipas nenit 59, të VKM Nr.951/2017 një vendim pozitiv revokohet kur:

1. Revokimi i një autorizimi OEA nuk cenon asnjë vendim të favorshëm i cili është marrë në lidhje me të njëjtin person, përveç nëse statusi OEA ishte një kusht për këtë vendim të favorshëm, ose nëse vendimi ishte bazuar në një kriter të listuar në nenin 41, të Kodit, i cili nuk është më i përmbushur.

2. Revokimi ose ndryshimi i një vendimi të favorshëm, i cili është marrë në lidhje me mbajtësit e autorizimit, nuk cenon automatikisht autorizimin OEA të atij personi.

3. Kur i njëjti person është një OEAD dhe një OEAS dhe kur neni 32 i Kodit ose neni 15, është i zbatueshëm për shkak të mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në shkronjën “ç”, të nenit 41, të Kodit, autorizimi OEAD revokohet dhe autorizimi OEAS mbetet i vlefshëm.

Kur i njëjti person është një OEAS dhe një OEAD dhe kur neni 32 i Kodit ose neni 32, është i zbatueshëm për shkak të mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në shkronjën “d”, të nenit 41, të Kodit, autorizimi OEAS revokohet dhe autorizimi OEAD mbetet i vlefshëm.

Në rast se autoriteti doganor vendos për revokimin e vendimit nuk do të pranohet një aplikim i ri për autorizim OEA brenda tre vjetëve nga data e revokimit.

Revokimi i një autorizimi OEA nuk cenon asnjë vendim të favorshëm i cili është marrë në lidhje me të njëjtin person, përveç nëse statusi OEA ishte një kusht për këtë vendim të favorshëm, ose nëse vendimi ishte bazuar në një kriter të listuar në nenin 41, të Kodit, i cili nuk është më i përmbushur (pika 1, e nenit 59 të VKM Nr.951/2017).

Revokimi ose ndryshimi i një vendimi të favorshëm, i cili është marrë në lidhje me mbajtësit e autorizimit, nuk cenon automatikisht autorizimin OEA të atij personi (pika 2, e nenit 59 të VKM Nr.951/2017).

Kur i njëjti person është OEAD dhe OEAS dhe autorizimi revokohet për shkak të mospërmbushjes së kushteve të parashikuara në nenin 41, shkronja “d” të Kodit

(standardet praktike të kompetencave apo kualifikimeve profesionale në lidhje direkte me aktivitetin që kryhet) autorizimi OEAD revokohet dhe autorizimi OEAS mbetet i vlefshëm (paragrafi i parë i pikës 3, të nenit 59, të VKM Nr.951/2017).

Kur i njëjti person është OEAS dhe OEAD dhe autorizimi revokohet për shkak të mospërmbushjes së kushteve të parashikuara në nenin 41, shkronja “dh” të Kodit (standardet e duhura të sigurisë) autorizimi OEAS revokohet dhe autorizimi OEAD mbetet i vlefshëm (paragrafi i dytë i pikës 3, të nenit 59, të VKM Nr.951/2017).

Vlen të theksohet se revokimi me iniciativën e autoritetit doganor është vendim i doganor dhe operatori ekonomik gëzon të drejtën për tu dëgjuar. Rrjedhimisht, çdo konstatim, vlerësimi i bërë dhe fakti që vlerësimi mund të çojë në revokimin e statusit OEA do t'i njoftohet OEA, me përjashtim të rastit kur e drejta për tu dëgjuar është shprehur në procedurën përpara pezullimit. Për çdo vendim revokimi operatori ekonomik gëzon të drejtën e ankimit.

Pjesa 6. Njohja reciproke

Informacionet e mëposhtme përqendrohen në një kontekst të përgjithshëm dhe në procesin e Marrëveshjeve të Njohjes Reciproke/ të ndërsjellë (MRA) dhe zbatimin e tyre.

Deri tani, Shqipëria ka qenë pjesë e programeve të njohjes reciproke OEA me vendet CEFTA.

Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 18/2018, datë 05.04.2018 ka ratifikuar “Protokollin Shtesë 5 të Marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qëndrore”.

Protokolli Shtesë 5, parashikon në pikën 3, të nenit 3, si një ndër objektivat e përgjithshme, njohjen reciproke të programeve kombëtare të operatorëve ekonomikë të autorizuar në çdo Palë të CEFTA-s, me kusht që legjislacioni dhe zbatimi i çdo programi kombëtar të jenë në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës të BE-së.

Statusi i OEA-ve dhe njohja përcaktohet në Nenin 25, Shkëmbimi i informacionit midis Palëve të CEFTA-s për programet e tyre të OEA-ve jepet në nenin 26.

Statusi OEA jepet nga secila Palë e CEFTA-s në përputhje me aneksin III të këtij Protokollit, ku jepen kushtet, kriteret dhe përfitimet për OEA-të.

Pezullimi, refuzimi, revokimi dhe anulimi i statusit të OEA do të bëhet, gjithashtu, në përputhje me aneksin III, të Protokollit. Statusi i OEA-së do të njihet nga Palët e tjera të CEFTA-s, me kusht që zbatimi i programeve të OEA-së, të jetë në përputhje të plotë me aneksin III, të Protokollit.

Statusi i përafrimit dhe i implementimit të çdo programi të OEA-së do të miratohet nga Palët e tjera të CEFTA-s, pa cenuar inspektimet doganore, në përputhje me procedurat përkatëse, të cilat do të miratohen nga Komiteti i Përbashkët i CEFTA-s.

Seksioni I – Hapat e procesit drejt Njohjes Reciproke

Për Shqipërinë, hapat e mëposhtëm kanë rëndësi për arritjen e Njohjes Reciproke:

- angazhim zyrtar për krijimin e Njohjes reciproke
- krahasim i legjislacionit
- vlerësim i zbatimit të programeve përkatëse dhe shkëmbimit të praktikave më të mira, duke përfshirë vizitat në terren nga të dyja anët (shih pjesën [6.VII të këtij Udhëzuesi](#) – rekomandime për kryerjen e monitorimit/vizita auditit)
- Teksti MRA duhet të përmbajë kryesisht këta elementë: përputhshmëria e dy programeve OEA, vlerësimi i përfitimeve reciproke që do të përftohen, me sa më shumë saktësi të jetë e mundur. Të dhënat që i nënshtrohen shkëmbimit automatik të të dhënave dhe rregullave për mbrojtjen e të dhënave. Rregulla procedurale, duke përfshirë edhe rregullat për pezullimin e njëanshëm të përfitimeve.
- Sistemi i shkëmbimit elektronik të të dhënave.

Seksioni III – Zbatimi dhe ndjekja, pas nënshkrimit të MRA

Për shkak të numrit të OEA në rajon që përfitojnë nga njohja reciproke dhe numrit po kaq të lartë të vendeve partnere të MRA, përpilimi dhe zbatimi i një mekanizmi të automatizuar për shkëmbimin e të dhënave është element shumë i rëndësishëm për një MRA. Me fjalë të tjera, për zbatimin e një MRA-je duhet që mekanizmi për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të jetë bërë funksional.

Kur MRA-ja përfundon vazhdon dialogu me vendin/vendet partner. Ka shkëmbime të shpeshta informacioni në lidhje me zhvillimet e fundit, duke përfshirë bashkëpunimin në rast të pezullimit të njëanshëm të përfitimeve nga MRA. Praktikën më të mira përsa i takon zbatimit të një MRA-je përfshijnë konferencat, seminarët dhe programet e tipit FAQ (ju pyesni, ne përgjigjemi) ku shpjegohen aspektet teknike të MRA.

Për tu siguruar që të palët i ruajnë standardet në lidhje me procedurat OEA rekomandohet fuqimisht që të kryhen vizita monitorimi të rregullta në secilën nga palët.

Seksioni IV – Përfitimet nga MRA, të propozuara nga BE-ja për anëtarët e programeve partnere OEA (dhe reciprokisht)

Përfitimet konkrete përcaktohen në marrëveshjet individuale për partnerët e MRA

- a) **më pak kontrolle sigurie:** çdo autoritet doganor e merr në konsideratë pozitivisht statusin e një Anëtari Programi të autorizuar nga autoriteti tjetër doganor, gjatë vlerësimit që i bën riskut, për të ulur inspektimet apo kontrollet dhe masat e tjera që lidhen me sigurinë.

- b) **njohja e partnerit të biznesit gjatë procesit të aplikimit:** çdo autoritet doganor e merr në konsideratë pozitivisht statusin e një Anëtarit Programi të autorizuar nga autoriteti tjetër doganor, me qëllim që ta trajtojë Anëtarin e Programit si partner të sigurtë gjatë vlerësimit të kërkesës së partnerit biznesit për aplikuesit në Programin e vet.
- c) **trajtim prioritar gjatë zhdoganimit:** çdo autoritet doganor e merr në konsideratë statusin e një Anëtarit Programi të autorizuar nga një tjetër autoritet doganor, duke garantuar trajtimin prioritar, përpunim të përshpejtuar, formalitete të thjeshtuara dhe çlirim të përshpejtuar të ngarkesës në rast të përfshirjes së një Anëtarit Programi.
- ç) **Mekanizmi i vazhdimësisë së biznesit:** të dyja palët përpiqen të krijojnë një mekanizëm të përbashkët të vazhdimësisë së biznesit, për të reaguar ndaj problemeve që mund të lindin në tregti për shkak të rritjes së niveleve të sigurisë, mbylljes së kufirit dhe/ose katastrofave natyrore, emergjenca të rrezikshme, apo incidente të tjera të mëdha, ku ngarkesat prioritare që lidhen me Anëtarët e Programit mund të kalojnë me procedurë të përshpejtuar, deri aty ku e kanë të mundur autoritetet doganore.
- d) **përfitimet e ardhshme MRA**
Administratat doganore dhe biznesi po bashkëpunojnë ngushtësisht për evidentimin dhe zhvillimin e përfitimeve shtesë për OEA në kuadrin e Njohjes reciproke me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të programit.

Në marrëveshjen e CEFTA-s përfitimet që rrjedhin nga statusi i OEA-së janë të parashikuara në nenet 9 dhe 10.

Seksioni V – Zbatimi i MRA-ve – Si të përfitohet nga MRA-të?

Kompanitë OEA me komponent sigurie që dëshirojnë të përfitojnë nga MRA me vendet me të cilat autoriteti doganor ka Marrëveshje për njohje reciproke duhet të sigurohen nëse e kanë dhënë **miratimin me shkrim për shkëmbimin e të dhënave me vendet partnere të MRA-së**. Ky pëlqim me shkrim është pjesë e **Pyetësorit të Vetëvlerësimit** dhe dorëzohet bashkë me aplikimin për OEA. Sidoqoftë, ky miratim mund të dorëzohet apo tërhiqet në çdo kohë nga aplikuesi/OEA. Me qëllim dorëzimit apo tërheqjes së miratimit, OEA duhet të kontaktojë me D.P.D.

Detajet mbi përfitimet dhe procedurat për njohje reciproke do të përcaktohen në marrëveshjet përkatëse midis shteteve.

Seksioni VI - Pezullimi i njëanshëm i përfitimeve

Në kuadrin e MRA-së nuk mund të përjashtohet fakti që një nga kompanitë partnere të zbulojë një rast incidenti që lidhet me sigurinë ku kompanitë OEA të palës tjetër janë të përfshira (p.sh. kapje e lëndëve narkotike në një kontenier të një kompanie OEA).

Për këto raste, vendimet përkatëse MRA përfshijnë bazën ligjore për të dyja palët, që lidhet me pezullimin e përfitimeve për kompanitë OEA të përfshira.

Seksioni VII – Rekomandime për kryerjen e një auditimi OEA apo vizitë monitorimi në një shtet me të cilin ka Marrëveshje për njohje reciproke.

Një nga elementët thelbësorë e negociatave MRA me vendet partnere, si dhe pjesë e monitorimit, si pjesë e zbatimit të MRA janë auditimi OEA ose monitorimi i vizitave në terren.

Qëllimi i vizitës në terren është të konstatojë sesi programi OEA zbatohet në praktikë nga shtete të ndryshme palë të MRA. Vizita të tilla janë pjesë e negociatave MRA dhe si pjesë e zbatimit MRA, momentin që MRA ka hyrë në fuqi.

Në përgjithësi interesi kryesor është zbatimi i legjislacionit të BE për OEA-n në mënyrë të njehsuar nga vendet anëtare.

Ajo përbëhet nga dy pjesë: hyrje në strukturën organizative dhe kombëtare të OEA-s dhe një panoramë e përgjithshme për kompaninë që do të vizitohet. Pjesa e dytë është praktikisht vizita.

Diskutim i zbatimit të programit të OEA në cdo shtet palë e MRA

Interesi kryesor ka të bëjë me mënyrën se si zbatohet programi OEA nga këndvështrimi operativ.

Këtu duhet të përfshihet një panoramë e shkurtër e:

- administratës doganore në përgjithësi;
- organigrama e OEA: numri i personelit që merret me OEA (me kohë të plotë e të pjesshme, sistemi i trajnimit, lidhjet me komunitetin e biznesit);
- procedura e autorizimit, duke përfshirë aplikimin dhe pyetësin për vetë-vlerësimin, si kontrollohen elementët e sigurisë;
- monitorimi dhe post-auditimi;
- bashkëpunimi me institucionet e tjera gjatë autorizimit dhe monitorimit.

Vizita në kompani

Qëllimi i vizitës në kompani është vëzhgimi i audituesve të OEA-s të vendeve anëtare të MRA kur kryejnë një kontroll në premiset e aplikuesit apo një vizitë monitorimi në një kompani OEA. Përfaqësuesit e vendit partner MRA, marrin pjesë si vëzhgues.

Është shumë e rëndësishme që kompanitë të informohen në lidhje me qëllimin e vizitës dhe që të dinë që synimi është konfirmimi që zbatimi OEA është në përputhje me standardet e përcaktuara.

Vizita në hapësirat e aplikuesit/kompanisë OEA zakonisht strukturohet në këtë mënyrë:

- vizita duhet të jetë një auditim që duhet të drejtohet nga audituesit e OEA – jo nga kompania;
- kompania duhet të jetë informuar paraprakisht në lidhje me këtë vizitë dhe mbi mënyrën sesi do të bëhet ajo;
- auditimi duhet të kryejë detyrat normale;
- në rast të një auditimi gjatë një aplikimi për OEA-n;
- në rast të një vizite monitorimi (monitorimi OEA ekzistues) dmth., pyetje në lidhje me zhvillimet e fundme që kanë ndikim tek OEA, t'i kërkohet kompanisë të shpjegojë apo demonstrojë procedurat e sigurisë);
- në rast se ka nevojë për përkthim, duhet të sigurohet koha e duhur për të përkthyer përmbajtjen e pyetjeve të revizorëve dhe përgjigjeve të kompanisë. Kompania duhet të informohet paraprakisht;
- vëzhguesit (nga vendi partner MRA) mund të krijojnë vetëm një ide të procesit të auditimit/monitorimit OEA;
- vizita e validimit duhet të përfundojë me rekomandime për aplikuesin;
- ushtrimi i auditimit duhet të përqendrohet tek Siguria

Konceptoi: M.Shqalsi

Pranoi: E.Hitaj

Miratoi: S.Sinani

Konfirmoi: A.Andoni

Shkurtime

OEA	Operator ekonomik i autorizuar
OEAD	AEO – Thjeshtime Doganore
OEAS	AEO - Siguria dhe Mbrojtja
AC	Dërguesi Përgjegjës
KE	Komuniteti Evropian
EORI	Regjistrimi dhe identifikimi i operatorit ekonomik
EOS	Sistemi i operatorit ekonomik
ERP	Planifikimi i burimeve të sipërmarrjeve
BE	Bashkimi Evropian
D.P.D	Autoriteti Lëshues Doganor
ONAC	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
ISO	Organizata Ndërkombëtare e Standardeve
ISO/PAS	Organizata Ndërkombëtare e Standardeve, Specifikim i disponueshëm për publikun
IMO	Organizata Ndërkombëtare Detare
KC	Dërgues i njohur
LSE	Sipërmarrje e shkallës së madhe
MRA	Marrëveshje e Njohjes reciproke
MS	Shtet(e) anëtar(e) i/të BE-së
OJ	Fletorja zyrtare
OTIF	Organizata ndërqeveritare për transportin ndërkombëtar hekurudhor
PBE	Njësia e përhershme e biznesit
RA	Agjent i rregulluar
RBA	Auditim me bazë risku
SME	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
SAQ	Pyetësor vetëvlerësimi
TAPA	Shoqata për mbrojtjen e aseteve të transportuara
TAXUD	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave në BE
UNECE	Komisioni Ekonomik i OKB-së për Evropën
UPU	Unioni Universal postar
UCC	Kodi doganor i BE-së ⁵

⁵ Rregullorja e (BE-së) Nr. 952/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 9 tetor 2013, ku përcaktohet Kodi Doganor i BE-së.

UCC DA	Akti i deleguar i Kodit Doganortë BE-së ⁶
WCO	Organizata Botërore e Doganave
WCO SAFE	Korniza “Safe” e Standardeve për tregti të sigurt globale të Organizatës Botërore të Doganave
VKM Nr.651/2017	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 651, datë 10.11.2017 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr. 102/2014 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

⁶ Regullorja e deleguar e Komisionit (BE) 2015/2446, datë 28 korrik 2015, në vazhdim të Regullores (BE) Nr. 952/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me rregullat e detajuara që specifikojnë disa nga dispozitat e Kodit doganor të BE-së.